

JA DALLIMI

Një studim i dallimeve
të rëndësishme Biblike

Nga

William MacDonald

E drejta e autorit: © 1997 nga William MacDonald

Titulli në anglisht: «Here's the Difference»

Përkthimi nga anglishtja, redaktimi dhe formati në shqip
nga
Sali B. Kaceli, George Sturm, Saimir Rakiplari

Falënderoj shkrimtarin William MacDonald për lejen për ta përkthyer këtë libër në shqip dhe
Russ Bell për përpjekjet e tij që ky libër të bëhej i vlefshëm në Shqipëri. - Sali B. Kaceli

Citimet biblike në shqip janë nga:
bibla, "Diodati i Ri" (1991-1994)
Përdorur me leje nga ALBANIA BIBLE SOCIETY
A.B.S., TIRANË

Asambleja Biblike 2000
Pogradec

Tabela e përmbajtjes

PJESA I: DALLIME NË SHPËTIM

1. TRE KOHËT E SHPËTIMIT
2. ASPEKTET E SHFAJËSIMIT
3. ASPEKTE TË JETËS SË PËRJETSHME
4. SHLYERJA E MËKATEVE ATËHERË DHE TANI

PJESA II: DALLIME NË JETËN E KRISHTERË

5. POZITA DHE PRAKTIKA
6. MARRËDHËNIA DHE BASHKËSIMI
7. FALJA JURIDIKE DHE PRINDËRORE
8. DY NATYRAT
9. LLOJET E SHENJTËRIMIT
10. BRENDABANIMI, PAGËZIMI DHE MBUSHJA
11. SHPËTIMI DHE SHËRBIMI
12. MADHËSHTIA PERSONALE NË KRAHASIM ME MADHËSHTINË

POZICIONALE

13. GJËRA THEMELORE, TË RËNDËSISHME DHE JOESENCIALE

PJESA III: DALLIME NË METODAT E PERËNDISË

14. EPOKA TË NDRYSHME
15. BESËLIDHJET MË TË RËNDËSISHME TË SHKRIMEVE TË SHENJTA
16. IZRAELI DHE KISHA
17. LIGJI DHE HIRI
18. KISHA DHE MBRETËRIA

PJESA IV: DALLIME NË NGJARJET E ARDHSHME

19. DY ARDHJET E KRISHTIT
20. FAZAT E KTHIMIT TË KRISHTIT
21. DITA E ZOTIT, DITA E KRISHTIT, DITA E PERËNDISË
22. PËRMBUSHJE TË DYFISHTA

PJESA V: DALLIME TË TJERA NË SHKRIMET E SHENJTA

23. SHTATË GJYKIMET
24. HADESI DHE GEHENA
25. MISTERE TË SHKRIMEVE TË SHENJTA
26. ASPEKTE TË LAVDIVE TË KRISHTIT
27. DALLIME NË UNGJIJTË

TRE KOHËT E SHPËTIMIT

Kur bëhemi të krishterë, shumë prej nesh mendojnë vetëm për një lloj shpëtimi: shpëtimin e shpirtit tonë. Në studimin tonë biblik ne menjëherë mundohemi t'i japim këtë kuptim sa herë që e gjejmë këtë fjalë. Por shpejt arrijmë të kuptojmë se kjo fjalë nuk ka gjithmonë të njëjtin kuptim.

Pastaj arrijmë të kuptojmë se shpëtimi është një fjalë shumë e përgjithshme që nënkupton çlirim, siguri ose shëndoshmëri. Për shembull, në Filipianëve 1:19, Pali e përdor atë në lidhje me lirin e pritur nga burgu:

E di në fakt, se kjo do të dalë për shpëtimin tim, me anë të lutjes suaj dhe me ndihmën e Frymës së Jezus Krishtit.

Në Filipianëve 2:12 shpëtimi ka kuptimin e diçkaje krejt të ndryshme; nënkupton zgjidhjen e një problemi që ka lindur në kishën në Filipi. Një rast serioz i përçarjes kishte ngjarë (Fil. 2:1-4; 4:2). Pali i kujton të krishterët se përgjigjja ndaj problemit ishte që ata të gjithë të kishin një frymë të përlulur dhe vetë-flijuese të Zotit Jezus. Pastaj në vargun 12 ai thotë:

Prandaj të dashurit e mi, ashtu sikur keni qenë gjithnjë të bindur jo vetëm kur isha i pranishëm, por edhe më shumë tani që jam larg, punoni për shpëtimin tuaj me frikë e me dridhje.

Me fjalë të tjera: «Unë ju kam treguar rrugën e çlirimit nga problemi që ju ka mbërthyer. Tani punoni për zgjidhjen e tij me frikë e me dridhje».

Në tre pjesë, shpëtimi përdoret për të përshkruar shpëtim nga mbytja:

Por duke qenë se detarët kërkonin të iknin prej anijes dhe po e ulnin sandallin në det gjoja për të hedhur spirancat nga bashi, Pali u tha centurionit dhe ushtarëve: «Po nuk qëndruan këta në anije, ju nuk do të mund të shpëtoni» (Veprat 27:30, 31).

Me anë të besimit Noeu, i lajmëruar hyjnisht për ato që ende nuk shiheshin, u frikësua dhe ndërtoi një arkë për shpëtimin e shtëpisë së tij... (Heb. 11:7).

... ai shkoi t'u predikojë frymërave që ishin në burg, që dikur ishin rebelë, kur durimi i Perëndisë i priste në ditët e Noeut, ndërsa po ndërtohej arka, në të cilën, pak vetë, gjithsejt tetë, shpëtuan nëpërmjet ujit (1 Pje. 3:19, 20).

Por përdorimi i fjalëve «shpëtim» ose «i shpëtuar», në të cilat ne jemi të interesuar, janë ato që kanë të bëjnë me çlirim nga mëkati. Ky është kuptimi më i zakonshëm në Dhiatën e Re.

Këtu ne duhet të mësojmë të dallojmë tre kohët e shpëtimit—të kryerën, të tashmen dhe të ardhmen:

E kryer—Jam shpëtuar nga dënimi i mëkatit.

E tashme—Unë po shpëtohem nga fuqia e mëkatit.

E ardhme—Unë do të shpëtohem nga prania e mëkatit.

Koha e kryer

Ja disa vargje që flasin kryesisht për shpëtimin nga dënimi i mëkatit:

Ju në fakt jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë (Ef. 2:8).

(Perëndia) që na shpëtoi dhe na thirri me një thirrje të shenjtë... (2 Tim. 1:9).

Ai na shpëtoi jo me anë të veprave të drejta që ne bëmë, por sipas mëshirës së Tij, me anë të larjes së rilindjes dhe të ripërtëritjes së Frymës së Shenjtë (Tit. 3:5).

Shënim: Në të tre këta shembuj fjala «shpëtuar» është në kohën e kryer. Sidoqoftë, gjenden vargje të tjerë që flasin për çlirimin tonë nga dënimi i mëkatit, ku folja nuk është në kohën e kryer.

Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem (Veprat 4:12).

Sepse, po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jezus dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, do të shpëtohesh (Rom. 10:9).

Kështu ju duhet të dalloni aspektin e shpëtimit nga përmbajtja e vargut më tepër sesa nga koha e foljes, nëse koha e kryer e shpëtimit është nënkuptuar. Në qoftë se çështja është për çlirim një herë e përgjithmonë nga mëkati, atëherë ju e dini se është koha e kryer e shpëtimit.

Koha e tashme

Megjithëse është e vërtetë se jam shpëtuar, është njëloj e vërtetë se po shpëtohem ditë për ditë. Unë jam shpëtuar nga mallkimi; unë po shpëtohem nga pasojat e mëkatit. Unë jam shpëtuar nga dënimi i mëkatit; unë po shpëtohem nga fuqia e mëkatit. Unë jam shpëtuar nëpërmjet veprës së kryer të Krishtit në Kryq; unë po shpëtohem nëpërmjet jetës së Tij dhe shërbimit të Tij që Ai bën për mua në krahun e djathtë të Perëndisë. Për shembull, kjo është çfarë nënkuptohet në Romakëve 5:10:

Në fakt, ndërsa ishim armiq, u pajtuam me Perëndinë nëpërmjet vdekjes së Birit të Tij, akoma më shumë tani, që jemi pajtuar, do të shpëtohem nëpërmjet jetës së Tij.

Koha e tashme e shpëtimit është e ngjashme me shenjtërimin, d.m.th. procesin e të qenit i ndarë nga mëkati e ndyrësia për Perëndinë. Ky shpëtim është një proces në vazhdimësi, për të cilin lexojmë në Hebrejve 7:25:

Prandaj edhe mund të shpëtojë plotësisht ata që me anë të Tij i afrohen Perëndisë, sepse gjithmonë rron që të ndërmjetësojë për ta.

Koha e ardhme

Së fundi, është aspekti i ardhshëm i shpëtimit. Kur të takojmë Shpëtimtarin ballë për ballë ne do të shpëtohem nga prania e mëkatit. Trupat tanë do të shpengohen dhe përlëvdohen. Vargjet e mëposhtme përshkruajnë të ardhmen e lavdishme të shpëtimit tonë.

... sepse shpëtimi ynë është më afër, se kur besuam (Rom. 13:11).

Kurse ne, mbasi jemi të ditës, jemi të esëll, duke veshur parzmoren e besimit dhe të dashurisë dhe për përkrenare shpresën e shpëtimit. Sepse Perëndia nuk na ka caktuar për zemërim, por për të marrë shpëtimin me anë të Zotit tonë Jezu Krisht (1 Thes.5:8, 9).

... do të duket për së dyti pa mëkat për ata që e presin për shpëtim (Heb. 9:28).

(Ju) që nga fuqia e Perëndisë me anë të besimit jeni të ruajtur, për shpëtimin gati për t'u zbuluar në kohët e fundit (1 Pje. 1:5).

Të tri kohët

Në qoftë se keni vështirësi në përshtatjen e një vargu në një nga këto klasifikime, kujtoni se mund të jetë i zbatueshëm në të tri kohët. Ja dy shembuj:

... ti do t'i vësh emrin Jezus, sepse Ai do të shpëtojë popullin e Tij nga mëkatet e tyre (Mat. 1:21).

Në Të edhe ju, pasi e dëgjuat fjalën e së vërtetës, ungjillin e shpëtimit tuaj dhe pasi besuat, u vulosët me Frymën e Shenjtë të premtimit (Ef. 1:13).

Kështu në këto raste ju nuk duhet të zgjidhni, sepse ato i aplikohen me forcë të njëjtë të tri fazave të shpëtimit.

ASPEKTET E SHFAJËSIMIT

Dhiata e Re na mëson se jemi shfajësuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, me anë të gjakut, me anë të fuqisë dhe nëpërmjet veprave. Kjo mund të na ngatërrojë dhe mund të na duket kontradiktuese, po qe se nuk kuptojmë se në secilin rast po paraqitet një aspekt i ndryshëm i të njëjtës temë.

Para së gjithash, çdo të thotë të shfajësohesh? Të shfajësosh do të thotë të konsiderohesh i drejtë. Nuk do të thotë të bëhesh i drejtë, por të deklarohesh se je i drejtë. Në fakt është term ligjor që është marrë nga gjykatat.

Ne vetë nuk jemi të drejtë në vetvete. Ne nuk kemi aspak drejtësi. Por kur marrim Jezu Krishtin si Zot dhe Shpëtimtar, Perëndia na deklaron të jemi të drejtë në bazën e veprës zëvendësuese të Krishtit. Kur jemi «në Krishtin», Perëndia me të drejtë na deklaron të drejtë, sepse në Kalvar është bërë pagesa e plotë për mëkatet tona. Mëkatari që beson është veshur me të gjithë drejtësinë e Perëndisë. «Sepse Ai (Perëndia) bëri të jetë mëkat për ne Ai (Krishti) që nuk njihete mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në Të» (2 Kor. 5:21).

Siç e përmendëm në fillim, shfajësimi është me anë të hirit, nëpërmjet besimit, me anë të gjakut, me anë të fuqisë dhe nëpërmjet veprave. Si është e mundur të jetë nëpërmjet të gjitha këtyre pesë mënyrave?

Së pari, shfajësimi është me anë të hirit. Në Romakëve 3:24 lexojmë: «Por janë shfajësuar falas me anë të hirit të Tij, nëpërmjet shpengimit që është në Krishtin Jezus». Kjo do të thotë se njeriu nuk meriton të shfajësohet. Ai nuk mund ta meritojë ose ta fitojë atë; ai duhet ta marrë atë si dhuratë. Hiri është kushti mbi të cilin Perëndia i jep shfajësimin njeriut—krejtësisht i pamërituar dhe që nuk mund të blihet—falas si dhuratë.

Së dyti, shfajësimi është nëpërmjet besimit. «Të shfajësuar, pra, me anë të besimit, kemi paqe me Perëndinë nëpërmjet Jezus Krishtit, Zotit tonë» (Rom. 5:1). Kjo do të thotë se mëkatari duhet ta marrë shfajësimin nëpërmjet një veprimi të prerë, d.m.th. besimi në Shpëtimtarin. Duke pohuar vetë se meriton ferrin, ai duhet ta pranojë Zotin Jezus si të Vetmin që pagoi dënimin për mëkatet e tij në Kryq.

Hiri është Perëndia që vjen te njeriu fajtor dhe që i ofron shfajësimin si një dhuratë falas në bazë të veprës shpenguese të Krishtit në Kalvar. **Besimi** është njeriu që pendohet dhe shtrin dorën duke marrë dhuratën nga Perëndia pa pasur ndonjë mendim se e meriton atë nëpërmjet karakterit të tij ose se e meriton atë nëpërmjet veprave të tij.

Shfajësimi është gjithashtu me anë të **gjakut**. «Shumë më tepër, pra, duke qenë tani të shfajësuar në gjakun e Tij, do të shpëtojmë nga zemërimi me anë të Tij» (Rom. 5:9). Natyrisht, kjo i referohet çmimit që duhej të paguhej me qëllim që unë të shfajësohesha. Shpëtimtari pamëkat derdhi gjakun e Tij të çmuar për të paguar borxhin që kishin grumbulluar mëkatet e mia. Vlera e pallogaritshme e shfajësimit tim shihet në çmimin marramendës që u pagua për ta siguruar atë.

Ndërsa nuk ka shumë pjesë nga Shkrimi ku thuhet me shumë fjalë se jemi të shfajësuar me anë të **fuqisë**, e vërteta gjendet në Romakëve 4:25: «(Ai) u dha për shkak të fyerjeve tona dhe u ringjall për shfajësimin tonë». Këtu justifikimi ynë është lidhur direkt me ringjalljen e Krishtit. Dhe pikërisht kështu! Po të mos ishte ringjallur, besimi ynë do të ishte i kotë dhe ne akoma do të ishim në mëkatet tona (1 Kor. 15:17). Kështu shfajësimi ynë është lidhur pandashëm me fuqinë që ngriti Zotin Jezus nga të vdekurit. Për këtë arsye themi se ne jemi shpëtuar me anë të fuqisë së tij.

Së fundi, ne shfajësohemi nëpërmjet **veprave**. «Ju shikoni, pra, se njeriu shfajësohet nga veprat dhe jo vetëm nga besimi» (Jakobi 2:24). Këtu duket sikur gjejmë një kontradiktë të

dallueshme. Apostulli Pal na mëson pa gabim se ne shfajësohemi vetëm nëpërmjet besimit. Por Jakobi duket se po thotë këtu: «S'është ashtu. Ne shfajësohemi nëpërmjet besimit dhe nëpërmjet veprave». Sidoqoftë, nuk është ashtu. Ai nuk po na mëson se shfajësimi merret fillimisht nëpërmjet bërjes së veprave të mira. Dhe nuk po thotë se shfajësohemi nëpërmjet besimit plus veprat. Ajo çfarë ai po thotë është se ne jemi shfajësuar nëpërmjet atij lloj besimi që rezulton në një jetë me vepra të mira.

Është e kotë për një njeri të thotë se ka besim në qoftë se ai nuk ka vepra për ta mbështetur atë. Ai lloj besimi—domethënë, një besim vetëm i fjalëve, është i padobishëm (Jakobi 2:14-17). Besimi i vërtetë është i padukshëm, por mund të duket nëpërmjet veprave (Jakobi 2:18). Abrahami u shfajësua nëpërmjet besimit në Zotin (Zan. 15:6), por vite më vonë ai tregoi se besimi i tij ishte i vërtetë duke mos hezitur për të flijuar birin e tij Isakun si ofertë (Zan. 22:9-14). Rahabi e provoi vërtetësinë e besimit të saj duke strehuar spiunët izraelitë dhe duke i ndihmuar ata të arratiseshin (Jakobi 2:25). Kështu, kur flasim për shfajësimin nëpërmjet veprave, ne nënkuptojmë se veprat janë manifestimi i jashtëm duke treguar se ne me të vërtetë jemi shfajësuar nëpërmjet besimit. Veprat nuk janë shkak, por ato janë pasoja. Ato nuk janë rrënja, por ato janë fruti.

Duke i bashkuar të gjitha këto së bashku, zbulojmë se Dhiata e Re na mëson se shfajësohemi nëpërmjet:

hirit—kjo do të thotë se nuk e meritojmë atë.

besimit—kjo do të thotë se ne duhet ta marrim atë.

gjakut—kjo do të thotë se është blerë me vdekjen e Shpëtimtarit.

fuqisë—kjo do të thotë se Ringjallja provon kënaqësinë e Perëndisë me veprën e Shpëtimtarit.

veprave—kjo do të thotë se kur ne me të vërtetë shfajësohemi nëpërmjet besimit, atëherë do të kemi vepra të mira që do ta provojnë atë.

Të gjitha këta aspekte janë shprehur poetikisht më poshtë:

Hir' sovran i Zotit m'zgjodhi
N'qiell për të shkuar;
Ishte vullnet' i mir' i Tij;
N'hirin jam shfaj'suar.

Kur Krishti në Kalvar vdiq;
Rrym' gjaku vërshoi
Që e bën njollën t'bardhë si bor';
Gjaku m'shfajësoi.

Perëndia e ngriti Atë,
Dyshimet e t'ligut largoi
Ngritja e Tij çdo frik' shuan;
Fuqia m'shfaj'soi.

Fryma e Shenjt' m'drejtoi
Shkrimin më mësoi;
Do të tregoj se jam i Tij;
Vepra m'shfajësoi.

Lavdi Zotit: gjithçka prej Tij,

Hiri, gjaku, besimi
Fuqi e ngritjes, e veprat;
Prej Zotit shfaj'simi!

—Helen H. Shaw

ASPEKTE TË JETËS SË PËRJETSHME

Cilësia e jetës

Jeta e përjetshme nuk është e njëjtë si ekzistenca e pafund. Gjithkush, i shpëtuar dhe i pashpëtuar, do të jetojë përgjithmonë, por vetëm besimtarët kanë jetë të përjetshme. Nuk është vetëm gjatësi jete, por është edhe një cilësi gjithashtu. Është jeta e Vetë Perëndisë, asgjë më pak se bashkim me Perëndinë dhe Zotin Jezus.

Dhe jeta u shfaq dhe ne e pamë e dëshmojmë për të dhe ju shpallim jetën e përjetshme që ishte pranë Atit dhe që na u shfaq neve (1 Gjoni 1:2. Shihni gjithashtu 1 Gjoni 5:20).

Në gjendjen e tij te pafajshme pa mëkat, Adami nuk kishte jetë të përjetshme. Përderisa nuk do të mëkatonte, ai do të kishte vazhduar të shijonte ekzistencën në tokë, por nuk do ta kishte patur shpresën e përlëvdimit me Krishtin në qiell. Dhe gjithmonë ekzistonte mundësia e tmerrshme e mëkatimit dhe kështu të vdiste—gjë që pikërisht ndodhi. Ishte atëherë kur ai besoi në Zotin si Shpëtimtar që ai mori jetë të përjetshme, me të gjitha bekimet e përjetshme të përfshira në të.

Shpeshherë jeta e përjetshme i referohet gjendjes së tanishëm dhe herë të tjera si shpresës së trashëgimisë të ardhshme.

Një zotërim i tanishëm

Ajo është një dhuratë e zotëruar nga besimtarët në të tashmen. Kjo dhuratë është premtuar nga Zoti (1 Gjoni 2:25) dhe gjendet në Të (Gjoni 6:68; 1 Gjoni 5:11). Kjo merret nëpërmjet besimit në Të:

Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Kush beson në mua ka jetë të përjetshme (Gjoni 6:47. Shihni gjithashtu Gjoni 3:15-16; 5:24; 6:40; 1 Tim. 1:16).

Shprehje të tjera, që janë të njëjta si besimi në Të, janë e pira e ujit që Ai jep (Gjoni 4:14); ngrënia e mishit dhe e pira e gjakut të Tij (Gjoni 6:54); ndjekja e Tij (Gjoni 10:27); dhe njohja e Tij (Gjoni 17:3). Gjoni thotë se vrasësit nuk kanë jetë të përjetshme (1 Gjoni 3:15), por ai mund ta thoshte këtë edhe për të gjithë mëkatarët gjithashtu.

Jeta e përjetshme është dhuratë nga Ati (Rom. 6:23; 1 Gjoni 5:11). Jeta e përjetshme jepet gjithashtu edhe nga Biri.

Delet e mia e dëgjojnë zërin tim, unë i njoh dhe ato më ndjekin; e askush nuk do t'i rrëmbejë nga dora ime. Ati im, që m'i dha, është më i madh se të gjithë; dhe askush nuk mund t'i rrëmbejë nga dora ime (Gjoni 10:27-28. Shihni gjithashtu Gjoni 17:2).

Gjithçka që Jezusi foli kishte në qendër dhënien e jetës së përjetshme (Gjoni 12:50).

Të gjithë që kanë jetën e përjetshme besojnë (Veprat 13:48); d.m.th., kjo është një anë e të vërtetës. Tjetra anë është se ata që refuzojnë të besojnë kështu e konsiderojnë veten të padenjë për jetën e përjetshme (Veprat 13:46). Kjo jetë jepet nga hiri (Rom. 5:21) dhe të gjithë ata që besojnë mund ta dinë se e kanë jetën e përjetshme sipas autoritetit të Fjalës së Perëndisë:

Jua shkrova këto gjëra juve që besoni në emrin e Birit të Perëndisë, që të dini se keni jetën e përjetshme dhe që të besoni në emrin e Birit të Perëndisë (1 Gjo. 5:13)

Ata që kanë jetë të përjetshme duhet ta ushtrojnë atë në praktikë çdo ditë.

Lufto luftën e drejtë të besimit, rrok jetën e përjetshme, në të cilën u thirre dhe për të cilën ke bërë rrëfimin e mirë të besimit përpara shumë dëshmitarëve (1 Tim. 6:12).

...Duke mbledhur si thesar një themel të mirë për të ardhmen, për të arritur jetën e përjetshme (1 Tim. 6:19. Shihni gjithashtu Gjoni 6:27).

Shpresë në të ardhmen

Krahas të qenit një zotërim në të tashmen, jeta e përjetshme është gjithashtu diçka në kohën e ardhme:

Në shpresën e jetës së përjetshme, të cilën Perëndia, që nuk gënjen, e premtoi para të gjitha kohërave (Titit 1:2).

Mbajeni njëri-tjetrin në dashurinë e Perëndisë, duke kërkuar mëshirën e Zotit Jezus Krisht për jetën e përjetshme (Juda 21).

Kjo i referohet jetës së përjetshme në kuptimin e plotë të saj, kur besimtari të jetë përgjithmonë i çliruar nga mëkati, sëmundjet, dëshpërimi dhe vdekja. Kjo i referohet gjendjes së përlëvduar në fund.

Shpeshherë jeta e përjetshme përdoret si diçka që një person e zotëron:

Dhe kushdo që ka lënë, për hir të emrit Tim, shtëpi, vëllezër, motra, atë, nënë, grua, bij ose ara, do të marrë njëqindfish dhe do të trashëgojë jetë të përjetshme (Mat. 19:29. Shihni gjithashtu Marku 10:29-30; Lluka 18:20).

...Të shfajësuar me anë të hirit të Tij, të bëhemi trashëgimtarë të jetës së përjetshme, sipas shpresës që kemi (Titit 3:7).

Nuk fitohet me vepra

Gjenden vargje të tjera që tingëllojnë se jeta e përjetshme fitohet nëpërmjet sjelljes së personit në tokë. Vargjet të tilla janë Mateu 25:45-46; Lluka 18:29-30; Gjoni 4:36; 12:25; Romakëve 2:7; Galatasve 6:8. Sidoqoftë, vetëm këta vargje nuk mund të hedhin poshtë të vërtetën e shpëtimit nëpërmjet hirit, si dhuratë, që merret vetëm me anë të besimit dhe që nuk ka të bëjë aspak me veprat.

Atëherë ç'kuptim kanë këto vargje shqetësuese? Kjo na bën të kujtojmë se do të ketë nivele të ndryshme të shpërblimit në parajsë. Në gjykimin e Krishtit, disa do të marrin kurora, të tjerë do të pësojnë humbje. Megjithatë të gjithë besimtarët do të kenë jetë të përjetshme, jo të gjithë do ta përjetojnë atë në të njëjtën mënyrë (1 Kor. 15:41b). Kjo përcaktohet që këtu nga besnikëria në shërbimin e Zotit (Gal. 6:8) dhe nga përparimi në shenjtëri (Rom. 6:22).

Veprat e mira që përmenden në këto vargje shqetësuese janë fryt i jetës së përjetshme në atë person dhe jo mënyra për ta fituar atë. Për shembull, në Mateun 25:46 kur thotë: «Dhe ata që shkojnë në mundim të përjetshëm dhe të drejtët në jetën e përjetshme», na mëson se ata që janë në anën e vëllezërve Izraelitë gjatë periudhës së Shtrengimit të Madh me të vërtetë janë shpëtuar dhe shpërblehen duke e shijuar jetën e përjetshme. Veprat e tyre të mira janë prova e

jetës së përjetshme në ata.

Gjoni 4:36; 12:25 i referohen shpërblimit për shërbimin besnik dhe nuk janë mjet për të fituar shpëtimin.

Korrësi e merr shpërblimin dhe mbledh frytin për jetën e përjetshme, që mbjellësi dhe korrësi të gëzohen sëbashku.

Kush e do jetën e vet do ta humbasë; dhe kush e urren jetën e vet në këtë botë, do ta ruajë për jetën e përjetshme.

Romakëve 2:7 është një varg i vështirë për shumë njerëz.

...Jetë e përjetshme atyre që kërkojnë lavdi, nder e pavdekësi... (Rom. 2:7)

Në pamje të parë, kjo duket sikur jeta e përjetshme bazohet në të qenit i mirë ose ti bën vepra të mira. Shkrimet e Shenjta e hedhin poshtë këtë interpretim. Ekzistojnë dy mënyra për ta kuptuar këtë siç duhet biblikisht. Së pari, kjo është një ideal në teori, një standard nëpërmjet të cilit Perëndia do të gjykojë jobesimtarët. Po të ishte e mundur për jobesimtarin ta bënte këtë, me fuqinë e tij, të vazhdonte pa përjashtim në të bërët mirë, atëherë ai do të shpërblehej me jetë të përjetshme. Por, sigurisht, kjo është e pamundur. «Askush nuk bën mirë, jo, asnjë» (Rom. 3:12c). Së dyti, mund të jetë se vetëm besimtarët, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, mund ta plotësojnë këtë përshkrim. Dhe në këtë rast, natyrisht, veprat e mira janë fryt i shpëtimit dhe jo burim i tij.

Përmbledhje

Jeta e përjetshme është një jetë frymërore e marrë nëpërmjet rilindjes. Është jeta e Vetë Perëndisë, e përjetshme ashtu si Vetë Ai. Ajo është diçka që e zotërojmë tani dhe gjithashtu është një shpresë në të ardhmen. Ai që vërtet beson në Krishtin mund ta dijë me siguri se e ka jetën e përjetshme sipas autoritetit të Fjalës së Perëndisë. Siguria e shpëtimit vjen nga Shkrimet e Shenjta.

Besimtari pret me padurim për jetën e përjetshme dhe të gjitha gjërat që i takojnë. Kjo njihet si shpengimi i trupit.

Kur flasim për jetën e përjetshme në lidhje me shpërblimet, ajo mund të nënkuptojë se është një shpërblim për shenjtërim, shërbim ose vepra të mira. Shpërblimet jepen si rezultat që je treguar besnik ndaj ndryshimit që jeta e Krishtit bën në jetën e besimtarit.

SHLYERJA E MËKATEVE ATËHERË DHE TANI

Shlyerja është një nga fjalët mahnitëse të Biblës me një përdorim të gjerë. Kuptimi i kësaj fjale duhet të përcaktohet në kontekstin e saj në Shkrimet e Shenjta. Ne e mësojmë kuptimin e kësaj fjale nga përdorimi i saj.

Para se të shqyrtojmë këtë, le t'i kujtojmë vetes tonë mënyrën e shpëtimit në Dhiatën e Vjetër. Njerëzit u shpëtuan kur ata besonin në Zotin. Kur Perëndia ua shfaqte Vetën atyre, ata besonin në Të dhe kjo u konsiderohej drejtësi. Kështu kur Perëndia i premtoi Abrahamit pasardhës të panumërt sa yjet në qiell, patriarku «i besoi Zotit, që ia vuri në llogari të drejtësisë» (Zan. 15:6). Abrahami u shfajësua në bazë të veprës së Krishtit akoma në të ardhmen. Abrahami mund të mos ketë patur njohuri për këtë punë, por Perëndia kishte njohuri për të dhe ia vuri gjithë vlerën e saj në llogarinë e Abrahamit. Zoti i siguroi atij falje juridike për të gjitha mëkatet e tij në bazë të gjakut të çmuar të derdhur në kryqin e Kalvarit. Shpëtimi në çdo epokë është me anë të shpëtimit në Zotin dhe në bazë të veprës së Zotit Jezus për ne. Kështu fillon një marrëdhënie e përjetshme.

Sidoqoftë, mëkatet që një Izraelit bënte pas besimit në Zotin, prishnin bashkësinë me Perëndinë dhe e bënë atë të papastër. Gjithashtu edhe veprime të tjera (si prekja e një trup të vdekur) e cila, megjithëse jo e mëkatshme, e bënte atë të papastër nga mënyra ceremoniale. Këto gjëra e bënë atë të mos merrte pjesë në adhurimin në tabernakull apo në tempull. Këtu nevojitej shlyerja e mëkatit, kështu tani le ta shqyrtojmë këtë çështje.

Kuptimi në Dhiatën e Vjetër

Në Dhiatën e Vjetër shlyerja vjen nga një fjalë Hebraike me kuptimin «mbulesë»¹. Kështu kur Perëndia i tha Noeut të mbulonte arkën me bitum nga brenda dhe jashtë, Ai përdori të njëjtën rrënjë të fjalës së përkthyer «të shlysh». Shlyerja është një mbulesë për mëkatin deri në trajtimin e tij të plotë e të përkryer, përfundimisht në veprën e Krishtit në kryqin e Kalvarit.

Në disa raste të tjera, fjala «të shlysh» mund të nënkuptojë të dekretosh, të pastrosh, të nxjerrësh nga dënimi dhe të shenjtërosh.

Zakonisht ajo përdorej si referim për njerëzit, priftërinjtë dhe kombin e Izraelit. Por pothuajse asnjëherë nuk ka marrë kuptimin heqjes së mëkateve, d.m.th. pagimin për to. Shkruesi i Hebrenjve e bën të qartë se flijimet nuk hoqën as edhe një mëkat të vetëm. Në qoftë se kuptimi parësor i shlyerjes së mëkateve ishte heqja e mëkatit, atëherë flijimet ishin të kota. «Sepse është e pamundur që gjaku i demave dhe i cjepeve të heqë mëkatet» (Heb. 10:4). Çdo vit në Ditën e Shlyerjes së Mëkateve bëhej kujtimi i mëkateve (Heb. 10:3). Për këtë arsye, sistemi i flijimeve asnjëherë nuk u dha njerëzve një ndërgjegje të pastër në lidhje me mëkatet. «Sepse përndryshe do të kishin pushuar t'i ofronin, sepse ata që e ushtrojnë kultin, si të pastroheshin një herë, a nuk do të kishin më asnjë vetëdije për mëkatet?» (Heb. 10:2).

Disa herë shlyerja bëhej edhe për sendet: altarin, vendin e shenjtë, shenjtoren, tabernakullin e mbledhjeve dhe tempullin. Është e qartë që kjo nuk kishte të bënte fare me heqjen e mëkateve, meqë sendet nuk mëkatojnë. Një altar, për të cilin ishte bërë shlyerje, ishte një altar i përshtatshëm për t'u përdorur për shërbim hyjnor ngaqë ishte i pastër ritualisht. Çfarëdo përkufizimi tjetër, që nuk jep shpjegim për shlyerjen e «sendeve» të ndryshme, nuk është i saktë.

Kur është përdorur për njerëzit, shlyerja kishte të bënte me pastrimin ceremonial. Kur një besimtar Izraelit mëkatonte dhe pastaj sillte flijimin e kërkuar, ai në fakt po rrëfente mëkatin

e tij. Sapo të rrëfente, ai falej. Falja nuk vinte nga kafsha e flijuar, por nëpërmjet flijimit të Krishtit, të cilin ajo simbolizonte. Dënimi i përjetshëm për mëkatën e tij anulohet kur ai të besonte në Zotin, por rrëfimi rinonte bashkësinë e tij me Perëndinë. Flijimi, që ai sillte, siguronte paraqitjen e jashtme për pjesëmarrje ose përdorim në adhurimin dhe shërbimin ndaj Jehovahës. Ai tashmë ishte në marrëdhënie besëlidhjeje me Perëndinë, por tani bëhej i pastër ritualisht. Flijimet Levitike shenjtëronin për pastrimin e mishit², domethënë, ata siguronin një pastrim ritual të jashtëm. Vetëm vepra e Krishtit mund ta pastronte ndërgjegjen nga veprat e kota për t'i shërbyer Perëndisë së gjallë.³

Një përjashtim

Të paktën njëherë në Dhiatën e Vjetër kjo fjalë është përdorur në mënyrë të qartë në kuptimin për të hequr mëkatën. «Shtatëdhjetë javë janë caktuar për popullin tënd dhe për qytetin tënd të shenjtë, për t'i dhënë fund shkeljes, për t'i dhënë fund mëkatit, për të sjellë pajtim për paudhësinë, për të sjellë një drejtësi të përjetshme, për të vulosur vegimin dhe profecinë, për të vajosur Vendin shumë të Shenjtë» (Dan. 9:24). Në këtë varg, shprehja për të sjellë pajtim për paudhësinë do të thotë fjalë për fjalë të shlysh për ligësi (kështu është përkthyer në versione të tjera të Biblës). Përkthyesit e Versionit King Xheims në anglisht deshën t'i shmangeshin sugjerimit se vepra e Krishtit veçse mbuloi mëkatet, kështu ata e përkthyen atë për të sjellë pajtim për paudhësinë.

Kjo na drejton te Ardhja e Dytë e Zotit Jezus kur të marrë fund ligësia e popullit të Tij, Izraelit. Në fakt, flijimi i duhur për këtë u bë në kryqin e Kalvarit, por i tërë Izraeli nuk do t'i shijojë të mirat e kryqit deri kur ata të kthehen te Ai, të cilin kryqëzuan dhe të vajtojnë për Të ashtu si dikush vajton për birin e tij të vetëm. Çdo shlyerje e përmendur në Dhiatën e Vjetër është trajtuar plotësisht dhe përfundimisht në Kryq.

Kuptimi i fituar sot

Shlyerja nuk është një fjalë e Dhiatës së Re. Kuptimi i shlyerjes në Dhiatën e Vjetër nuk gjendet në Dhiatën e Re. Nuk kemi as edhe një rast të shlyerjes së bërë për njerëzit ose për sendet.

Në ditët tona, fjala shlyerje ka fituar një kuptim të ri. Kur bëjmë fjalë për shlyerjen e mëkateve nga Krishti, ne nënkuptojmë pagesën e bërë për mëkatet tona nëpërmjet vdekjes, varrosjes dhe ringjalljes së Tij. Në shërbesë apo në këngë, ne ngazëllohemi se nëpërmjet gjakut të Tij shlyes, d.m.th. mëkatet janë paguar njëherë e përgjithmonë. Por ky kuptim është një çështje përdorimi dhe nuk ka asnjë lidhje me kuptimin bazë të kësaj fjale.

Do të na ndihmonte së tepërmi në zgjidhjen e shumë keqkuptimeve po të bënim dallimin midis kuptimit të kësaj fjale në Dhiatën e Vjetër dhe kuptimit të fituar sot nëpërmjet përdorimit të saj. Nuk është aspak gabim të flasim për shlyerjen e mëkateve nga Krishti, për sa kohë që ne e kuptojmë se vepra e Tij ishte e përkryer, përfundimtare dhe e përbrendshme, ndërsa shlyerja në Dhiatën e Vjetër ishte, me një përjashtim të vetëm, e papërkryer, e përsëritur dhe e jashtme.

Shlyerja në Mbretërinë

Kjo fjalë është përdorur nga Ezekieli në lidhje me shërbimet në të ardhmen në tempullin⁴, në Mijëvjeçarin. Duke patur parasysh Mbretërinë, Ezekieli flet për shlyerjen e bërë për altarin, për njerëzit, d.m.th. shtëpinë e Izraelit dhe për tempullin. Kjo përbën një problem për disa. Kjo duket sikur kontradikton Hebrenjve 10:12: «Përkundrazi, Ai pasi dha për gjithnjë një flijim të vetëm për mëkatet, u vu të rrijë në të djathtën e Perëndisë» dhe Hebrenjve 10:18: «Edhe atje ku ka ndjesë të këtyre gjërave, nuk ka më ofertë për mëkatën».

Problemi qëndron në atë se ne i japim kësaj fjale kuptimin e fjalorit të sotëm modern dhe jo kuptimin bazë të Dhiatës së Vjetër. Nuk ka as edhe një sugjerim se flijimet në tempullin e

mijëvjeçarit do të kenë efekt për të hequr fajin dhe dënimin e mëkatit si në epokën e Dhiatës së Re. Ata do të jenë thjeshtë pjesë e riteve në tempull. Gjatë këtyre ceremonive, Izraeli i shpenguar do ta vërë re dobësinë e këtyre riteve, të krahasuara me përsosmërinë e veprës së Krishtit. Ata do ta kuptojnë se ritet ishin hije të realitetit, ndërsa Krishti është realiteti. Ashtu sikurse flijimet shlyese të Dhiatës së Vjetër na drejtojnë te vepra e Krishtit, ashtu edhe ato të mijëvjeçarit do të na drejtojnë pas te kryqi i Kalvarit, ashtu si Darka e Zotit për ne sot. Ata do të jenë përkujtime.

Shënime

1. Folja është kaphar, e cila tingëllon në koincidence si përkthimi në anglisht «cover», d.m.th. «kavër» në shqip. Forma e emrit ekziston akoma në festën izraelite, Yom Kippur, e përkthyer fjalë për fjalë «Dita e Mbulesës» (Shlyerjes).

2. Hebrenjve 9:13.

3. Hebrenjve 9:14.

4. Ezekieli 43:20, 26; 45:15, 17, 20.

POZITA DHE PRAKTIKA

Nuk ka asnjë çelës tjetër më të dobishëm për të zbërthyer Dhiatën e Re sesa të kuptosh ndryshimin midis pozitës së besimtarit dhe praktikës së tij. Po qe se nuk e vini re këtë dallim, do të ndodhë që pjesë të ndryshme do t'ju ngatërrojnë dhe madje mund t'ju duken edhe kontradiktuese.

Ndonjëherë për pozitën dhe për praktikën flitet si qëndrim dhe gjendje; kuptimi është i njëjtë. Shkurtimisht, pozita e një të krishteri është qëndrimi i tij në Krishtin—çfarë ai është në Krishtin. Praktika e tij është çfarë vetë ai është në vetvete—ose më mirë, çfarë duhet të jetë. E para ka të bëjë me doktrinë, e dyta me detyrë.

Gjendet një ndryshim midis asaj çfarë një besimtar është në Krishtin dhe çfarë ai është në vetvete. Hiri i ka dhënë njeriut në Krishtin një qëndrim absolut të përsosur para Perëndisë. Ai është pranuar në të Dashurin, Birin e Perëndisë (Ef. 1:6) dhe është bërë i plotë në Krishtin (Kol. 2:10). Mëkatet i janë falur dhe ai është veshur me të gjithë drejtësinë e Perëndisë (2 Kor. 5:21). Nuk është aspak hezitim për të të thënë:

Afër, kaq afër Perëndis',
S'ka më afër më;
Sepse n'Birin e Perëndis'
Jam aq afër sa Ai.

I dashur, kaq shumë prej Zotit
Më tepër s'mund t'ketë;
Me dashurin' e Birit t'Tij,
Ai më deshi vërtet.

Praktika e besimtarit është diçka tjetër përsëri. Fatkeqësisht, është shumë larg nga të qenët i përsosur. Në shumicën e rasteve ajo ndryshon nga dita në ditë. Ndonjëherë besimtari është shpirtërisht në majën e malit. Herë të tjera ai mund të jetë në luginat e mposhtjes.

Vullneti i Perëndisë është që praktika jonë të korrespondojë gjithnjë në rritje me pozitën tonë. Nga dashuria për Atë që vdiq për ne, jetët tona të përditshme duhet të jenë gjithnjë në rritje në ngjashmërinë e Krishtit. Natyrisht, ne kurrë nuk do të arrijmë një gjendje të përsosur në këtë jetë; ajo kurrë nuk do të ndodhë derisa të vdesim ose deri kur të vijë Shpëtimtari. Por procesi duhet të vazhdojë; ne duhet të bëhemi në praktikë gjithnjë e më tepër çfarë jemi në pozitë.

Kur të shohim Shpëtimtarin, ne do të jemi automatikisht si Ai (1 Gjoni 3:2). Ky transformim do të ndodhë nga fuqia hyjnore, pa bashkëpunimi tonë. Por i sillet më tepër lavdi Perëndisë, po qe se njerëzit e Tij rriten në ngjashmërinë e Zotit Jezus në këtë jetë.

Si mund ta dallosh nëse një pjesë e veçantë po bën fjalë për pozitën apo për praktikën tonë? Shihni për fraza të tilla si: «në Krishtin», «në të Dashurin», ose «në Të». Kur gjeni të tilla fraza, zakonisht mund të jeni të sigurt se shkrimtari po flet rreth pozitës sonë (shihni Ef. 1:3-14). Mënyra më e mirë për ta identifikuar praktikën tonë është të vëmë re, kur gjejmë një varg, që na tregon se çfarë duhet të jemi ose çfarë duhet të bëjmë.

Rregulli i pandryshueshëm në Dhiatën e Re është të gjejmë pozitën të parën, pastaj praktikën. Shumë nga Letrat janë në strukturën e këtij rregulli. Për shembull, në Efesianët tre kapitujt e parë përshkruajnë atë çfarë jemi në Krishtin; tre të fundit përshkruajnë atë çfarë duhet të jemi në jetën tonë të përditshme. Në tre kapitujt e parë e gjejmë veten në vende

qiellore në Krishtin; në tre të fundit po mundohemi me problemet e përditshme të shtëpisë dhe të botës së biznesit.

Tani le të shohim se sa e dobishme është të jesh i vetëdijshëm për këtë dallim, ndërsa studiojmë Dhiatën e Re. Këta janë disa shembuj të thjeshtë të ndryshimit midis pozitës dhe praktikës.

Pozita

Praktika

Shembulli 1

Sepse me një ofertë të vetme, Ai bëri të përsosur për gjithnjë ata që shenjtërohen (Heb. 10:14).	Jini pra të përkryer, ashtu siç është i përsosur Ati juaj, që është në qiej (Mat. 5:48).
---	---

Vargu i parë tregon se të gjithë besimtarët janë të përsosur; i dyti tregon se besimtarët duhet të jenë të përsosur. Kjo do të tingëllonte si një gjë e dyfishtë, po të mos kuptonim se e para flet për qëndrimin dhe e dyta për gjendjen tonë.

Shembulli 2

Ne që jemi të vdekur për mëkatin, si do të jetojmë akoma në të? (Rom. 6:2).	Kështu edhe ju konsiderojeni veten të vdekur për mëkatin (Rom. 6:11).
--	--

Ju jeni të vdekur për mëkatin—kjo është pozita në të cilën hiri ju ka vënë. Tani konsiderojeni veten të vdekur për mëkatin çdo ditë—kjo duhet të jetë praktika juaj.

Shembulli 3

Por të gjithë atyre që e pranuan, Ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e Tij (Gjoni 1:12).	Bëhuni pra imitues të Perëndisë, si bij shumë të dashur (Ef. 5:1).
--	---

Sapo një person të lindë përsëri, ai bëhet një fëmijë i Perëndisë. Duke filluar që atëherë ai duhet të jetë një ndjekës i Perëndisë si një fëmijë i dashur. Të gjithë ata që janë fëmijë të Perëndisë duhet të shfaqin ngjashmërinë e familjes, domethënë, të jenë të perëndishëm.

Shembulli 4

Besnik është Perëndia, nga i cili jeni thirrur në bashkësinë e Birit të Tij Jezus Krishtit, Zotit tonë (1 Kor. 1:9).	Unë ... ju bëj thirrje që të ecni denjësisht sipas thirrjes për të cilën u thirrët (Ef. 4:1).
---	--

Ne jemi thirrur në një bashkësi të mrekullueshme. Privilegji përmban edhe përgjegjësi. Ne duhet të ecim të denjë sipas thirrjes.

Shembulli 5

Për ju të gjithë që jeni në Romë, të dashur nga Perëndia, të thirrur shenjtorë (Rom. 1:7)	Që ta pranoni në Zotin, sikurse u ka hije shenjtorëve... (Rom. 16:2).
--	--

Pali u drejtohet të krishterëve në Romë si shenjtorë; ata ishin «të ndarët mënjanë». Pra, një njeri i shpëtuar është një shenjtor. Por shenjtorët duhet të jenë të shenjtë; kjo është ana praktike e kësaj, sikurse e nxjerrim në Romakëve 16:2.

Shembulli 6

Jeni të shpëtuar me anë të hirit nëpërmjet besimit (Ef. 2:8).	Punoni për shpëtimin tuaj me frikë dhe dridhje (Fil. 2:12).
--	--

Qëndrimi ynë është dhuratë nga Perëndia. Gjendja jonë është një mënyrë në të cilën ne duhet të shprehim mirënjohjen tonë. Vini re që qëndrimi gjithmonë është i pari, pastaj gjendja. Nuk bëhemi të krishterë nëpërmjet të jetuarit të një jete të krishterë. Por më tepër, ne jetojmë jetën e krishterë, sepse jemi bërë të krishterë.

Shembulli 7

me anë të të cilit edhe patëm, nëpërmjet besimit, hyrjen në këtë hir në të cilin qëndrojmë të patundur ... (Rom. 5:2a)	Por shpresoj, në Zotin Jezus, t'ju dërgoj së shpejti Timoteun, që edhe unë duke njohur kushtet tuaja të inkurajohem (Fil 2:19)
---	---

Hiri në të cilin qëndrojmë është pozita jonë e privilegjuar në Krishtin. Praktika jonë është gjendja e sjelljes sonë së përditshme.

Shembulli 8

Si shembull të fundit, ne do të marrim Kolosianëve 3:1-5 dhe të tregojmë sesi Pali kombinon pozitën dhe praktikën brenda një vargu.

Në qoftë se ju jeni ringjallur me Krishtin (v. 1a).	kërkoni ato që janë lart, ku Krishti është ulur në të djathtë të Perëndisë (v. 1b).
	Kini në mend gjërat që janë atje lart, jo ato që janë mbi tokë (v. 2).
Sepse ju keni vdekur dhe jeta juaj është fshehur bashkë me Krishtin në Perëndinë (v. 3).	Bëni, pra, të vdesin gjymtyrët tuaja që janë mbi tokë (v.5a).

Pali po thotë, «Ju keni vdekur; tani vdisni». «Ju jeni ringjallur; tani jetoni jetën e ringjalljes». Kështu, ajo çfarë nuk do të ishte e qartë bëhet e qartë, kur kuptojmë se Apostulli po flet për çfarë jemi në Krishtin në njërën anë dhe se çfarë duhet të jemi në veten tonë në

anën tjetër.

Në mbyllje le të ilustroj se si më ka ndihmuar mua dallimi midis pozitës dhe praktikës në një periudhë të vështirë të jetës sime. Pasi u shpëtova, dëgjoja njerëz të citonin 2 Korintasve 5:17 kur jepnin dëshminë e tyre:

Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja.

Ata tregonin për transformimin e mrekullueshëm që kishte ndodhur në jetën e tyre—sesi të gjitha gjërat e vjetra kishin shkuar dhe të gjitha gjërat ishin bërë të reja. Unë uleshja atje dhe mendoja: «Dëshiroja të thoja edhe unë se të gjitha gjërat e vjetra në jetën time kanë shkuar dhe të gjithë gjërat u bënë të reja». Por nuk ishte ashtu. Unë akoma kisha disa nga zakonet e vjetra, disa mendime të liga, shfaqje zemërimi dhe shumë gjëra të tjera që u përkisnin ditëve para shpëtimit. Në disa raste vija në dyshim shpëtimin tim.

Pastaj një ditë vura re frazën «në Krishtin» dhe zemra ime u mbush me gëzim. Kuptova se vargu fliste rreth pozitës sime—jo rreth praktikës. Dhe, natyrisht, «në Krishtin» e gjitha ishte e vërtetë. Në Të, me të vërtetë të gjitha gjërat kishin shkuar—dënimi, zotërimi i Satanit, frika nga vdekja, etj. Në Të çdo gjë ishte e re—falja, pranimi, shfajësimi, shenjtërimi dhe një mori bekimesh të tjera. Që nga ajo kohë ai varg nuk ka shfaqur ndonjë frikë për mua. Unë e dua atë. Dhe njohuria e asaj çfarë jam në Krishtin më bën të jetoj për Të si Zotin e jetës sime.

Pyetje: Edhe qëndrimi edhe gjendja gjenden në 1 Korintasve 5:7, Ef. 5:8, dhe 1 Pjetri 2:9. A mund t'i identifikoni ato?

MARRËDHËNIA DHE BASHKËSIMI

Ky studim është i ngjashëm me atë mbi pozitën dhe praktikën. Por ndryshimi është mjaft i rëndësishëm sa t'i kushtojmë një kapitull të veçantë.

Kur një person lind përsëri, një marrëdhënie e re formohet; ai bëhet fëmijë i Perëndisë.

... të gjithë atyre që e pranuan, atyre që besojnë në emrin e Tij, Ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë (Gjoni 1:12).

Shumë të dashur, tani jemi bij të Perëndisë, por ende nuk është shfaqur ç'do të jemi; por dimë se, kur të shfaqet Ai, do të jemi të ngjashëm me Të, sepse do ta shohim se si është Ai (1 Gjoni 3:2).

Tani ka diçka që është shumë vendimtare për një lindje. A keni menduar ndonjëherë rreth kësaj? Sapo një lindje të ndodhë ajo do të zgjasë përgjithmonë. Ju nuk mund të ktheheni dhe ta anuloni atë. Formohet një marrëdhënie që nuk mund të ndryshohet. Le të themi, për shembull, se i ka lindur një djalë familjes Xhëuns. Nuk ka rëndësi se çfarë mund të ndodhë, djali do të jetë gjithmonë biri i zotit dhe zonjës Xhëuns dhe ata do të jenë gjithmonë prindërit e tij. Më vonë në jetë ai mund të mos e nderojë familjen e tij dhe u shkakton atyre dhimbje të madhe. Por marrëdhënia akoma qëndron—zoti Xhëuns është akoma babai i tij dhe ai akoma është biri i zotit Xhëuns.

Tani zbatojani këtë besimtarit. Nëpërmjet lindjes së re formohet një marrëdhënie me Perëndinë Atë.

Vetë Fryma i dëshmon frymës sonë se ne jemi bij të Perëndisë (Rom. 8:16).

Prandaj ti nuk je më shërbëtor, por bir; dhe në qoftë se je bir, je edhe trashëgimtar i Perëndisë... (Gal. 4:7).

Ajo është një marrëdhënie që nuk mund të prishet. Sapo të jesh bir, je për gjithmonë një bir.

Por gjendet edhe një anë tjetër e së vërtetës dhe ajo anë është bashkësimi. Bashkësim do të thotë ndarja e gjërave të njëjta. Po qe se marrëdhënia është një bashkim, atëherë bashkësimi është të qenët bashkë. Dhe po qe se marrëdhënia është një zinxhir që nuk mund të këputet, bashkësimi është një fill i hollë që mund të këputet shumë lehtë.

Mëkati e prish bashkësimin me Perëndinë. Dy veta nuk mund të ecin së bashku, po qe se nuk bien dakord (Amos 3:3) dhe Perëndia nuk mund të ketë bashkësim me fëmijët e Tij, kur ata mëkatojnë. «Perëndia është dritë dhe në Të nuk ka aspak errësirë» (1 Gjoni 1:5). Ai nuk mund ta shijojë bashkësimin me ata që fshehin ligësi në jetën e tyre.

Bashkësimi mbetet i prishur për sa kohë që mëkati është i parrëfyer dhe i pa braktisur. Një bashkësim i prishur është shumë serioz. Për shembull, një vendim mund të merret, kur një besimtar është jashtë lidhjes me Zotin, që mund të vendosë një mallkim për pjesën tjetër të jetës. Sa të krishterë që janë tërhequr kanë zgjedhur një bashkëshorte jobesimtare dhe kanë shkatërruar jetën e tyre për sa i përket dobishmërisë për Perëndinë! Ata janë shpëtuar, por jetët e tyre kanë humbur.

Bashkësimi i prishur sjell disiplinimin nga Perëndia. Ndërsa një besimtar është i lirë nga dënimi i përjetshëm për mëkatet, ai nuk është i lirë nga pasojat e mëkatit në jetën e tij. Pse

ishin disa nga shenjtorët korintas të sëmure? Sepse ata po shkonin në tryezën e bashkësimit pa rrëfyer së pari mëkatet e tyre dhe pa e zgjidhur këtë problem (1 Kor. 11:29-32). Disa prej tyre madje kishin vdekur. Ata ishin përgatitur për qiellin nëpërmjet shpengimit që është në Krishtin Jezus, por ishin të papërshtatshëm për jetë të mëtejshme dhe për dëshmi këtu mbi tokë.

Bashkësimi i prishur do të rezultojë në humbje të shpërblimit në Gjykimin nga Krishti (1 Kor. 3:15). E gjithë koha e kaluar jashtë bashkësimit me Perëndinë është kohë e humbur përgjithmonë.

Kështu ndërsa ngazëllohemi në të vërtetën se marrëdhënia jonë me Perëndinë është e pathyeshme, ne duhet të frikësohemi së tepërmi nga çdo gjë që prish marrëdhënien tonë me Atin. Në fakt, njohuria se hiri na ka sjellë në një marrëdhënie të tillë të mrekullueshme duhet të jetë motivi më i fortë për të mirëmbajtur një bashkësim të vazhdueshëm me Zotin. Hiri nuk e inkurajon mëkatën; ai është pengesa më e madhe për të.

Në Dhiatën e Vjetër, Davidi është një shembull klasik, bashkësimi i të cilit me Perëndinë ishte prishur nga mëkati. Ne lexojmë për këtë rrëfim dhe restaurim ndaj Zotit në Psalmet 32 dhe 51.

Në Dhiatën e Re, biri i arratisur mund të merret si ilustrim për një të tërhequr që kthehet (Lluka 15:11-24) (megjithëse ngjarja zakonisht interpretohet për shpëtimin e mëkatarit). Bashkësimi ishte prishur nëpërmjet rebelimit dhe largimit të birit. Por ai përsëri ishte një bir i babait të tij, megjithëse në një vend të largët. Sapo ai u kthye dhe filloi të bënte rrëfimin e tij, bashkësimi u restaurua. Babai vrapoi dhe e përqafoi atë.

Në 1 Gjoni 2:1 ne lexojmë: «Djema të mi, ju shkruaj këto gjëra që të mos mëkatoni; dhe në qoftë se ndokush mëkaton, kemi një avokat te Ati, Jezu Krishtin të drejtin». Kjo u është shkruar fëmijëve, atyre që kanë lindur në familjen e Perëndisë. Synimi i Perëndisë është që fëmijët e Tij të mos mëkatojnë. Por ne mëkatojmë dhe Perëndia na ka siguruar një rrugëzgjdhje. «... dhe në qoftë se ndokush mëkaton, kemi një avokat te Ati». Vini re këtë —«ne kemi një avokat te Ati». Ai akoma është Ati ynë, madje edhe kur mëkatojmë. Si është e mundur? Sepse marrëdhënia është një lidhje që nuk mund të thyhet kurrë. Çfarë ndodh kur ne mëkatojmë? «Ne kemi një avokat te Ati, Jezu Krishtin të drejtin». Ai menjëherë vazhdon të punojë në jetën tonë, duke na sjellë në një vend ku ne kemi dëshirë dhe vullnet për të pohuar dhe braktisur mëkatet tona, kështu që të shijojmë bashkësimin me Atin edhe një herë.

Kur unë shoh ndryshimin midis marrëdhënies dhe bashkësimit më ndihmon të kuptoj këto Shkrime. Ajo gjithashtu më bën të pëlqej sigurinë e përjetshme që unë kam në Krishtin dhe më motivon të jetoj në bashkësim me Atin tim, i cili më do shumë.

FALJA JURIDIKE DHE PRINDËRORE

Dy lloje të ndryshme të faljes gjenden në Shkrimet e Shenjta dhe në qoftë se duam të jemi studentë të kujdesshëm të Fjalës, ne duhet të mësojmë t'i dallojmë ato. Ne do t'i quajmë ato falje juridike dhe prindërore (megjithëse këta emra nuk përdoren në Bibël).

Ta themi atë thjeshtë, falja juridike është falja nga gjykatësi dhe falja prindërore është falja nga babai. Termi i parë është marrë nga gjykata dhe i dyti është marrë nga shtëpia.

Le të kthehemi te gjykata. Perëndia është Gjykatësi dhe mëkatari është njeriu në ndjekje penale. Njeriu është fajtor për bërjen e mëkateve dhe dënimi është vdekja e përjetshme. Por Zoti Jezus shfaqet atje dhe lajmëron: «Unë do të paguaj dënimin që meritojnë mëkatet e njeriut; Unë do të vdes si Zëvendësues për të!». Ja çfarë bëri Shpëtimtari në Kryqin e Kalvarit. Tani Gjykatësi lajmëron njeriun mëkatari: «Në qoftë se t'i i dorëzohesh Birit Tim, si Zot dhe Shpëtimtar, Unë do të të fal». Sapo njeriu të vendosë besimin e tij në Shpëtimtarin, ai merr faljen juridike për të gjitha mëkatet e tij. Atij nuk i duhet kurrë që të paguajë dënimin për to në ferr, sepse Krishti e ka paguar të gjithë atë. Mëkatari i falur tani hyn në një marrëdhënie të re: Perëndia nuk është më Gjykatësi i tij; tani Ai është Ati i tij.

Kështu tani le të kthehemi te shtëpia për një ilustrim të faljes prindërore. Perëndia është Ati dhe besimtari është fëmija. Në momentin e papritur, fëmija bën mëkat. Pastaj çfarë ndodh? A e dënon Perëndia fëmijën që të vdesë për mëkatin? Natyrisht që jo, sepse Perëndia nuk është më Gjykatësi, por Ai është Ati! Çfarë ndodh? Bashkësimi në familje është prishur. Atmosfera e lumtur e familjes nuk ekziston më. Fëmija nuk e ka humbur shpëtimin e tij, por ai ka humbur gëzimin e shpëtimit. Shpejt ai mund të përjetojë disiplinim nga Ati i tij, për ta sjellë atë përsëri në miqësi. Sapo që fëmija ta rrëfejë mëkatin e tij, ai merr falje prindërore.

Falja juridike zë vend një herë e përgjithmonë në momentin e shpëtimit; falja prindërore zë vend sa herë që një besimtar e rrëfen dhe e braktis mëkatin e tij. Kjo është çfarë Jezusi na mëson në Gjonin 13:8-10: ne kemi nevojë për larjen e rilindjes vetëm njëherë për të na çliruar nga dënimi i mëkateve, por kemi nevojë për shumë pastrime gjatë jetës sonë të krishterë për të na dhënë falje prindërore.

Ndryshimi midis dy llojeve të faljeve mund të përmbledhet grafikisht si më poshtë:

Juridike

Prindërore

Statusi i personit	Mëkatar (Rom. 3:23).	Fëmijë (1 Gjo 3:2)
Marrëdhënia e Perëndisë me të	Gjykatës (Psa. 96:13).	Atë (Gal. 4:6)
Rezultati i mëkatit	Vdekja e përjetshme (Rom. 6:23).	Bashkësim i prishur (1 Gjo 1:6)
Roli i Krishtit	Shpëtimtar (1 Tim. 1:15)	Kryepriфт dhe Avokat (Heb. 4:14-16; 1Gjo 2:1)
Nevoja e personit	Shpëtimi (Veprat 16:30)	Gëzimi i shpëtimit (Psa. 51:12)
Mjeti i faljes	Besimi (Veprat 16:31)	Rrëfimi (1Gjo 1:9)
Lloji i faljes	Juridike (Rom. 8:1)	Prindërore (Lluka 15:21, 22)
Pasoja për rastet e kundërshtimit	Ferri (Gjoni 5:24)	Disiplinim (1 Kor. 11:31-32) Humbje në Gjykimin nga Krishti (1Kor. 3:15)
Rezultati pozitiv	Marrëdhënie e re (Gjoni 1:12)	Bashkësim i restauruar (Psa. 32:5)
Shpeshësia	Njëherë (një larje rilindjeje) (Gjoni 13:10)	Shpeshherë (shumë pastrime) (Gjoni 13:8)

Duke filluar që tani, kur gjejmë vargje që flasin për faljen një herë e përgjithmonë, që na është garantuar ne si mëkatarë nëpërmjet veprës së Krishtit, ne do ta dimë se tema është falja juridike. Vargjet më poshtë e ilustrojnë këtë:

Në të cilin kemi shpengimin me anë të gjakut të Tij, faljen e mëkateve sipas pasurive të hirit të Tij (Ef. 1:7).

Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njëri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin (Ef. 4:32).

Që kishit vdekur në mëkate dhe në parrethprerjen e mishit, duke jua falur të gjitha mëkatet (Kol. 2:13).

Sidoqoftë, ka edhe pjesë të tjera të Shkrimeve të Shenjta që trajtojnë faljen prindërore:

Sepse në qoftë se ju ua falni njerëzve gabimet e tyre, Ati juaj qiellor do t'jua falë edhe juve; por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj nuk do t'ua falë juve gabimet tuaja (Mat. 6:14-15).

Mos gjykoni dhe nuk do të gjykoheni; mos dënoni dhe nuk do të dënoheni; falni dhe do të jeni të falur (Lluka 6:37).

Dhe kur nisni të luteni, nëse keni diçka kundër ndokujt, faleni, që edhe Ati juaj që është në qiejt, t'ju falë mëkatet tuaja (Marku 11:25).

Vini re se në dy nga këta vargje Perëndia është përmendur specifikisht si Atë; është falja e Atit që është përfshirë. Vini re gjithashtu se të jemi të falur varet në vullnetin tonë për të falur të tjerët. Kjo nuk është e vërtetë për faljen juridike; vullneti për të falur të tjerët nuk është kusht për shpëtimin. Por ajo është e vërtetë për faljen prindërore; Ati ynë nuk do të na falë, në qoftë se ne nuk e falim njëri-tjetrin.

Në Mateun 18:23-35 Jezusi tregon një histori të një skllavi, të cilit mbreti i kishte falur 10,000 monedha ari. Por i njëjti skllav nuk do t'i falte 100 monedha ari një skllavi tjetër. Mbreti kështu u zemërua me të dhe ia dorëzoi atë rojeve të burgut derisa ai pagoi borxhin. Jezusi e përfundoi shëmbëlltyrën duke thënë: «Kështu do të veprojnë me ju edhe Ati Im qiellor, në qoftë se secili prej jush nuk e fal me gjithë zemër vëllanë e vet për fajet e tij». Këtu përsëri bëhet fjalë për faljen nga Ati. Është një mëkat të kemi një shpirt që nuk fal, dhe kështu Perëndia nuk mund të na falë prindërisht derisa ne të rrëfejmë dhe braktisim mëkatin.

Një nga gjërat e gëzueshme të studimit biblik është të shohësh këto dallime themelore dhe që të jesh i aftë t'i zbatosh ato në të lexuarit e përditshëm. Duke filluar që tani, kur të gjeni temën e faljes në Fjalën e Perëndisë, ju duhet të jeni të aftë të thoni: «Oh, po, ajo i referohet faljes juridike» ose ndryshe «ajo duhet t'i referohet faljes nga Ati ndaj fëmijës së Tij».

DY NATYRAT

Kur diskutojmë dallimet biblike, asnjë prej tyre nuk është më e rëndësishme sesa dallimi midis dy natyrave të besimtarit. Kur i krishteri është i pavetëdijshëm për këtë të vërtetë, atëherë është e mundur që ai të shkatërrohet nga faji, dyshimi dhe dekurajimi. Kështu, është e rëndësishme të kuptojmë se çdo i krishterë ka dy natyra, të vjetrën dhe të renë dhe duhet t'i kuptojë të gjitha karakteristikat e tyre.

Natyra e vjetër

Të gjithë, të shpëtuar dhe të pashpëtuar, kanë një natyrë të vjetër. Kjo është e vetmja natyrë që ka i pashpëtuari. Ajo është trashëguar nga Adami dhe mbetet e njëjtë gjatë gjithë jetës. Atë mund ta quajmë natyra Adamike, njeriu i vjetër ose mishi. Davidi e shprehu atë në këto fjalë: «Ja, unë jam mbrauajtur në paudhësi dhe nëna ime më ka lindur në mëkat» (Psalm 51:5). Pali iu referua kësaj kur ai shkroi: «E di se në mua (domethënë në mishin tim) nuk banon asgjë e mirë» (Rom. 7:18a). Ne nuk duhet të kërkojmë ndonjë gjë të mirë në të dhe nuk duhet të dekurajohemi kur nuk shohim ndonjë të mirë. Është trishtuese kur kuptojmë se secili nga ne ka një natyrë që është e aftë të bëjë çfarëdo mëkati të përshkruar në Shkrimet e Shenjta.

Natyra Adamike është një nga tre armiqtë e besimtarit, bota dhe djalli janë dy të tjerat. Natyra e vjetër është armiku ynë nga përbrenda. Ajo ushqehet në atë që është e pavlefshme dhe e papastër. E bën besimtarin në mënyrë të natyrshme të largohet nga Perëndia. Shkakton armiqësi kundër Perëndisë, nuk i nënshtrohet ligjit të Perëndisë dhe nuk mund ta kënaqë Perëndinë. Si rezultat i kësaj, njerëzit anojnë më tepër të pranojnë të shtrembrën sesa të vërtetën.

Natyra Adamike është e ligë në mënyrë të pashërueshme. Edhe kur një burrë ose grua jetojnë një jetë të shenjtë për vite me radhë, natyra e vjetër nuk është aspak më e mirë. Zoti nuk mundohet ta përmirësojë apo ta reformojë atë. Ai e dënoi atë në kryqin e Kalvarit. «Perëndia (dërgoi) Birin e vet në shëmbëllim mishi mëkatar, edhe për mëkat, e dënoi mëkatin në mish» (Rom. 8:3). «Njeriu ynë i vjetër u kryqëzua me Të» (Rom. 6:6). Tani Perëndia e udhëzon besimtarin ta konsiderojë natyrën e vjetër të vdekur, domethënë, të reagojë ndaj saj si një i vdekur.

Kur një person është i ndaluar të bëjë diçka, natyra e vjetër menjëherë dëshiron ta bëjë atë. Pali e shpjegon këtë në Romakëve 7:7c-9):

...Mëkatin unë nuk do ta kisha njohur, veç se me anë të ligjit; sepse unë nuk do ta kisha njohur lakminë, po të mos thoshte ligji: «Mos lakmo». Por mëkati, duke marrë shkas nga ky urdhërim, ngjalli në mua çdo lakmi sepse, pa ligj, mëkati është i vdekur. Dikur unë jetoja pa ligj, por kur erdhi urdhërimi, mëkati u ngjall dhe unë vdiqa.

Pali e ngjason natyrën e vjetër me atë të një trupi të vdekur të ngjeshur në shpinën e tij. Natyrisht, kjo tablo është ajo e një trupi të ndyrë që po kalbëzohet. Ajo e ndoqi atë kudo, duke e bërë atë të thërriste: «Oh, njeri i mjerë që jam! Kush do të më çlirojë nga ky trup i vdekjes?» (Rom. 7:24).

Natyra e vjetër është ajo çfarë jemi në Adamin. Zoti Jezus vdiq për të, ashtu si edhe për mëkatet që kemi bërë. Kjo na ngushëllon, sepse ajo çfarë jemi është shumë më e keqe në krahasim me atë që kemi bërë.

E gjitha kjo për të cilën kemi folur nuk e mohon faktin se shpeshherë jobesimtarët janë të dashur, ngadhënjyes dhe bujarë. Kjo sjellje mund të dëshmohet në shumë mënyra. Ajo mund të jetë një instinkt natyror, për shembull, dashuria e nënës për foshnjën e saj. Kjo mund të jetë një diçka impulsive ose një sjellje e mësuar. Kjo ndodh në sajë të ndikimit të Krishterimit, i cili është kripa dhe drita e botës. Dhe mund të motivohet nga dëshira për të fituar ose merituar shpëtim. Pavarësisht nga burimi, një gjë është e sigurt. Gjëja e parë e mirë, që një njeri i pashpëtuar mund të bëjë, është të pranojë Krishtin (Gjoni 6:39).

Natyra e re

Kur një person lind përsëri, ai ose ajo merr një natyrë të re, një natyrë hyjnore (2 Pje. 1:4), jetën e Krishtit. Kjo natyrë nuk mund të mëkatojë, sepse ajo lind nga Perëndia (1 Gjoni 3:9).

Është e mirë dhe e aftë vetëm për të mirën. Atë e quajmë natyra e Krishtit ose njeriu i ri.

Ajo pëlqen të ushqehet vetëm në atë që është e kulluar dhe e shenjtë. Ajo reagon së tepërmi ndaj Fjalës së Perëndisë. Ajo kënaqet në ligjin e Perëndisë. Urdhëresat e Tij nuk janë të bezdisshme; ato janë pikërisht gjërat që natyra e re pëlqen të bëjë. Ato janë si t'i tregojë një mamaje të kujdeset për foshnjën e saj; kjo është çfarë natyra e re pëlqen të bëjë.

Dy natyrat mund të krahasohen me korbin dhe pëllumbin që lëshoi Noeu nga arka. Korbi nuk u kthye më; ai u kënaq duke u ushqyer me gjithë mishin që po kalbëzohej mbi ujë. Pëllumbi, që përfaqëson natyrën e re, u kthye te arka ngaqë nuk mundi të gjente ndonjë vend të thatë ku të qëndronte e të ushqej.

Sa të vërteta janë fjalët e Zotit Jezus: «Ç'ka lindur nga mishi është mish; por ç'ka lindur nga Fryma është frymë» (Gjoni 3:6).

Beteja ka filluar!

Një i saposhpëtuar e përshkroi natyrën e tij të dyanshme në mënyrë të larmishme. Ai tha: «Mëkati u hoq nga zemra ime, por në kocka kam akoma gjyshin tim».

Sapo që një njeri të shpëtohet, dy natyrat fillojnë të ndeshen me njëra-tjetrën. A nuk është aspak e çuditshme? Si të ishte e mundur që dy natyra, kaq diametralisht të ndryshme, të jetojnë në paqe? Beteja është ilustruar nga dy foshjat që po ziheshin në barkun e Rebekës (Zan. 25:22-23). Ajo pyeti: «Në qoftë se është kështu, pse gjendem në këto kushte?»

Pali e përshkruan këtë konflikt në mënyrë të larmishme në Romakëve 7:14-25:

Sepse ne e dimë se ligji është frymëror, por unë jam i mishtë, i shitur mëkatit si skllav. Sepse unë nuk kuptoj atë që bëj, sepse nuk bëj atë që dua, por bëj atë që urrej. Edhe, nëse bëj atë që nuk dua, unë pranoj që ligji është i mirë. Por tani nuk jam më unë që veproj, por mëkati që banon në mua. Në fakt unë e di se në mua domethënë në mishin tim nuk banon asgjë e mirë sepse, ndonëse e kam dëshirën për të bërë të mirë, nuk ia gjej mënyrën. Në fakt të mirën që unë e dua nuk e bëj; por të keqen që s'dua, atë e bëj. Edhe, në qoftë se bëj atë që nuk dua, s'jam më vetë ai që e bëj, por është mëkati që banon në mua. Unë, pra, po zbuloj këtë ligj: duke dashur të bëj të mirën, e keqja gjendet në mua. Në fakt unë gjej kënaqësi në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm, por shoh një ligj tjetër në gjymtyrët e mia, që lufton kundër ligjit të mendjes sime dhe që më bën skllav të ligjit të mëkatit që është në gjymtyrët e mia. Oh, njeri i mjerë që jam! Kush do të më çlirojë nga ky trup i vdekjes? I falem nderit Perëndisë me anë të Jezu Krishtit, Zotit tonë. Unë vetë, pra, me mendjen, i shërbej ligjit të Perëndisë, por, me mishin e ligjit të mëkatit.

Një përshkrim tjetër i konfliktit që ka ngjashmëri, por që nuk është identik, është beteja midis mishit dhe Frymës së Shenjtë (Gal. 5:17):

Sepse mishi ka dëshira kundër Frymës dhe Fryma ka dëshira kundër mishit; dhe këto janë të kundërta me njëra-tjetrën, që ju të mos bëni ato që dëshironi.

Pa dyshim, që një besimtar shpeshherë është i ngatërruar (si Rebeka) nga ky konflikt i brendshëm. Ai mendoi (vërtet) se beteja do të merrte fund pasi ai të pranonte Zotin, por tani ai zbulon se një betejë më e ashpër ka filluar dhe ai është i çorientuar. Ai madje mund të dyshojë edhe shpëtimin e tij.

Ai duhet të dijë se çdo i krishterë, edhe ai më shenjtë e përjeton këtë betejë (1 Kor. 10:13) dhe ajo do të vazhdojë deri në vdekje ose me Rrëmbimin. Në vend të provës që ai është i pashpëtuar, për më tepër ajo konfirmon se ai është shpëtuar me të vërtetë.

Cila natyrë fiton?

Fryma e Shenjtë na çliron nga fuqia e mëkatit brendabanues (Gal. 5:17). Edhe besimtari më i perëndishëm nuk e ka atë fuqi në vetvete. Sidoqoftë, bindja dhe bashkëpunimi nga besimtari janë të domosdoshme.

Besimtari është ai që përcakton fituesin. Është ajo që ai ushqen. Ai nuk mund ta ushqejë mishin me TV, filma, literaturë dhe zbavitje jo të krishterë dhe ndërkohë të presë që natyra e re të fitojë. Ai nuk duhet të ushqejë ujkun dhe të presë që qengji të fitojë.

Për këtë arsye Romakëve 13:14 thotë të «mos tregoni kujdes për mishin, që t'ia kënaqni lakmitë» dhe në 1 Pje. 2:11 të «hiqni dorë nga lakmitë e mishit, që luftojnë kundër shpirtit».

Por, në anën tjetër ai duhet të kalojë shumë kohë në Fjalën e Perëndisë, në lutje dhe në shërbimin për Zotin. Kërkohen të gjitha veprimet që ndikojnë në shenjtërimin e jetës.

S'ka pretekste, ju lutem!

Ne nuk duhet të shfajësohemi duke ia vënë fajin natyrës së vjetër. Ajo është një formë transferimi faji që nuk do të ketë sukses. Perëndia e bën përgjegjës njeriun dhe jo natyrën.

Duke ia lënë fajin mëkatit e bën më të lehtë mëkatimin. Ai e ul rezistencën e besimtarit.

Konkluzion

Edhe Bibla, edhe përvoja na tregojnë se ne kemi dy natyra. Ato mund të njihen me emra të ndryshëm, por ama ato ekzistojnë. Në qoftë se besimtari nuk e kupton këtë, ai mund të ndiejë një kontradiktë. Ose ai mund të vërë në pyetje shpëtimin e tij ose ai jeton një jetë të mposhtur.

Zgjidhja e kësaj çështjeje varet nga reagimi ndaj dëshirave të natyrës së vjetër, ashtu si të ishit të vdekur dhe t'i nënshtroheni kontrollit të Frymës së Shenjtë. Për sa kohë që besimtari bën këtë, ai nuk do t'i plotësojë dëshirat e mishit (Gal. 5:16).

LLOJET E SHENJTËRIMIT

Fjala «shenjtëroj» do të thotë «ndaj mënjanë». Gjendet një familje e tërë fjalësh—shenjtëroj, shenjtërim, shenjt, i shenjtë, shenjtëri, përkushtoj, përkushtim. Shumë shpesh shenjtërimi nënkupton procesin e ndarjes nga përdorimet e zakonshme ose të papastra për shërbim hyjnor. Por jo gjithmonë. Po të keni parasysh se të shenjtërohesh do të thotë të ndash mënjanë, do të keni një përkufizim që do të përshtatet në të gjitha rastet.

Në Dhiatën e Vjetër Perëndia e shenjtëroi ditën e shtatë (Zan. 2:3). I parëlinduri i njerëzve dhe kafshëve u shenjtëruan nga Zoti (Eks. 13:2). Priftërinjtë duhet të shenjtëronin veten ndaj Zotit (Eks. 19:22). Tabernakulli dhe gjithë pajisjet e tij ishin shenjtëruar (Eks. 40:9).

Në Dhiatën e Re shenjtërimi përdoret kryesisht në lidhje me njerëzit. Sidoqoftë, Jezusi tha se Tempulli shenjtëron arin në të dhe se altari shenjtëron dhuratën në të (Mat. 23:17, 19). Pali tregon se kur ne japim falënderime për ushqimin, ai shenjtërohet nëpërmjet Fjalës së Perëndisë dhe lutjes (1 Tim. 4:5).

Për sa i përket shenjtërimit të personave, Perëndia e shenjtëroi Krishtin dhe e dërgoi në botë (Gjoni 10:36); domethënë, Ati la mënjanë Birin e Tij për punën e shpëtimit tonë nga mëkatet tona. Jezusi shenjtëroi Vetën (Gjoni 17:19); me fjalë të tjera, Ai u nda mënjanë me qëllim që të ndërhynte për njerëzit e Tij.

Madje në një kuptim, ka jobesimtarë të caktuar që shenjtërohen. «Sepse burri jobesimtar është shenjtëruar me anë të gruas dhe gruaja jobesimtare është shenjtëruar me anë të burrit...» (1 Kor. 7:14). Kjo do të thotë se partneri jobesimtar është ndarë mënjanë në një pozitë privilegji duke pasur një bashkëshorte të krishterë që lutet për shpëtimin e tij.

Dhe në një kuptim në të cilin Krishti duhet të shenjtërohet nga të gjithë besimtarët. «Por shenjtërojeni Zotin Perëndi në zemrat tuaja...» (1 Pje. 3:15). Ne e shenjtërojmë Atë duke e bërë Atë si Sovranin e pamposhtur në jetën tonë.

Sidoqoftë, krahas gjërave të mësipërme ka katër lloje të tjera të rëndësishme të shenjtërimit, të cilat duhet t'i dallojmë në studimin tonë të Dhiatës së Re. Ata quhen shenjtërimi përpara shpëtimit, shenjtërimi pozicional, shenjtërimi përparimtar dhe shenjtërimi i përsosur.

Shenjtërimi përpara shpëtimit

Shumë kohë para se një person të lindë përsëri, Fryma e Shenjtë ka qenë duke punuar në jetën e tij, duke e ndarë atë mënjanë nga bota për Krishtin. Pali e kuptoi se ai ishte ndarë mënjanë para se ai të lindte (Gal. 1:15). Në 2 Thesalonikasve 2:13, apostulli u kujton Thesalonikasve se kishte tre hapa në shpëtimin e tyre:

1. Zgjedhja e tyre nga Perëndia.
2. Shenjtërimi i tyre nga Fryma.
3. Besimi i tyre në të vërtetën.

Vini re se ky shenjtërim ishte para se ata të besonin dhe të shpëtoheshin.

Në 1 Pjetri 1:2, radha e ngjarjeve në lidhje me shpëtimin lidhet si më poshtë:

1. Zgjedhje dhe paracaktim nga Ati Perëndi.
2. Shenjtërim nga Fryma.
3. Bindje ndaj Krishtit Jezus.
4. Spërkatje me gjakun e Tij.

Në përjetësi Perëndia na zgjodhi ne që t'i përkisnim Atij. Me kalimin e kohës Fryma e

Shenjtë na ndau ne mënjane për Zotin. Pastaj ne iu bindëm ungjillit. Sapo e bëmë këtë, e gjithë vlera e gjakut të derdhur të Krishtit iu shtua llogarisë sonë. Por pika për t'u vënë re këtu është se shenjtërimi për të cilin Pjetri flet është një lloj shenjtërimi që zë vend para se një person të lindë përsëri.

Shenjtërimi pozicional

Në momentin që një person lind përsëri, ai bëhet i shenjtëruar pozicionalisht. Kjo do të thotë se për sa i përket të qëndruarit para Perëndisë, ai është ndarë mënjane nga bota për Perëndinë, sepse ai është «në Krishtin». Në një kuptim të vërtetë Krishti është shenjtërimi i tij (1 Kor. 1:30).

Secili besimtar i vërtetë është një shenjtor; ai është ndarë mënjane për Zotin. Kjo është pozita e tij. Kështu në 1 Korintasve 1:2 të gjithë të krishterët në kishën lokale të Korintit janë përshkruar si «të shenjtëruar në Krishtin Jezus, të thirrur për të qenë shenjtorë». Ata nuk shprehin gjithmonë shenjtërim. Ata toleronin mëkatin në bashkësinë e tyre (1 Kor. 5:1, 2). Ata u kthyen te ligji kundër njëri-tjetrit (1 Kor. 6:1). Ata kishin mësues që e mohuan Ringjalljen (1 Kor. 15:33, 34). Por ishte akoma e vërtetë për ta se për sa i përkiste pozitës së tyre, ata ishin shenjtorë — të shenjtëruar në Krishtin Jezus.

Tani le të shohim disa nga pjesët që kanë të bëjnë me shenjtërimin pozicional. Në Veprat 20:32, shprehja «të gjithë ata që janë shenjtëruar» do të thotë të gjithë besimtarët. Në Veprat 26:18, Zoti i përshkroi njerëzit e Tij si ata «që janë shenjtëruar nëpërmjet besimit që është në mua». Korintasit janë përshkruar si të «larë ... shenjtëruar ... të përligjur në emrin e Zotit Jezus dhe me anë të Frymës së Perëndisë sonë» (1 Kor. 6:11). Dhe shkruesi i Hebrenjve na kujton se «ne jemi shenjtëruar me anë të kushtimit të trupit të Jezus Krishtit, që u bë njëherë për të gjithë» (Heb. 10:10). «Sepse, me një ofertë të vetme, Ai i bëri të përsosur për gjithnjë ata që shenjtërohen» (Heb. 10:14).

Shenjtërimi pozicional disa herë tregohet edhe me përdorimin e fjalës «i shenjtë». Kështu në Kolosianëve 3:12, kur Pali u drejtohet të krishterëve si «të shenjtë», ai po i referohet pozitës të tyre para Perëndisë.

Shenjtërimi përparimtar

Ndërsa ka shumë Shkrime, të cilat thonë se të gjithë të krishterët shenjtërohen, ka shumë të tjera që thonë se ata duhet të shenjtërohen. Në qoftë se dështojmë të bëjmë dallimin e llojeve të shenjtërimeve, kjo mund të na duket shumë e ngatërrueshme.

Shenjtërimi përparimtar ose praktik i referohet asaj çfarë duhet të jemi në jetën tonë të përditshme. Ne duhet të jemi duke jetuar jetë të ndara nga mëkati dhe nga e liga. Shenjtorët duhet të shenjtërohen gjithnjë e më tepër gjithë kohën.

Ishte ky aspekt i shenjtërimit të cilit Jezusi iu referua në Gjonin 17:17 kur Ai u lut për të Tijët: «Shenjtëroi ata në të vërtetën tënde: fjala Jote është e vërteta».

Bashkëpunimi i besimtarit përfshihet në këtë (2 Tim. 2:21). Kur gjeni thirrje për shenjtërim, ju mund të jeni të sigurt se bëhet fjalë për shenjtërimin praktik. Kështu Pali iu kërkoi me të madhe Korintasve: «... le ta pastrojmë veten nga çdo ndotje e mishit dhe e frymës dhe ta përfundojmë shenjtërimin tonë në druajtjen e Perëndisë» (2 Kor. 7:1). Dhe për të njëjtën gjë shkroi Pjetri: «... si është i shenjtë ai që ju thirri, të jini edhe ju të shenjtë në gjithë sjelljen tuaj» (1 Pje. 1:15).

Një formë e veçantë e shenjtërimit praktik ka lidhje me ndarjen nga imoraliteti. «Sepse ky është vullneti i Perëndisë: shenjtërimi juaj; të hiqni dorë nga kurvëria; që secili prej jush të dijë ta mbajë enën e vet në shenjtëri dhe me nder» (1 Thes. 4:3, 4).

Si bëhet një i krishterë më i shenjtë, më i ngjashëm me Zotin Jezus? Përgjigjja gjendet në 2 Korintasve 3:18: «Dhe ne të gjithë, duke soditur fytyrëzbuluar lavdinë e Zotit si në pasqyrë, transformohemi në të njëjtën shëmbëllim nga lavdia në lavdi, posi prej Frymës së Zotit».

Shenjtërimi praktik vjen nga të qenët i lidhur me Zotin. Është një parim në jetë që ne bëhemi si ai që e adhurojmë. Sa më tepër të shohim Krishtin, aq më tepër bëhemi si Ai. Fryma e Shenjtë e bën të mundur një transformim të tillë të mahnitshëm—jo të gjithin njëherazi, por nga një shkallë e lavdisë në një tjetër!

Shenjtërimi i përsosur

Ky aspekt i shenjtërimit është akoma në të ardhmen për besimtarin. Kur ai të shohë Shpëtimtarin ballë për ballë, ai do të jetë përgjithmonë i ndarë mënjane nga gjithë mëkati dhe ndyrësia. Ai do të jetë moralisht si Zoti Jezus—i shenjtëruar përsosmërisht.

Kjo është çfarë lexojmë në Kolosianëve 1:22: «Në trupin e mishit të Tij, me anë të vdekjes, që t'ju nxjerrë juve përpara vetes së Tij shenjtore, faqebardhë dhe të pafajshëm».

Në atë ditë Kisha do të marrë shenjtërimin e saj përfundimtar: «Që ta nxjerrë përpara Vetes të lavdishme, pa njolla a rrudha a ndonjë gjë të tillë, por që të jetë e shenjtë dhe e paqortueshme» (Ef. 5:27).

Pjesë të tjera përshkruajnë shenjtërimin tonë të përsosur pa e përmendur fjalën «shenjtërim». Gjoni, për shembull, thotë: «... dimë se, kur të shfaqet Ai, do të jemi të ngjashëm me të, sepse do ta shohim se si është Ai» (1 Gjoni 3:2). Dhe Juda na kujton se Zoti ynë do të na paraqesë ne «... para lavdisë së Tij të paqortueshëm dhe me gëzim» (Juda 24).

Tani do të jetë së tepërmi një ndihmë në studimin tuaj të Biblës të bëni dallimin midis këtyre aspekteve të ndryshme të shenjtërimit. Kurdoherë që gjeni fjalë që kanë të bëjnë me shenjtërimin, bëjini vetes pyetjen: «A është kjo çfarë ndodhi para shpëtimit? A është kjo çfarë unë jam në Krishtin? A është kjo çfarë unë duhet të jem ditë për ditë? Apo është kjo çfarë unë do të jem kur të hyj në praninë e lavdishme të Zotit Jezus Krisht?»

BRENDABANIMI, PAGËZIMI DHE MBUSHJA

Kur studiojmë doktrinën e Frymës së Shenjtë, ne zbulojmë se duhet të kemi parasysh disa dallime të rëndësishme. Ne duhet të kemi parasysh dallimin midis brendabanimit, pagëzimit dhe mbushjes me Frymën e Shenjtë. Duhet të kuptojmë se pagëzimi me Frymën nuk është i njëjtë si pagëzimi me zjarr. Gjithashtu duhet të bëjmë dallimin midis mbushjes sovrane me Frymën dhe përgjegjësisë tonë.

Brendabanimi

Sapo që një person të lindë përsëri, Fryma e Shenjtë e Perëndisë brendabanon në trupin e tij (1 Kor. 6:19). «A nuk e dini se trupi juaj është tempulli i Frymës së Shenjtë që është në ju, të cilin e keni nga Perëndia dhe se nuk i përkritni vetvetes»? Një njeri që nuk e ka Frymën nuk është me të vërtetë i krishterë (Rom. 8:9b). Menjëherë sapo Personi i tretë i Trinisë brendabanon një njeri, Ai kurrë nuk e braktis atë (Gjo. 14:16). Si e dimë se Ai është në ne? Ne e dimë menjëherë, sepse kështu thotë Fjala e Perëndisë. Por ndërsa koha kalon, ne e dimë nëpërmjet ndryshimeve që Ai sjell në jetën tonë. Brendabanimi nuk është një çështje ndjenjash, megjithëse ndjenjat përfshihen në të. Ne asnjëherë nuk na kërkohet të lutemi për brendabanimin ose të presim për të. Ne e marrim atë sapo që të besojmë në Zotin Jezu Krishtin.

Pagëzimi me Frymën

Përsa i përket pagëzimit me Frymën, teksti kryesor gjendet në 1 Korintasve 12:13:

Sepse të gjithë ne jemi pagëzuar në një Frymë të vetëm në të njëjtin trup, qofshin Hebrejtë apo Grekët, qofshin skllëvërit a të liruarit dhe të gjithë kemi pirë në të njëjtin Frymë.

Këtu ne mësojmë se pagëzimi është shërbimi i Frymës, i cili e bën besimtarin pjesë të trupit të Krishtit, domethënë pjesë të Kishës. Pagëzimi fillestar ndodhi në Ditën e Rrëshajave kur Kisha u formua. Që atëherë, sa herë që një njeri shpëtohet, ai bëhet pjesë e Kishës nëpërmjet pagëzimit në Frymën.

Me një fjalë, të gjithë besimtarët e kanë marrë këtë pagëzim pa marrë parasysh racën apo kombësinë e tyre. Ai është i njëhershëm me rilindjen dhe jo rrjedhojë e saj dhe nuk është e nevojshme të përsëritet prapë në jetën e krishterë.

Askush nuk është urdhëruar të pagëzohet me Frymën. Kjo ndodh menjëherë sapo mëkatari e pranon Shpëtimtarin. Ajo nuk është një përvojë emocionale. Ne e dimë se kjo ndodh sepse Bibla na tregon këtë.

Pagëzimi me zjarr

Pagëzimi me zjarr nuk është i njëjtë si pagëzimi me Frymën. Ky është një pagëzim gjykimi dhe jo një pagëzim bekimi apo privilegji.

Kur Gjon Pagëzori po fliste para një turme besimtarësh dhe jobesimtarësh, ai tha: «Ai (Krishti) do t'ju pagëzojë me zjarrin» (Mat. 3:11; Lluka 3:16). Gjoni pastaj vazhdon të shpjegojë se pagëzimi me zjarr është gjykimi hyjnor:

Ai mban në dorë terploten dhe do ta pastrojë plotësisht lëmin e tij grurin e tij do ta mbledhë në hambar, por bykun do ta djegë me zjarr të pashueshëm (Lluka 3:17;

shih gjithashtu Mat. 3:12).

Konteksti na shpjegon se zjarri është gjykim. Kjo nuk është një gjë e bukur ose entuziazëm i këndshëm!

Por kur nuk përmenden jobesimtarët, Gjoni thotë: «Ai do t'ju pagëzojë me Frymën e Shenjtë» (Mark 1:8; Gjoni 1:33). Ai as që e përmend zjarrin.

Pagëzimi me Frymën është një përjetim në të kaluarën për besimtarët. Pagëzimi me zjarr është një ngjarje në të ardhmen për jobesimtarët.

Dy aspektet e mbushjes me Frymën

Mbushja me Frymën e Shenjtë përdoret në dy kuptime në Dhiatën e Re. Po që se nuk e vëmë re këtë, ne do ta kemi të vështirë të bëjmë lidhjen midis pjesëve të ndryshme të Shkrimeve të Shenjta për sa i përket kësaj teme.

Së pari, është ajo që ne mund ta quajmë mbushje «sovrane». Për shembull, në Shkrimet e Shenjta lexojmë se Gjon Pagëzori ishte «i përplotë me Frymën që në barkun e së ëmës» (Lluka 1:15b). Sigurisht që Gjonit nuk i duhej të plotësonte ndonjë kusht për t'u mbushur me Frymën! Perëndia në sovranitetin e Tij e bëri këtë për ta përgatitur Pagëzorian për shërbimin e tij të veçantë si pararendës i Mesias.

Raste të tilla të ngjashme të mbushjes sovrane gjenden në Veprat e Apostujve. Ja dy prej tyre: Pjetri ishte mbushur me Frymën për tu përgatitur për fjalimin para drejtuesve të Këshillit të Lartë të Izraelit (Veprat 4:8-12).

Dhe ngaqë Zoti e mbushi Palin me Frymën e Shenjtë, u bë e mundur që apostulli të denonconte Elimasin, magjistarin (Veprat 13:9-11).

Mbushuni me Frymën

Mbushja tjetër është ndryshe nga ajo më lart. Është një urdhëresë për secilin besimtar dhe ishte në dorën e tij. Teksti i artë rreth kësaj teme gjendet në Efesianëve 5:18: «Dhe mos u dehini me verë, në të cilën ka shturje, por mbushuni me Frymën».

Folja «mbushuni» nënkupton një detyrë të vazhdueshme, jo një përjetim të vetëm të Frymës së Shenjtë¹. Kjo është vënë në kontrast me shturje nga të qenurit i dehur me verë². Kini parasysh ç'ka vijon më poshtë:

I dehuri me verë

I mbushuri me Frymën

Flet duke bëlbëzuar, ndoshta pa kuptim.	Flet i saktë dhe lartëson Krishtin.
Ecën duke u përkundur dhe anuar.	Ecën në shenjtëri dhe me synim.
Kontrollohet nga alkooli.	Kontrollohet nga Fryma e Shenjtë.
Humbet vetë-kontrollin.	Është i përmbajtur.
I mungon morali.	Nuk e humbet moralin.
Nuk i reziston mëkatit.	I reziston mëkatit.
I paturpshëm dhe poshtërues.	Është shembull dhe fisnik.
Vera nuk stimulon për mirë.	Mbushja stimulon për mirë.

Si të mbushemi?

Me sa thamë më lart, duhet të plotësohen disa kushte me qëllim që të dimë se jemi mbushur me Frymën. Ashtu siç ka thënë dikush, ne duhet ta vëmë veten «në udhën e bekimeve». Si mund të realizohet kjo?

- Rrëfeje dhe braktise mëkatit sa më shpejtë (1 Gjo 1:9; Fja. 28:13).
- Paraqitjani Krishtit trupin tuaj vazhdimisht si fli të gjallë (Rom. 12:1,2).
- Mbusheni veten me Fjalën e Perëndisë (Kol. 3:16).
- Kaloni kohë në adhurimin e Perëndisë dhe në lutje (2 Kor. 3:18; Mat. 7:7).
- Qëndroni në bashkësim me vëllezërit e krishterë (Heb. 10:25).
- Bëni gjithçka për lavdinë e Perëndisë (1 Kor. 10:31).

Ai që është i mbushur me Frymën nuk ua bën të njohur këtë fakt të tjerëve. Ai është i përlurur dhe lëvdon Krishtin (Gjoni 3:30; 16:14). Sa më tepër që ai ecën në Frymën e Shenjtë, aq më tepër ai bëhet i vetëdijshëm për kotësinë dhe pavlefshmërinë e tij.

Është mirë të themi se mbushja me Frymën e Shenjtë nuk është një emocion, por është shenjtërim. Është e vërtetë se emocionet kanë të bëjnë, ashtu si në shumë sfera të tjera të jetës së krishterë, por ato nuk janë gjëja kryesore. Emocionet tona njerëzore janë produkt si rrjedhojë e mbushjes hyjnore.

Një fjalë të fundit

Një besimtar mund të ketë një përjetim të Frymës së Shenjtë, i cili është shumë i ndryshëm nga çfarë kemi përshkruar mësipër. Për shembull, kjo mund të ndodhë kur ai kthehet përsëri te Perëndia ose kur ai ia ripërkushton veten Krishtit në një mënyrë të re e më të plotë. Një përjetim i tillë duhet të admirohet shumë dhe mund të përfshijë edhe emocione të thella. Kjo nuk është e njëjtë me brendabanimin ose me pagëzimin me Frymën e Shenjtë. Kjo mund të jetë një krizë që të çon në atë proces që e njohim si mbushje, por mbushja nuk është vetëm e njëhershme. Ajo është një proces. T'i ngatërrosh këto shërbime të Frymës me shprehje të tjera biblike të jetës frymërore, do të thotë vërtet të krijosh ngatërresë në doktrinë.

Shënime:

1. Në tekstin origjinal gjenden dy kohë të foljes të përdorura si urdhër ose në formën «urdhërore». Njëra thekson veprën ose ngjarjen (koha aorist). Tjetra e përdorur këtu (e tashmja) shpeshherë thekson një veprim të vazhduar ose të përsëritur. Një përkthim i mundshëm do të ishte: «Vazhdoni të mbusheni».

2. Shturja ka të bëjë me jetën pa kufij për sa i përket alkoolit.

SHPËTIMI DHE SHËRBIMI

Në studimin e Fjalës së Perëndisë ne mund ta shmangemi nga shumë gabime dhe konfuzione nëse bëjmë dallimin midis pjesëve të ndryshme të Shkrimeve të Shenjta që trajtojnë shpëtimin dhe atyre që kanë të bëjnë me jetën dhe shërbimin e krishterë.

Në përgjithësi, pjesët që bëjnë fjalë për shpëtimin nuk janë të vështira për t'u dalluar. Ato japin dëshmi të vazhdueshme për faktet e mëposhtme.

Por janë shfajësuar me anë të hirit të Tij, ... (Rom. 3:24).

Sepse Ai bëri të jetë mëkat për ne Ai që nuk njihte mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në Të (2 Kor. 5:21).

Duke ditur se njeriu nuk shfajësohet me anë të veprave të ligjit, por me anë të besimit... (Gal. 2:16).

Jua shkrova këto gjëra juve që besoni në emrin e Birit të Perëndisë, që të dini se keni jetën e përjetshme dhe që të besoni në emrin e Birit të Perëndisë (1 Gjoni 5:13).

Dhe unë u jap atyre jetën e përjetshme dhe nuk do të humbasin kurrë, e askush nuk do t'i rrëmbejë nga dora ime (Gjoni 10:28).

Ne ndeshim vështirësi kur nuk mund të dallojmë pjesë që kanë të bëjnë me jetën e krishterë dhe me shërbimin sesa me shpëtimin. Merrni, për shembull, Gjonin 15:1-11:

Unë jam hardhia e vërtetë dhe Ai Im është vreshtari. Secili shermend që nuk jep fryt në Mua, Ai e heq; kurse çdo shermend që jep fryt, Ai e krasit që të japë edhe më shumë fryt. Ju tashmë jeni të pastër, për shkak të fjalës që ju kumtova. Qëndroni në Mua dhe Unë do të qëndroj në ju; sikurse shermendi nuk mund të japë fryt nga e vetja, po qe se nuk qëndron në hardhi, ashtu as ju, nëse nuk qëndroni në Mua. Unë jam hardhia, ju jeni shermendet; kush qëndron në Mua dhe Unë në të, jep shumë fryt, sepse pa Mua nuk mund të bëni asgjë. Në qoftë se ndokush nuk qëndron në Mua, hidhet jashtë si shermendi dhe thahet; pastaj i mbledhin, i hedhin në zjarr dhe digjen. Në qoftë se qëndroni në Mua dhe fjalët e Mia qëndrojnë në ju, kërkoni çfarë të doni dhe do t'ju bëhet. Në këtë është përlëvduar Ati Im, që të jepni shumë fryt dhe kështu do të jeni dishepujt e Mi. Sikurse Ati më ka dashur Mua, ashtu edhe Unë ju kam dashur juve; qëndroni në dashurinë Time. Po të zbatoni urdhërimet e Mia, do të qëndroni në dashurinë Time, sikursi zbatova urdhërimet e Atit Tim dhe qëndroj në dashurinë e Tij. Këto gjëra jua kam thënë që gëzimi Im të qëndrojë në ju dhe gëzimi juaj të jetë i plotë.

Tema e këtij paragrafi është frytdhënia, domethënë, manifestimi i frytit të Frymës në jetën e të krishterit (Gal. 5:22, 23). Kjo nuk u është shkruar mëkatarëve që kanë nevojë për Shpëtimtarin, por shenjtorëve që kanë nevojë për ngjashmërinë e Krishtit. Nëse nuk e vë re këtë, ti mund të arrish në një konkluzion se të krishterët mund të hidhen në liqenin e zjarrit pas së gjithash (Gjoni 15:6). Në fakt, çfarë na mëson kjo është se bota e merr emrin dhe dëshminë e një të krishterit të kthyer prapa dhe e hedh atë në zjarr. Njerëzit e pashpëtuar

gëzohen shumë kur një degë (një besimtar) që nuk është e lidhur me Hardhinë (Krishti).

Një pjesë tjetër që shpeshherë keqkuptohet është 1 Korintasve 3:10-15.

Sipas hirit të Perëndisë që më është dhënë, si arkitekt i ditur, unë kam hedhur themelin dhe një tjetër ndërton mbi të; por secili të ketë kujdes se si ndërton mbi të, sepse askush nuk mund të hedhë themel tjetër përveç atij që është hedhur, i cili është Jezu Krishti. Dhe, në qoftë se dikush ndërton mbi këtë themel ar, argjend, gurë të çmuar, dru, sanë, kashtë, vepra e secilit do të shfaqet, sepse dita do ta tregojë; sepse do të zbulohet me anë të zjarrit dhe zjarri do të provojë veprën e secilit e ç'lloji është. Në qoftë se vepra që dikush ka ndërtuar mbi themelin qëndron, ai do të marrë një shpërblim, në qoftë se vepra e tij digjet, ai do të pësojë humbje, por ai vetë do të shpëtohet, si përmes zjarrit.

Tema e vargut 11 është shpëtimi; ai na mëson se Zoti Jezus është i vetmi themel i vlefshëm. Por pjesa tjetër e këtij paragrafi flet për ndërtimin mbi këtë themel—me fjalë të tjera, për shërbimin që ndjek fill pas shpëtimit. Nuk ka as edhe një sugjerim se ndonjë besimtar do të provohet me anë të zjarrit. Janë veprat ato që do të provohen. Vetë njeriu nuk do të digjet, por veprat ndoshta po. Theksi këtu nuk është mbi besimin që të drejton për në shpëtim, por në punën që të drejton për në shpërblim ose në humbje të shpërblimit.

Ose merrni si shembull tjetër fjalët e Palit në 1 Korintasve 9:24-27.

A nuk e dini se ata që vrapojnë në pistë, vërtetë vrapojnë të gjithë, por vetëm një e fiton çmimin? Vraponi në mënyrë që ta merrni. Dhe kushdo që merr pjesë në garë kontrollon veten në të gjitha; dhe ata e bëjnë këtë për të marrë një kurorë që prishet, kurse ne për një kurorë që nuk prishet. Unë, pra, vrapoj, por jo sikur jam i pasigurt: kështu luftoj, por jo sikur rrah erën; madje e mundoj trupin tim dhe e nënshtroj, se mos, pasi t'u kem predikuar të tjerëve, të bëhem për t'u përjashtuar.

Në vargun e fundit Pali flet për mundësinë për të qenë i përjashtuar në fund. Por konteksti nuk trajton shpëtimin, por vetë-kontrollin në jetën e krishterë. Nuk kishte asnjë mundësi që Pali të hidhej poshtë për shpëtimin, sepse ai ishte pranuar në Krishtin. Por dështimi në disiplinimin e vetvetes mund të rezultojë në një përjashtim për sa i përket shërbimit dhe shpërblimit.

Dallimi midis shpëtimit dhe shërbimit është çelësi për të zgjidhur ato që neve na duken kontradikta në Dhiatën e Re. Në Mateun 12:30 Zoti ynë ka thënë:

Kush nuk është me Mua, është kundër Meje dhe kush nuk mbledh me Mua, shpërndan.

Por në Markun 9:40 Ai thotë:

Sepse kush nuk është kundër nesh, është me ne.

Në shikimin e parë këta vargje duken sikur janë një kontradiktë e hapur ndaj njëri-tjetrit. Por vështirësia zhduket kur ne shohim se i pari trajton shpëtimin dhe i dyti shërbimin. Në rastin e parë, Zoti Jezus po u fliste farisenjve, të cilët po e hidhnin poshtë Atë si Biri i Perëndisë dhe po e akuzonin sikur Ai bënte mrekulli me anë të fuqisë së Djallit. Kur bie fjala për Personin e Krishtit, kushdo që nuk është në anën e Tij, është kundër Tij.

Rasti i dytë kishte të bënte me një njeri që po shërbente në Emrin e Krishtit, por nuk po i ndiqte dishepujt. Kur ata e ndaluan atë, Jezusi tha: «Mos ia ndaloni ... sepse kush nuk është

kundër nesh, është me ne». Kur bie fjala për shërbimin për Krishtin, kushdo që nuk është kundër nesh, është me ne.

Këta ilustrime duhet të tregojnë se sa e dobishme është të bësh dallimin midis pjesëve të Shkrimeve që trajtojnë shpëtimin dhe ato që trajtojnë jetën dhe shërbimin e krishterë. Kështu, në studimin tuaj biblik bëjini pyetjen vetes nëse pjesa që ju po merrni parasysh ka të bëjë me

Veprës e Perëndisë për ne—shpëtimin

Veprën e Perëndisë në ne—shenjtërimin

Veprën e Perëndisë nëpërmjet nesh—shërbimin.

MADHËSHTIA PERSONALE NË KRAHASIM ME MADHËSHTINË POZICIONALE

Në disa pjesë të Shkrimeve të Shenjta është e rëndësishme të dallojmë nëse shkrintari po flet për karakterin e një personi apo për rolin e tij në jetë. Për shembull, një njeri mund të jetë më i mirë se një tjetër ngaqë ai është më i mirë nga natyra e tij. Nga ana tjetër, madhështia superiore tregon se ai njeri ka veçse një pozitë zyrtare më të lartë.

Gjon Pagëzori

Jezusi tha: «Me siguri po ju them, se ndër ta që janë lindur prej gruas nuk ka dalë kurrë ndonjë më i madh se Gjon Pagëzori...» (Mat. 11:11a). Kjo nuk do të thotë se Gjoni pati një karakter më të mirë se Noeu, Danieli apo Jobi. Nuk do të thotë se ai ishte më i mirë, më i perëndishëm, më i urtë apo më i dashur. Ç'ka kjo do të thotë është se pozita e tij si pararendës i Mesias luajti një rol më të madh se ai i paraardhësve të tij. Askush tjetër nuk e ka patur privilegjin të hapë rrugën për Zotin, duke lajmëruar ardhjen e Tij dhe duke e pagëzuar Atë. Në këtë aspekt Gjoni është i veçantë.

Më i vogli në Mbretëri

Menjëherë pasi Jezusi foli për superioritetin pozicional të Gjonit, Ai shtoi: « ... por më i vogli në mbretërinë e qiellit është më i madh se ai» (Mat. 11:11b). Edhe njëherë, kjo nuk do të thotë se më i vogli në mbretërinë e Perëndisë ka një personalitet ose mënyrë jetese më të mirë se Gjon Pagëzori. Për më tepër, çështja qëndron në atë se ai e shpalli mbretërinë dhe besimtarët sot janë shtetas të kësaj mbretërie¹. Gjoni e përshkruan veten si «mik i dhëndrit» (Gjoni 3:29), ndërsa njerëzit e Perëndisë janë nusja. Nusja zë një pozitë më të lartë sesa një mik i dhëndrit dhe është në një rang më të lartë në atë aspekt.

Maria

Engjëlli Gabriel i tha Maries së virgjër: «Gëzohu, o hirplotë, Zoti është me ty; je e bekuar ndër gratë» (Luka 1:28). Nuk ka pikë dyshimi se Maria ishte një e re e perëndishme dhe e panjollosur. Por madhështia e saj e vërtetë qëndron në atë se ajo u zgjodh për të qenë nëna e Zotit tonë (d.m.th. prej asaj u lind Shpëtimtari). Madje ajo e quajti veten mëkatare duke e thirrur Perëndinë «Shpëtimtar» (Luka 1:47). Karakteri i saj nuk ishte më i lartë se i Ruthit apo i Anës. Por roli i saj ishte i pakrahasueshëm.

Një ditë një grua i tha Jezusit: «Lum barku që të barti dhe gjinjtë që të mëndën» (Luka 11:27). Jezusi u përgjigj: «Më tepër, lum ata që e dëgjojnë Fjalën e Perëndisë dhe e zbatojnë» (v. 28). Kjo do të thotë se është më mirë të jesh ndjekës besnik i Krishtit sesa të jesh nëna e Tij. Gjithashtu, kjo do të thotë se ishte bekim më i madh për Marinë që besoi në Krishtin sesa ta lindte Atë.

Ati është më i madh se Unë

Një pjesë shumë e rëndësishme nga Shkrimet e Shenjta, për të bërë dallimin midis karakterit dhe pozitës gjendet në Gjonin 14:28, ku Jezusi thotë: «Ju më keni dëgjuar duke ju thënë, 'Do të largohem dhe do të kthehem prapë te ju'. Po të më doni, ju do të gëzoheshit sepse thashë se do të shkoj te Ati,' sepse Ati Im është më i madh se Unë». Kultet dhe të tjerët që e mohojnë hyjninë e Krishtit i shtrembërojnë këto fjalë të fundit, «Ati Im është më i madh se Unë», duke i nxjerrë jashtë kontekstit duke u munduar të krijojnë pabarazi midis Birit dhe Atit dhe kështu mohojnë edhe Trininë.

Atëherë, cili është kuptimi i këtij vargu? Kur Zoti ynë i foli këto fjalë, Ai ishte akoma në tokë, duke u ndeshur me lloj lloj armiqësie, qortimesh dhe abuzimesh nga krijesat e Tij. Ai u hodh poshtë, u përul dhe u poshtërua. Në anën tjetër, Ati ishte në qiell, plotësisht i lirë nga ky lloj trajtimi. Në atë kuptim, Ati ishte më i madh sesa Biri—më i madh në pozitë, por jo më i madh në person. Po qe se dishëpujt do ta donin me të vërtetë Zotin, atëherë ata do të ishin gëzuar me lajmin se Ai po kthehej në qiell, sepse atje Ai nuk do të binte më pre e poshtërimeve njerëzore. Në qiell, pozita e Tij do të ishte e njëjtë me atë të Atit të Tij—i pa ndikuar nga persekutimi nga krijesat e Tij.

Kjo nuk ka të bëjë aspak me karakterin personal. Për sa i përket kësaj, Biri i Perëndisë është i barabartë me Atin në çdo aspekt. Por për sa kohë që Biri i Perëndisë ishte në tokë, duke u ndeshur me armiqësira nga mëkatarët kundër Tij, Ati ishte më i madh se Ai për sa i përket vendit dhe pozitës së Tij.

Jezusi më i madh se...

Në Mateun 12, Zoti Jezus thotë se Ai është më i madh madje edhe se tempulli (v. 6), më i madh se Jona (v. 41) dhe më i madh se Salomoni (v. 42)². Këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me një çështje pozite apo roli. Ai është më i madh se tempulli në atë që Ai e themeloi atë dhe ritin e tij. Ai është më i madh se Jona në Personin e Tij, në mesazhin e Tij dhe në rezultatet. Dhe Ai është më i madh se Salomoni në lavdinë dhe në urtësinë e Tij; Ishte Ai që i dha urtësi këtij mbreti.

Shihni kontekstin

Zakonisht, konteksti e shpjegon nëse çështja në fjalë ka të bëjë me karakterin personal apo me dinjitetin pozicional. Për sa i përket Zotit Jezus, nuk ka pikë dyshimi për superioritetin e Tij personal! Ai është gjithmonë «më i madhi i të mëdhenjve dhe më i miri i të mirëve».

Shënime:

1. Shihni kapitullin e titulluar «Kisha dhe Mbretëria».
2. Përkthyer fjalë për fjalë «diçka më e madhe se» mund t'i referohet mbretërisë. Por meqë prania e mbretërisë ishte në Personin e Mbretit, themi «Dikush më i madh se».

GJËRA THEMELORE, TË RËNDËSISHME DHE JOESENCIALE

Në studimin e Dhiatës së Re është tepër e rëndësishme të bëjmë dallimin midis gjërave themelore, atyre që janë të rëndësishme (por jo themelore) dhe atyre joesenciale. Çdo fjalë e Perëndisë është e frymëzuar nga Fryma e Shenjtë, por të gjitha pjesëve të Biblës nuk u është vënë i njëjti theks dhe rëndësi.

Njëherë kur Zoti Jezus po u fliste farisenjve, Ai tha: «...ju llogaritni të dhjetën e mëndrës, të koprës dhe të barit të gjumit dhe lini pas dore gjërat më të rëndësishme të ligjit: gjyqin, mëshirën dhe besimin» (Mat. 23:23). Me një fjalë, Ai theksoi se disa pjesë të ligjit janë më të rëndësishme se të tjerat. Por Ai gjithashtu u kujtoi atyre se madje edhe gjërat më pak rëndësi të ligjit kërkonin bindje.

Kështu është në besimin e krishterë; ekzistojnë doktrina themelore absolute. Ka doktrina të tjera që janë të rëndësishme; disa prej tyre janë emërtuar si urdhëresa të Zotit (1 Kor. 14:37). Dhe disa çështje i janë lënë gjykimit të vetë besimtarit përpara Zotit.

Cilat janë gjëra themelore?

Kur bëjmë fjalë për gjërat themelore, ne u referohemi doktrinave të tilla si:

- Frymëzimi nga Fryma e Shenjtë e Shkrimeve të Shenjta. Bibla është Fjala e Perëndisë.
- Trinia. Ekziston një Perëndi, që ekziston përjetësisht në tre Persona.
- Hyjnia e Krishtit. Zoti Jezu Krisht është Perëndia.
- Mishërimi. Jezusi është gjithashtu Njeri i përsosur.
- Vdekja e Tij zëvendësuese në Kryqin e Kalvarit, varrosja, ringjallja dhe ngritja e Tij në qiell.
- Ungjilli. Shpëtimi me anë të hirit nëpërmjet besimit, i ndarë nga veprat.
- Ardhja e dytë. Krishti do të vijë përsëri. Megjithëse jo të gjithë janë të një mendjeje për detajet e kthimit të Tij, vetë fakti i ardhjes së Tij është një hallkë e besimit.
- Dënimi i përjetshëm i të pashpëtuarve.

Këto doktrina janë të pacënueshme. Ne duhet të luftojmë për to. Ato janë bërë të qarta në Shkrimet e Shenjta. Ato janë mbajtur nga kisha ungjillore për shekuj me radhë. Çdo pikëpamje tjetër që i kontradikton këto doktrina është e gabuar. Besimtarët kanë dhënë jetën për këto të vërteta të çmuara. Nuk ka vend për kompromis. Ne nuk mund të bashkësohemi me ata që i mohojnë këto gjëra themelore.

Natyrisht, kjo i zbatohet edhe ligjeve morale të pandryshueshme të Perëndisë. Gjithmonë është mëkat të bësh tradhëti bashkëshortore. Gjithmonë është mëkat të gënjeshtosh ose të vjedhësh. Idhujtaria e çfarëdo lloji ndalohej nga Fjala e Perëndisë. Për këto dhe për çështje të tjera të ngjashme, nuk mund të ketë zbutje apo vend për kompromis. Ne duhet të qëndrojmë me Perëndinë kundër këtyre ligësive.

Të rëndësishme, por jo themelore

Një klasifikim i dytë i gjërave përfshin ato që janë të rëndësishme ngaqë Bibla na mëson për to me autoritet. Por ato nuk konsiderohen si themelore të besimit. Ja disa prej tyre që gjenden në këtë kategori:

- Pagëzimi.

- Divorci dhe rimartesa.
- Ngjarjet në të ardhmen.
- Zgjedhja dhe përgjegjësia e njerëzve.
- Siguria e besimtarit.
- Roli i grave në kishë.
- Dhuntitë e Frymës së Shenjtë.

Ndërsa ekziston vetëm një interpretim i saktë për secilën prej këtyre doktrinave, jo të gjithë besimtarët bien dakord se cili është interpretimi i saktë. Të krishterë të njohur e të perëndishëm nuk bien krejtësisht dakord. John Wesley nuk binte dakord me Charles Spurgeon. Në të tilla çështje, është e rëndësishme që secili t'i formojë bindjet e tij krejtësisht duke u bazuar vetëm në Fjalën e Perëndisë.

Gjëra joesenciale ose gjëra të indiferencës morale

Klasifikimi i tretë përmbledh gjëra që Bibla i konsideron si joesenciale. Këto konsiderohen gjithashtu gjëra të indiferencës morale. Për të tilla çështje, Zoti lejon të ketë ndryshime në opinion për sa kohë që sjellja e besimtarit nuk bëhet gur pengese për të tjerët (Rom. 14:13), nuk shkakton problem për paqen e kishës (Rom. 14:19), ose për sa kohë që nuk shkel në ndërgjegjen e tij (Rom. 14:23).

Në ditët e para të kishës, lindën probleme në lidhje me ushqimin që u ishte ofruar idhujve, me festimin e festave (të kalendarit fetar Izraelit) dhe për sa i përket ushqimit të pastër dhe të papastër. Zgjidhja biblike mund të përmblihet si më poshtë:

Ushqime të ofruara idhujve

Pjesët kryesore në lidhje me ushqimin e ofruar idhujve gjenden në 1 Korintasve 8:1-13 dhe 1 Korintasve 10:14-30. Këtu thelbi i mësimi është që s'ka problem nëse ha nga ky ushqim në qoftë se i krishteri nuk merr pjesë në festën ku ushqimi u ofrohet idhujve; në qoftë se ndërgjegjja e tij është e pastër; dhe në qoftë se ai nuk bëhet gur pengese për besimtarët e tjerë. Por kur Pali thotë: «Të gjitha gjërat janë të ligjshme», ne duhet të kuptojmë se ai nuk po flet për të gjitha gjërat pa përjashtim. Ai po i referohet vetëm çështjes në fjalë—gjërat e indiferencës morale. Po qe se nuk arrini ta kuptoni këtë, atëherë ju mund të adoptoni interpretimin e gabuar se Pali e lejonte imoralitetin!

Festimi i festave izraelite

Kapitulli 14 i Romakëve trajton festimin e festave, ngrënien e mishit (në kontrast me ngrënien e vetëm perimeve) dhe pirjen e verës. Ndër të tjera vija udhëzimi, Pali shtron këtë: «Gjithsecili të jetë plotësisht i bindur në mendjen e tij» (v. 5b). Kështu, në qoftë se ju e merrni atë jashtë kontekstit dhe në qoftë se ia zbatoni doktrinës së fymëzimit të Shkrimeve të Shenjta nga Fryma, ose shpëtimit me anë të hirit nëpërmjet besimit, atëherë ju me të vërtetë i keni shkaktuar problem vetes. Është tepër e rëndësishme të shohim se parimet e shtruara në Romakëve 14 trajtojnë gjëra që nuk janë të rëndësishme në vetvete (që nuk janë as të bardha as të zeza në vetvete).

Ushqime të pastra dhe të papastra

Në Titit 1, Pali u kushton vëmendje të veçantë atyre që po mundoheshin t'i vinin besimtarët nën Ligjin e Moisiut. Në vargun 15 apostulli thotë: «Gjithçka është e pastër për ata që janë të pastër, por asgjë nuk është e pastër për të ndoturit dhe për ata që nuk besojnë; madje edhe mendja, edhe ndërgjegjja e tyre janë të ndotura».

Duhet të jetë e qartë për ne kur Pali thotë: «Gjithçka është e pastër për ata që janë të pastër» se ai nuk po tregon për një të vërtetë universale por flet për llojet e mishit të

konsideruara si të papastra nga Ligji i Moisiut. Për të krishterët në këtë epokë hiri, të gjitha ushqimet që Perëndia na ka siguruar janë të pastra. Etiketat «e pastër» dhe e «papastër» nuk zënë më vend.

Vargu 14 në Romakëve 14 duhet të kuptohet në të njëjtën mënyrë: «Unë e di dhe jam plotësisht i bindur në Zotin Jezus, se asnjë gjë nuk është e ndyrë në vetvete...». Pali ashtu si edhe ne e dinte se kishte gjëra të papastra, por këtu ai po bën fjalë vetëm për ushqime si mish i dërrit, mish lepuri, të cilat ishin të papastra sipas ligjit të Dhiatës së Vjetër.

Gjëra jothemelore sot

Gjëra që në ditët tona mund të vendosen në këtë klasifikim janë:

- Verë apo lëng rrushi në Darkën e Zotit.
- Bukë me maja apo bukë pa maja.
- Një kupë apo shumë kupa.
- Kohët e takimeve.
- Përdorimi i mjeteve muzikore në takimet e kishës.
- Përdorimi i përkthimeve të ndryshme të Biblës.
- Metodikat e shërbimit të krishterë.

Në lidhje me çështjen e fundit në këtë listë, d.m.th. metodikat e shërbimit të krishterë, ka vend për përshtatje sipas kulturës dhe zakoneve të një vendi. Kështu në 1 Korintasve 9:19-23 Pali tregon sesi ai u përshtatej njerëzve, natyrisht pa komprometuar me ndonjë prej të vërtetave bazë dhe besnikërinë e tij ndaj Krishtit.

Sepse, ndonëse jam i liruar nga të gjithë, e bëra veten time shërbëtor të të gjithëve që të fitoj sa më shumë njerëz. Kështu e kam bërë veten time Jude me Judenjtë për t'i fituar Judenjtë; e kam bërë veten time si një që është nën Ligj me ata që janë nën Ligj për t'i fituar ata që janë nën Ligj; me ata që janë pa Ligj e kam bërë veten time si pa ligj (ndonëse nuk isha pa Ligjin e Zotit, por nën Ligjin e Krishtit), për të fituar ata që janë pa ligj. E kam bërë veten time të dobët me të dobëtit për të fituar të dobëtit; e kam bërë veten time gjithçka për të gjithë, që të mund të shpëtoj me çdo mënyrë disa njerëz. Dhe këtë e bëj për hir të Ungjillit, që të bëhem edhe unë pjesëtar i tij.

Por kur Pali thotë: «E kam bërë veten time gjithçka për të gjithë, që të mund të shpëtoj me çdo mënyrë disa njerëz», ai pa dyshim nuk komprometoi asnjë të vërtetë të Ungjillit dhe nuk mori pjesë në ndonjë aktivitet mëkatar. Ku ishte e mundur të bëhej një përshtatje pa e sakrifikuar të vërtetën (si në rastin e rrethprerjes së Timoteut, Veprat 16:3), ai e bëri këtë që mesazhi të dëgjohej nga më shumë njerëz. Por kur bëhej fjalë për të vërtetën e shpëtimit me anë të hirit dhe jo nëpërmjet mbajtjes së Ligjit (si në rastin e diskutimit për rrethprerjen e Titit, Galatasve 2:1-5), ai nuk anoi aspak.

Konkluzion

Tani le të përmbledhim materialin që sapo diskutuam.

Për sa u përket gjërave themelore dhe ligjeve morale të pandryshueshme të Perëndisë, duhet të ketë marrëveshje dhe bindje absolute.

Për sa u përket gjërave që janë të rëndësishme frymërisht, megjithëse jothemelore, secili besimtar duhet të gjykojë dhe të veprojë sa më afër me atë që thotë Fjala e Perëndisë.

Për sa u përket gjërave jothemelore, duhet të ketë vend për opinione të ndryshme për hir

të unitetit dhe paqes (Ef. 4:1-6). Por edhe në këtë rast i krishteri duhet të qëndrojë larg çdo lloji ligësie, të mos bëhet pengesë për një të krishterë tjetër dhe të mos bjerë ndesh me ndërgjegjen e tij.

Kur bëjmë fjalë për gjërat themelore dhe gjërat e rëndësishme, atëherë parime të caktuara bazë duhet të zbatohen. Por kur bëjmë fjalë për çështje të indiferencës morale, atëherë duhet të zbatohet një grup rregullash të tjerë. Kështu, kur flasim për hyjninë e Krishtit, Pali nuk lejonte vend për opinione të ndryshme duke thënë: «Secili të jetë plotësisht i bindur në mendjen e tij» (Rom. 5b). Ose kur bëhej fjalë për imoralitet, ai nuk thoshte: «E di dhe jam i bindur në Zotin Jezus Krishtin se asgjë nuk është e ndyrë në vetvete» (Rom. 14:14). Ne duhet të bëjmë dallimin nëse ai po bënte fjalë për çështje themelore, të vërteta të rëndësishme apo për gjëra anësore.

EPOKA TË NDRYSHME

Agustini ka thënë: «Bëni dallimin midis epokave dhe Shkrimet janë në harmoni». Perëndia e ka ndarë të gjithë historinë njerëzore në epoka: «...me anë të të cilit Ai krijoi epokat» (Heb. 1:2). Këto epoka mund të jenë të gjata ose të shkurtra. Por ajo që i dallon ato nuk është kohëzgjatja, por mënyra në të cilën Perëndia merret me njerëzimin.

Ndërsa vetë Perëndia kurrë nuk ndryshon, metodat e Tij ndryshojnë. Ne ndonjëherë flasim për mënyrën sesi Perëndia i administron punët e Tij me njeriun gjatë një ere të caktuar si përndarje¹. Teknikisht, një përndarje nuk nënkupton një epokë, por për më tepër një administrim, një përkujdesje, një rregull ose një ekonomi. Por është e vështirë për ne ta mendojmë një përndarje pa marrë parasysh kohën. Për shembull, historia e qeverisë së Shteteve të Bashkuara është ndarë në administrime të ndryshme. Ne flasim për administrimin e Rusveltit, të Eizenhaurit, ose për administrimin e Kenedit. Sigurisht, nënkuptojmë mënyrën në të cilën qeveria ka operuar ndërsa këta presidentë kanë qenë në drejtim. Gjëja e rëndësishme është: politikat që janë ndjekur, por ne patjetër i lidhim këto politika me një periudhë të caktuar kohe.

Kështu, në këtë mësim ne do ta mendojmë një përndarje si mënyra në të cilën Perëndia merret me njerëzit gjatë një periudhe të caktuar të historisë. Përndarjet e Perëndisë mund të krahasohen me mënyrat në të cilat drejtohet një shtëpi. Kur gjendet vetëm një burrë dhe një grua në shtëpi, ndiqet një program i caktuar. Por kur ka shumë fëmijë të vegjël, përdoret një program drejtimi tërësisht i ri. Ndërsa fëmijët rriten në maturë, punët e shtëpisë trajtohen ndryshe përsëri. Ne e vëmë re të njëjtën strukturë në trajtimet e Perëndisë me racën njerëzore (Gal. 4:1-5).

Për shembull, kur Kaini vrau vëllain e tij Abel, Perëndia vendosi një shenjë në të, me qëllim që kushdo që ta gjente atë të mos e vriste (Zan. 4:15). Por pas Përmbytjes, Perëndia nxori dënimin me vdekje, duke dekretuar se «Kushdo që derdh gjakun e njeriut, nga njeriu do të derdhet gjaku i tij» (Zan. 9:6). Pse ky ndryshim? Sepse ka pasur një ndryshim në përndarjet.

Një shembull tjetër. Në Psalmin 137:8, 9 shkrimtari kërkon dënim të ashpër mbi Babiloninë:

O bijë e Babilonisë, që duhet të shkatërrohesh, lum ai që do ta lajë të keqen që na ke bërë! Lum ai që merr foshnjat e tua dhe i përplas kundër shkëmbit!

Por më vonë Zoti i mësoi njerëzit e Tij:

Duajini armiqtë tuaj, bekonit ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin (Mat. 5:44).

Është e qartë se gjuha e përshtatshme për psalmistin që jeton nën Ligjin, nuk është më e përshtatshme për një të krishterë që jeton nën hirin.

Jo të gjithë të krishterët bien dakord me numrin e përndarjeve ose me emrat që duhet t'u vihen atyre. Në fakt, jo të gjithë të krishterët i pranojnë përndarjet.

Por ne mund ta tregojmë ekzistencën e përndarjeve si më poshtë. Së pari, ka të paktën dy përndarje — ligji dhe hiri: «Sepse Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jesus Krishtit» (Gjoni 1:17). Fakti se Bibla ndahet në Dhiatën e Vjetër dhe Dhiatën e Re tregon se ka ndodhur një ndryshim në administrim. Më tepër dëshmi jepet në

faktin se besimtarëve në këtë epokë nuk u kërkohet të ofrojnë flijime me kafshë; kjo gjithashtu tregon se Perëndia ka prezantuar një rregull të ri.

Por nëse biem dakord se ka dy përndarje, ne sforcohem të besojmë se ato janë tre, sepse Përndarja e Ligjit nuk u prezantua deri në kapitullin 19 të Eksodit, qindra vjet pas Krijimit. Kështu duhet të ketë pasur të paktën edhe një përndarje para Ligjit (shihni Rom. 5:14). Kjo bën të jenë tre.

Dhe pastaj ne do të binim dakord në një përndarje të katërt, sepse Shkrimet flasin për «epokën e ardhshme» (Heb. 6:5). Kjo, natyrisht, është koha kur Zoti Jezus Krisht do të kthehet për të sunduar mbi tokë, ndryshe e njohur si Mijëvjeçari.

Apostulli Pal gjithashtu bën dallimin midis epokës së tashme dhe asaj që do të vijë. Së pari, ai flet për një përndarje që iu dha Atij në lidhje me të vërtetën e Ungjillit dhe të Kishës (1 Kor. 9:17; Ef. 3:2; Kol. 1:25). Ajo është epoka e tanishme. Por pastaj ai gjithashtu i referohet epokës së ardhshme kur, në Efesianëve 1:10, ai i referohet si «përndarja e plotësisë së kohërave». Është e dukshme nga përshkrimi i tij për të se kjo përndarje nuk ka ardhur akoma.

Kështu ne e dimë se nuk po jetojmë në epokën e fundit të historisë së botës.

Dr. C. I. Skofildi, redaktori i Referencës Skofild të Biblës, tregon për shtatë përndarje, si më poshtë:

1. Pafajshmëria (Zan. 1:28). Nga krijimi i Adamit deri në rënien e tij në mëkat.
2. Ndërgjegjja ose përgjegjësia morale (Zan. 3:7). Nga rënia deri në fund të Përmbytjes.
3. Qeveria njerëzore (Zan. 8:15). Nga fundi i Përmbytjes deri në thirrjen e Abrahamit.
4. Premtimi (Zan. 12:1). Nga thirrja e Abrahamit deri në dhënien e Ligjit.
5. Ligji (Eksodi 19:1). Nga dhënia e Ligjit deri në Ditën e Rrëshajave.
6. Kisha (Veprat 2:1). Nga Dita e Rrëshajave deri në Rrëmbim.
7. Mbretëria (Zbu. 20:4). Sundimi njëmijëvjeçar i Krishtit.

Në listën e tij «Kursi i kohës nga përjetësia në përjetësi», A. E. Booth tregon për shtatë përndarje të historisë njerëzore të parashikuara në shtatë ditët e Zanafillës:

Dita e parë—Njeriu provohet me dritën e krijimit—dritë dhe premtim.

Dita e dytë—Qeverisje (nga Përmbytja deri në ndarjen e kombeve).

Dita e tretë—Izraeli (nga Abrahami deri në fund të Ungjijve).

Dita e katërt—Hiri.

Dita e pestë—Shtrëngesa.

Dita e gjashtë—Mijëvjeçari.

Dita e shtatë—Përjetësia.

Ndërsa nuk është e rëndësishme të biem dakord me të gjitha detajet ekzakte, është mjaft e rëndësishme të shohim se ka përndarje të ndryshme. Dallimi midis ligjit dhe hirit është veçanërisht i rëndësishëm. Përndryshe, ne do të marrim pjesë nga Shkrimet që kanë të bëjnë me epoka të tjera dhe t'ia referojmë vetes. Ndërsa të gjitha Shkrimet janë të dobishme për ne (2 Tim. 3:16), jo të gjitha na janë shkruar direkt ne. Pjesë që trajtojnë epoka të tjera gjejnë zbatime në ne, por interpretimi i tyre parësor është për epokën në të cilën ato u shkruan. Për shembull, çifutët që jetonin nën ligjin nuk lejoheshin të hanin mishin e ndonjë kafshe të papastër, domethënë, një që nuk ishte dythundrake dhe që nuk ripërtypej (Lev. 11:3). Ky moslejim nuk ka të bëjë me të krishterët sot (Mat. 7:18-19), por parimi bazë mbetet—që ne duhet të evitojmë papastërtinë morale dhe shpirtërore.

Perëndia i premtoi popullit të Izraelit se në qoftë se ata do t'i bindeshin Atij, Ai do t'i bënte të pasur materialisht (Ligji i Përtërirë 28:1-6). Atëherë theksi ishte vënë në bekimet materiale

në vendet tokësore. Por kjo nuk është e vërtetë sot. Perëndia nuk premton se Ai do të na shpërblejë me begati financiare sepse i bindemi Atij. Në vend të saj, bekimet e kësaj përndarjeje janë bekime prej frymës në vende qiellore (Ef. 1:3).

Ndërsa epokat ndryshojnë me njëra-tjetrën, një gjë kurrë nuk ndryshon dhe ai është Ungjilli. Shpëtimi gjithmonë ka qenë, është tani dhe do të jetë gjithmonë me anë të besimit në Zotin. Dhe baza e shpëtimit për çdo epokë është vepra e mbaruar e Krishtit në Kryqin e Kalvarit. Njerëzit në Dhiatën e Vjetër shpëtoheshin duke besuar çfarëdo zbuluese që Zoti u dha atyre. Për shembull, Abrahami u shpëtua duke i besuar Perëndisë, kur Ai tha se fara e patriarkut do të ishte aq e panumërt sa yjet (Zan. 15:5, 6). Abrahami nuk kishte njohuri se ç'do të ndodhte në Kalvar shekuj më vonë. Por Perëndia e dinte. Dhe kur Abrahami i besoi Zotit, Ai vuri në llogarinë e Abrahamit të gjithë vlerën e veprës së ardhshme të Krishtit në Kalvar.

Dikush ka thënë se shenjtoret e Dhiatës së Vjetër u shpëtuan «me kredi». Kjo do të thotë, se ata u shpëtuan në bazat e çmimit që Zoti Jezus Krisht do të paguante shumë vjet më vonë (ky është kuptimi i Romakëve 3:25). Ne shpëtohemi në bazën e veprës që Krishti përmbushi mbi 1900 vjet më parë. Por në të dy rastet shpëtimi është me anë të besimit në Zotin.

Ne duhet të ruhem nga ndonjë ide që nënkupton se njerëzit në Përndarjen e Ligjit u shpëtuan duke mbajtur Ligjin ose duke ofruar flijime të kafshëve. Ligji vetëm mund të dënojë; nuk mund të shpëtojë (Rom. 3:20). Dhe gjaku i qeve dhe dhive nuk mund të heqë as edhe një mëkat të vetëm (Heb. 10:4). Jo! Mënyra e Perëndisë për shpëtim është nëpërmjet besimit dhe vetëm besimit! (Shihni Romakëve 5:1).

Një tjetër pikë e rëndësishme për t'u mbajtur mend është kjo: kur flasim për epokën e tanishme si Epoka e Hirit, ne nuk themi se Perëndia nuk ishte i mëshirshëm në përndarjet e mëparshme. Ne thjesht nënkuptojmë se Perëndia tani po e provon njeriun nën hirin dhe jo nën ligjin. Ky dallim do të shpjegohet më tej në mësimin e ardhshëm.

Është gjithashtu e rëndësishme të kuptojmë se epokat nuk mbyllen me ndarje preçize. Shpeshherë ka një periudhë përjashtuese ose tranzitore. Ne e shohim këtë në librin e Veprave, për shembull; iu desh ca kohë Kishës së re të hidhte tej disa gjëra të panevojshme të përndarjes së mëparshme. Dhe ka mundësi të ketë një periudhë kohe midis Rrëmbimit dhe Shtërngesës gjatë së cilës Njeriu i Mëkatit do të manifestohet dhe Tempulli do të ngrihet në Jerusalem.

Një fjalë e fundit.

Ashtu si të gjitha gjërat e mira, studimi i përndarjeve mund të abuzohet. Ka disa të krishterë që i marrin përndarjet në një ekstrem të tillë, saqë ata marrin vetëm Letrat e Palit nga Burgu si të zbatueshme për Kishën sot! Si rezultat ata nuk e pranojnë pagëzimin ose darkën e Zotit, meqë ato nuk gjenden në Letrat e Burgut. Ata gjithashtu mësojnë se mesazhi i ungjillit të Pjetrit nuk ishte i njëjtë me atë të Palit. (Shihni Galatasve 1:8, 9 për hedhjen poshtë të kësaj). Këta njerëz ndonjëherë quhen ultra-përndarës ose Bullingeritas (sipas emrit të një mësuesi të quajtur E. Bullinger). Pikëpamja e tyre ekstreme e përndarjeve duhet të hidhet poshtë.

Shënime:

1. Folja «përndaj» do të thotë: I jap secilit pjesën që i takon nga një e tërë a nga një grumbull gjërash. Në këtë mësim ne do ta mendojmë një përndarje si mënyra në të cilën Perëndia merret me njerëzit gjatë një periudhe të caktuar të historisë

BESËLIDHJET MË TË RËNDËSISHME TË SHKRIMEVE TË SHENJTA

Në intervale të ndryshme të historisë njerëzore, Perëndia bëri marrëveshje ose besëlidhje me njerëzimin. Disa prej tyre, si Ligji, ishin besëlidhje të kushtëzuara. Perëndia do ta mbante pjesën e Tij të besëlidhjes, po qe se ata do të mbanin të tyren. Besëlidhjet e kushtëzuara ishin «të vështira për t'u mbajtur» dhe njerëzit patjetër dështuan në plotësimin e kushteve.

Për fat të mirë, shumica e besëlidhjeve hyjnore ishin të pakushtëzuara. Në to, gjithçka varej në Zotin dhe kjo garanton përmbushjen e tyre.

Shumica e besëlidhjeve u bënë me Abrahamin dhe pasardhësit e tij. Asnjë prej tyre nuk është bërë në mënyrë direkte me Kishën, megjithëse Kisha përfshihet në disa prej tyre, siç do ta shohim më poshtë.

Edeni (Zan. 1:28-30; 2:16-17)

Besëlidhja Edenike e bëri njeriun, në pavetëdijen e tij, të ishte i përgjegjshëm për shumëzim, për të populluar tokën dhe për ta nënshtuar atë. Atij iu dha pushtet të sundonte mbi gjithë kafshët. Ai duhej të kujdesej për kopshtin dhe të hante nga gjithë prodhimtaria prej tij, përveç frutit të njohurisë të së mirës dhe të ligës. Mosbindja për të zbatuar këtë urdhëresë do të rezultonte në vdekje. Kështu, kjo ishte një besëlidhje me kushte.

Adami (Zan. 3:14-19)

Pas rënies së njeriut në mëkat, Perëndia e mallkoi gjarprin dhe tregoi për armiqësinë midis gjarprit dhe gruas, midis Satanit dhe Krishtit. Satani do t'i linte plagë Krishtit, por Krishti do ta shkatërronte Satanin. Gruaja do të përjetonte dhimbjet e lindjes dhe do të ishte nën autoritetin e burrit. Toka u mallkua: njeriu do të mendohej së tepërmi me gjembat dhe ferrat në kultivimin e saj. Kjo botë do të përfshinte djersë dhe lodhje dhe përfundimisht njeriu do të kthehet në pluhur, nga i cili erdhi.

Noeu (Zan. 8:20-9:27)

Perëndia i premtoi Noeut se Ai nuk do ta mallkonte përsëri tokën me ndonjë përmbytje, kështu krijoi ylberin si një garanci. Dënimi me vdekje i kësaj besëlidhjeje për rastet e krimeve, tregon se do të ketë qeverisje, e cila do t'i gjykonte këto raste dhe do të jepte gjykimin e duhur. Kështu, në të vërtetë, besëlidhja me Noeun përbën fillimin e qeverisjes njerëzore. Perëndia siguroi rregullin e periudhave të kohës dhe të stinëve, drejtoi njeriun të popullonte tokën dhe riafirmoi zotërimin e tij mbi krijesat më të ulëta. Tani njeriu mund t'i shtonte edhe mish dietës së tij të mëparshme vetëm prej perimesh. Për sa u përket pasardhësve të Noeut, Perëndia e mallkoi djalin e Kamit, Kanaanin, duke e bërë shërbëtor të Semit dhe të Jafetit. Ai e favorizoi Semin, të cilin siç e dimë, është në gjenealogjinë e Mesias. Jafeti do të shtohet së tepërmi dhe to të jetonte në tendat e Semit. Besëlidhja me Noeun ishte pa kushte dhe kurrë nuk është thyer. Ajo ishte për «të gjithë brezat e ardhshëm» (Zan. 9:12).

Abrahami (Zan. 12:1-3; 13:14-17; 15:1-5; 17:1-8)

Kjo besëlidhje përfshin premtimet pa kushte të bëra me Abramin, (më vonë i quajtur Abraham) dhe me pasardhësit e tij: një komb i madh (Izraeli); bekime personale; një emër të madh; një burim bekimesh për të tjerët (12:2). Bekime hyjnore për miqtë e tij dhe mallkime mbi armiqtë e tij; bekime për të gjitha kombet (e përmbushur nëpërmjet Krishtit) (12:3). Zotërim të përjetshëm të tokës fillimisht të njohur si Kanaani dhe më vonë si Izraeli dhe

Palestina (15:18). Bekime të panumërta në pasuri natyrore dhe frymërore (13:16; 15:5). Ati i shumë kombeve dhe i mbretërve (nëpërmjet Ismaelit dhe Isakut) (17:4, 6). Një marrëdhënie të veçantë me Perëndinë (17:7b).

Ligji, gjithashtu i njohur si Besëlidhja me Moisiun (Eks. 19:5; 20-31)

Në kuptimin e gjerë të fjalës, Ligji i Moisiut përfshin 10 Urdhëresat, të cilat përshkruajnë detyrat e njeriut para Perëndisë dhe ndaj fqinjit të tij (Eks. 20); një seri rregullash në lidhje me jetën e kombit të Izraelit (Eks. 21:1-24:11); dhe shugurime të detajuara në lidhje me jetën fetare (Eks. 24:12-31:18). Ligji iu dha kombit të Izraelit dhe jo kombeve të tjerë dhe u konfirmua me gjak (Eks. 24:8; Heb. 9:19-20). Kjo ishte një besëlidhje me kushte, e cila kërkonte që njeriu të bindej dhe kështu kjo «ishte pa forcë për shkak të mishit» (Rom. 8:3a). Ligji nuk u dha për të siguruar shpëtim, por për të bindur njerëzit për mëkatet dhe dështimin e tyre (Rom. 3:20b). Nëntë nga Dhjetë Urdhëresat janë përsëritur në Dhiatën e Re (Shabati nuk është përfshirë) jo si ligj me një dënim të bashkëngjitur, por si një sjellje e përshtatshme për ata që janë shpëtuar me anë të hirit. I krishteri është nën hirit, jo nën ligjin, por ai është «nën ligjin» e Krishtit (1 Kor. 9:21), një përkufizim shumë më i lartë. Ligji nuk e anuloi Besëlidhjen me Abrahamin (Gal. 3:17-18).

Palestina (Ligji i Përt. 28:1; 29:1-30:20).

Kjo besëlidhje gjendet në formën e bërthamës në Zan. 15:18, kur Perëndia i premtoi Abrahamit tokën «nga lumi i Egjiptit (Përroi i Egjiptit, jo lumi i Nilit) deri te lumi i madh, Lumi i Euftratit». Kjo parashikon shpërndarjen e Izraelit në kombet e tjerë përreth për arsye të mosbindjes dhe pabesnikërisë, kthimin te Zoti në Ardhjen e Dytë të Tij, pendimin dhe shpëtimin e tyre, dënimin e armiqve të tyre dhe banimin e sigurt në këtë tokë nën sundimin e Mesias.

Izraeli asnjëherë nuk e ka zotëruar plotësisht këtë tokë. Gjatë sundimit të Salomonit, kombe në lindje të Izraelit paguan taksa (1 Mbret. 4:21, 24), por kjo nuk mund të konsiderohet si zotërim apo pushtim i kësaj toke. Përmbushja e Besëlidhjes Palestinase akoma është në të ardhmen.

Davidi (2 Sam. 7:1-17)

Perëndia i premtoi Davidit se mbretëria e Tij, jo vetëm që do të ekzistonte përgjithmonë, por do të kishte edhe pasardhës që do të ulëshin në fron (2 Sam. 7:12-16). Kjo ishte një besëlidhje pa kushte, e cila nuk varej aspak nga bindja apo drejtësia e Davidit. Krishti është trashëgimtari i ligjshëm i fronit të Davidit që me Salomonin, ashtu siç e shohim qartë në gjenealogjinë e Jozefit në Mateun 1. Jozefi e adoptoi Jezusin si bir të tijin. Krishti është pasardhësi në linjën e pasardhësve të Davidit duke filluar me Nathanin, siç e shohim në gjenealogjinë e Marias në Llukën 3. Meqë Ai jeton përgjithmonë, atëherë nuk mund të ketë ndonjë pretendues tjetër për fronin. Mbretëria e Tij është e përjetshme. Sundimi i Tij 1000 vjeçar do të pasohet nga mbretëria e përjetshme.

Salomoni (2 Sam. 7:12-15; 1 Mbret. 9; 2 Kron. 7)

Besëlidhja me Salomonin ishte pa kushte për sa i përket mbretërisë së përjetshme, por me kushte për sa u përket pasardhësve që do të ulëshin në fron (1 Mbret. 9:4-5; 2 Kron. 7:17-18). Njëri nga pasardhësit e Salomonit, Koniahu (gjithashtu i quajtur Jekoniahu dhe Jehojakini), e la pa fëmijë që të mos kishte ndonjë pasardhës fizik për t'u ulur në fronin e Davidit (Jer. 22:30). Jezusi nuk është pasardhës i Salomonit, siç e pamë më lart. Përndryshe Ai do të ishte nën mallkimin e Koniahut.

Besëlidhja e Re (Jer. 31:31-34; Heb. 8:7-12; Llu. 22:20)

Besëlidhja e Re është bërë me shtëpinë e Izraelit dhe shtëpinë e Judas (Jer. 31:31) dhe ia kalon Besëlidhjes së Vjetër (Moisiu). Kjo ka një priftëri më të mirë, një kryeprift më të mirë, flijim më të mirë, altar më të mirë dhe qëndron në premtime më të mira (Heb. 7-9; 13:10). Ishte akoma në të ardhmen kur Jeremia shkroi për të (Jer. 31:31a). Kjo nuk ishte besëlidhje me kushte, si Ligji i Moisiut, të cilin Izraeli e shkeli (Jer. 31:32). Në të Perëndia premton pa kushte (vini re përsëritjen e shprehjes «Unë do të»: rilindjen e Izraelit në të ardhmen (Ezek. 36:25-26); brendabanimin nga Fryma e Shenjtë (Ezek. 36:27); një zemër që do të bëjë vullnetin e Perëndisë (Jer. 31:33a); njohuri të përgjithshme të ligjit në Izrael (Jer. 31:34a); falje dhe moskujtim të mëkateve (Jer. 31:34b); dhe vazhdimësi të kombit përgjithmonë (Jer. 31:35-37).

Izraeli, si komb nuk i ka shijuar akoma privilegjet e besëlidhjes së re, por kjo do të ndodhë me Ardhjen e Dytë. Ndërkohë, besimtarët e vërtetë gëzojnë disa nga bekimet e besëlidhjes. Ata shijojnë faljen edhe moskujtimin e mëkateve (Heb. 10:16-17) dhe iu është dhënë fuqi për të përmbushur kërkesat e drejta të ligjit (Rom. 8:4). Fakti se Kisha ka të bëjë me Besëlidhjen e Re shihet në Darkën e Zotit, ku kupa simbolizon besëlidhjen dhe gjakun, me anë të të cilit kjo besëlidhje u dekretua (Lluka 22:20; 1 Kor. 11:25)¹. Gjithashtu Pali iu referua vetvetes dhe apostujve të tjerë si «shërbyes të një besëlidhjeje të re» (2 Kor. 3:6), duke nënkuptuar Ungjillin e hirit të Perëndisë.

Shënime:

1. J. N. Darbi ka theksuar se Kisha e njej në mënyrë personale Ndërmjetësin e Besëlidhjes së Re, që është më e mirë se të ishte subjekti kryesor i besëlidhjes së Re.

IZRAELI DHE KISHA

Ne ndoshta mund ta zgjeronim këtë titull duke e quajtur «Kombet joçifute, Izraeli dhe Kisha». Arsyeya për të cilën e themi këtë është se Dhiata e Re e ndan të gjithë njerëzimin në tre kategori. Për shembull, Pali thotë në 1 Korintasve 10:32, «Mos u bëni shkak skandali as për çifutët, as për joçifutët, as për kishën e Perëndisë».

Në Veprat 15:14-17 këto tre ndarje të njerëzimit janë përmendur përsëri:

Kisha

... i ka vizituar për herë të parë Perëndia, joçifutët, që të zgjedhë nga ata një popull për emrin e Tij (v. 14).

Izraeli

Pas këtyre gjërave, unë do të kthehem dhe do ta rindërtoj tabernakullin e Davidit që është rrezuar, do t'i restauroj gërmadhat e tij dhe do ta ngre përsëri më këmbë (v. 16).

Kombet joçifute

Që mbetja e njerëzve dhe të gjithë joçifutët mbi të cilët thirret emri im, të kërkojnë Zotin, thotë Zoti që i bën të gjitha këto (v.17).

Apostulli Pal bëri gjithashtu dallimin midis

çifutëve—rrethprerja e bërë me duar (Ef. 2:11).

joçifutëve—mosrrethprerjen (Ef. 2:11).

Kishës—rrethprerjen e bërë pa duar (Kol. 2:11).

Në përgjithësi, studentët e Biblës nuk i ngatërrojnë joçifutët me Izraelin ose me Kishën; kjo nuk ka qenë problem. Kështu në këtë mësim do të merremi vetëm në dallimin midis Izraelit dhe Kishës. Kjo është e një rëndësie të madhe. Po të arrijmë të shohim se këta dy grupe janë të ndarë dhe të dallueshëm, atëherë kjo do të na ndihmojë në interpretimin e Biblës, veçanërisht në fushën e të vërtetës dhe profecisë së Kishës.

Që të tregojmë pse kjo temë është e rëndësishme, ne duhet të përmendim se disa njerëz mësojnë se Kisha është thjeshtë një zgjatje ose një shtojcë e Izraelit. Ata thonë: «Perëndia ka pasur një Kishë në vazhdimësi nëpër shekuj. Izraeli ishte Kisha në Dhiatën e Vjetër, por kur ky popull e hodhi poshtë Mesinë, Perëndia i hodhi poshtë ata përgjithmonë. Nuk ka të ardhme për Izraelin në mënyrë kombëtare. Kisha e Dhiatës së Re është bërë tani Izraeli i Perëndisë dhe të gjitha premtimet që i janë bërë Izraelit në mënyrë kombëtare tani kanë një përmbushje shpirtërore për Kishën».

Ne besojmë se Shkrimet na mësojnë ndryshe—se Izraeli dhe Kisha janë të ndryshme në origjinë, karakter, përgjegjësi dhe paracaktim.

Kur Izraeli e hodhi poshtë Zotin Jezus si Mesinë e tij, Perëndia e la mënjanë kombin për ca kohë. Pastaj Ai paraqiti diçka krejt të re—Kishën. Kur programi i Tij me Kishën të përfundojë në tokë, Ai do të vazhdojë me trajtimet e Tij me Izraelin në rang kombëtar. Kështu Kisha ka hyrë gjatë ndërprerjes së marrëdhënieve të Perëndisë me Izraelin, popullin e Tij të lashtë.

Dallimi midis Kishës dhe Izraelit mund të shihet më mirë nëpërmjet kontrasteve të mëposhtme.

Kisha

Izraeli

<p>1. Pali flet për kishën si një mister "që nuk iu bë i njohur në epokat e tjera bijve të njerëzve, ashtu si iu zbulua tani apostujve të shenjtë dhe profetëve të tij me anë të Frymës" (Ef. 3:5). Ai thotë se ky mister ishte fshehur në Perëndinë që nga fillimi i botës (Ef. 3:9) dhe ishte mbajtur sekret qëkur bota filloi, por që tani është manifestuar me anë të Shkrimeve profetike (Rom. 16:25, 26). (Shihni gjithashtu Kol. 1:25, 26).</p> <p>2. Kisha filloi në Ditën e Rrëshajave kur Fryma e Shenjtë u dha (Veprat 2). Ne e nxjerrim këtë nga seria e fakteve të mëposhtme.</p> <p>a. Kisha ishte akoma në të ardhmen kur Krishti ishte mbi tokë, sepse Ai tha: "Unë do ta ndërtoj kishën Time" (Mat. 16:18).</p> <p>b. Kur Pali e shkroi Letrën e tij të Parë Korintasve, Kisha në atë kohë ishte formuar. Ai flet për besimtarët, të pagëzuar nga Fryma në trupin e Krishtit (1 Kor. 12:13).</p> <p>c. Ne e dimë se pagëzimi i premtuar nga Fryma ngjau Ditën e Rrëshajave. Kështu ajo ishte datëlindja e Kishës.</p> <p>3. Krishti është Kreu i Kishës.</p> <p>4. Anëtarësia në Kishë është nëpërmjet lindjes prej Frymës.</p> <p>5. Kisha është populli qiellor i Perëndisë. Bekimet e Kishës janë bekime të Frymës në vende qiellore.</p>	<p>1. Kurrë nuk flitet për Izraelin si mister. Asnjë nga përshkrimet në kolonën tjetër nuk janë të vërteta për Izraelin.</p> <p>2. Kombi i Izraelit filloi me thirrjen e Abrahamit (Zan. 12).</p> <p>3. Abrahami ishte kreu i Izraelit.</p> <p>4. Anëtarësia në komb ishte nga lindja natyrore.</p>
---	---

Edhe shumë kontraste të tjera midis Kishës dhe Izraelit mund të jepeshin. Në Teologjinë Sistematike të tij, Chafer numëron njëzet e katër dallime të pagabueshme. Por ato që ne kemi dhënë duhet të jenë të mjaftueshme për të treguar se Kisha zë një vend të veçantë në planet e në qëllimet e Perëndisë dhe se nuk duhet të ngatërrohet me Izraelin.

Një nga pjesët e Shkrimit, në të cilin Izraeli dhe Kisha ngatërrohen, është Predikimi Profetik, që gjendet në Mateun 23:37-25:46. Kjo pjesë flet për Izraelin—jo për Kishën. Ai përshkruan gjendjen para dhe gjatë ardhjes së Krishtit për të sunduar si Mbret. Vini re çfarë thuhet në 24:16: «Atëherë ata që janë në Jude, le të ikin ndër male»—lokalizimi është qartësisht çifut. Dhe në vargun 20 lexojmë: «Dhe lutuni që ikja juaj të mos ndodhë ... të shtunën». Shabati (e shtuna) kurrë nuk u dha për Kishën—vetëm për Izraelin. Të zgjedhurit e përmendur në vargun 22 janë të zgjedhurit çifutë të Perëndisë. Ardhja e Krishtit e përshkruar në vargun 30 nuk është ardhja e Tij në ajër për Kishën, por ardhja e Tij në tokë si Mbreti i Izraelit.

Kështu një student i Biblës duhet të dallojë nëse një pjesë i referohet Izraelit apo Kishës. Po qe se ai po lexon rreth Ditës së Zotit, ai mund të jetë i sigurt se pjesa i referohet kryesisht Izraelit. Në anën tjetër, po qe se ka referime për Ditën e Krishtit, ai mund të jetë i sigurt se është vënë në dukje Kisha. Kështu trumbeta e shtatë e Zbulesës 11 ka të bëjë me Izraelin, sepse ajo është pjesë e Ditës së Zotit. Por «boria e fundit» e 1 Korintasve 15:52 ka të bëjë me Kishën, sepse tema është Rrëmbimi dhe Rrëmbimi është i lidhur me Ditën e Krishtit.

Në mbyllje, ne duhet të kemi parasysh dy nga argumentet më shpesh të përdorur për të provuar se Kisha nuk është e ndarë nga Izraeli.

1. Në Veprat 7:38 Izraeli thirret «kisha është në shkretëtirë». Por ne duhet të kuptojmë se fjala «kishë» thjeshtë do të thotë një asamble ose bashkësi njerëzish. E njëjta fjalë përdoret për të përshkruar një grup nëpunësish aziatikë paganë në Efes (Veprat 19:32). Kisha e Dhiatës së Re identifikohet si e lidhur me Perëndinë Atin dhe Zotin Jezus Krisht.

2. Në Galatasve 6:16 Pali thotë: «Dhe të gjithë ata që do të ecin sipas kësaj rregulle paçin paqe dhe mëshirë, e ashtu qoftë edhe për Izraelin e Perëndisë». Shprehja «Izraeli i Perëndisë» përdoret për të deklaruar se sot të gjithë besimtarët përbëjnë «Izraelin e Perëndisë». Por ne besojmë se ky është një keqkuptim. Kur Pali thotë: «Paqja qoftë mbi ta», ai u referohet të gjithë besimtarëve. Por me fjalët «Izraeli i Perëndisë», Pali tregon për këta besimtarë të lindur çifutë, të cilët ecin sipas rregullit të krijimit të ri (v. 15) dhe jo sipas rregullit të Ligjit.

LIGJI DHE HIRI

Ligji dhe hiri janë dy mënyra të kundërta në të cilat Perëndia merret me njerëzimin. Ne mund t'i përshkruajmë si parime të ndryshme, nën të cilat Ai provon njeriun. Ose ne i mendojmë ato si dy besëlidhje që Ai ka bërë me njerëzit e Tij: «Sepse Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jezus Krishtit» (Gjoni 1:17).

Nën parimin e ligjit, njeriu merr atë çfarë ai fiton ose meriton. Nën hirin ai shpëtohet nga çfarë meriton dhe pasurohet përtej ç'ka mund të përshkruhet — e gjitha si një dhuratë falas. Dy parimet përshkruhen në Romakëve 4:4, 5:

Edhe atij që vepron, shpërblimi nuk i konsiderohet si hir, por si borxh; ndërsa atij që nuk vepron, por beson në atë që shfaqëson të paudhin, besimi i tij i numërohet për drejtësi.

Hiri dhe ligji janë të dy të papajtueshëm; domethënë, ata nuk mund të përzihen. «Po të jetë prej hirit, nuk është më prej veprash, përndryshe hiri nuk do të ishte më hir...» (Rom. 11:6).

Ligji është një besëlidhje me kushte: Perëndia thotë: «Në qoftë se ju do të bindeni, Unë do t'ju shpërblej, por në qoftë se nuk do të më bindeni, Unë do t'ju dënoj». Hiri është një besëlidhje pa kushte: Perëndia thotë: «Unë do t'ju bekoj ju falas».

Ligji thotë «Bëni», ndërsa hiri thotë «Besoni». Por të besuarit nuk është kusht; ai është i vetmi reagim i arsyeshëm i një krijese ndaj Krijuesit. Dhe nuk është se e meriton; askush nuk mund të jetë krenar se ka besuar në Zotin. Do të ishte budallallëk të mos besojë në Personin e vetëm në univers, në të cilin mund të varesh.

Nën ligjin kërkohet shenjtëri, por nuk jepet aspak fuqi për të jetuar një jetë të shenjtë. Nën hirin shenjtërimi mësohet (Tit. 2:11, 12) dhe fuqia e nevojshme na është dhënë. Dikush e ka thënë në këtë mënyrë: «Ligji kërkon forcë nga dikush që nuk ka aspak dhe e mallkon atë në qoftë se ai nuk mund ta zbatojë atë. Hiri i jep forcë atij që nuk ka aspak dhe e bekon atë në shfaqjen e hirit».

Ligji sjell mallkim: «I mallkuar është kushdo që nuk qëndron në të gjitha ato që shkruhen në librin e ligjit për t'i praktikuar» (Gal. 3:10). Hiri sjell bekim: «Janë shfaqësuar falas me anë të hirit të Tij, nëpërmjet shpengimit që është në Krishtin Jezus» (Rom. 3:24).

Nën ligjin inkurajohet mburrja, por nën hirin ajo përjashtohet. «Ku është, pra, mburrja? Është përjashtuar. Nga cili ligj? Ai i veprave? Jo, por nga ligji i besimit» (Rom. 3:27).

Nuk mund të ketë ndonjë siguri shpëtimi nën ligjin; një njeri nuk mund ta dijë kurrë nëse ka bërë mjaft vepra të mira ose vepra të dhura. Nën hirin ka siguri të plotë, sepse shpëtimi është një dhuratë; ti e di kur e ke marrë një dhuratë!

Një person nën ligjin nuk mund ta ketë sigurinë e vërtetë, sepse ai nuk mund të jetë i sigurt se do të vazhdojë të plotësojë kërkesat. Nën hirin besimtari e shijon sigurinë e përjetshme (Gjoni 10:27-29), sepse shpëtimi i tij varet në veprën e Krishtit.

Nuk ka shpëtim nëpërmjet ligjit. Perëndia kurrë nuk pati si qëllim që dikush të shpëtohej në atë parim. Qëllimi i ligjit është për t'i treguar njeriut se është mëkatar. «... me anë të ligjit në fakt arrihet njohja e mëkatit» (Rom. 3:20)—jo njohuria e shpëtimit.

Shpëtimi është me anë të hirit (Ef. 2:8, 9). Ai është dhurata falas, e pamerituar e Perëndisë për ata që e marrin Zotin Jezu Krisht si shpresën e tyre të vetme për qiellin.

Nën ligjin mëkati nxitet (Rom. 7:8-13); nën hirin ai poshtërohet. Kur njeriu mëkatar vihet nën ligjin, ai menjëherë dëshiron të bëjë atë çfarë është e ndaluar. Nuk është faji i ligjit, por

është reagimi i mëkatit në natyrën e njeriut. Nën hirin, mëkati poshtërohet. Kur kujtojmë se çfarë i kushtoi Shpëtimtarit për mëkatet tona, kjo na bën që të largohemi prej tyre.

Nën ligjin puna kurrë nuk mbarohet. Për këtë arsye Shabati, dita e shtatë, mori fund në një javë pune. Hiri na tregon për një vepër të mbaruar, kështu ne fillojmë me Ditën e Zotit, si ditën tonë të pushimit.

Ligji i tregon njeriut çfarë duhet të bëjë. Hiri na shfaq atë çfarë Perëndia ka bërë në Krishtin.

Ligji është një sistem prangash (Gal. 4:1-3); hiri është një sistem lirie (Gal. 5:1). Njerëzit nën ligjin janë shërbëtorë; njerëzit nën hirin janë bij.

Ligji thotë: «Ju do të doni...». Hiri thotë: «Perëndia aq shumë e deshi...».

Ligji thotë: «Bëni dhe do të jetoni». Hiri thotë: «Jetoni dhe do të bëni».

Ligji thotë: «Provoni dhe bindjuni». Hiri thotë: «Besoni dhe bindjuni».

Nën ligjin një bir i pabindur nxirrej jashtë qytetit dhe gjuhej me gurë për vdekje (Ligji i Përt. 21:18-21). Nën hirin biri i larguar mund ta pohojë mëkatin e tij dhe mund të kthehet përsëri në bashkësinë e shtëpisë së babait të tij (Lluka 15:21-24).

Nën ligjin delet vdesin për bariun. Nën hirin bariu vdes për delet (Gjoni 10:11).

Superioriteti i hirit është përshkruar si më poshtë: hiri nuk kërkon njerëz të mirë të cilët mund t'i aprovojë, sepse nuk është hiri por drejtësia ajo që aprovon mirësi; por hiri po kërkon njerëz të dënuar, fajtorë, të pa gojë dhe të pandihmë, të cilët mund t'i shpëtojë, shenjtërojë dhe përlevdojë.

KISHA DHE MBRETËRIA

Ndoshta për shumë lexues kjo do të jetë një surprizë kur të mësojnë se Kisha nuk është e njëjtë me mbretërinë e Perëndisë ose me mbretërinë e qiellit. Në Krishterimin në gjerësi, Kisha dhe mbretëria merren zakonisht si të njëjta. Por mosarritja e dallimit të tyre të çon në probleme serioze në doktrinë dhe në praktikë.

Në kapitullin e parafundit ne diskutuam mjaft për kishën dhe kështu nuk është e nevojshme ta përsërisim tërë materialin. Është e mjaftueshme t'i kujtojmë vetes se Kisha është një shoqëri e vetme, e ndryshme nga ndonjë tjetër e trajtuar nga Perëndia. Krishti është Koka dhe gjithë besimtarët janë gjymtyrët. Dallime të racës, statusit shoqëror, të seksit janë zhdukur në Krishtin; të gjithë bëhen një në Të. Kisha filloi në Ditën e Rrëshajave dhe do të plotësohet në Rrëmbimin. Për të flitet si trupi dhe nusja e Krishtit dhe është e paracaktuar të sundojë me Të në Mbretërinë e Tij dhe të ndajë lavdinë e Tij përjetë.

Po mbretëria e qiellit? Mbretëria e qiellit është fusha në të cilën njihet sundimi i Perëndisë. Fjala qiell përdoret në mënyrë figurative për të përcaktuar Perëndinë; kjo tregohet ekzaktësisht në Danielin 4:25, 26. Në vargun 25, Danieli thotë se Më i Larti sundon mbretërinë e njerëzve. Në vargun tjetër që pason, ai thotë se qielli sundon. Kështu mbretëria e qiellit lajmëron sundimin nga Perëndia, që ekziston kudo që njerëzit i nënshtrohen atij sundimi.

Gjenden dy aspekte të mbretërisë së qiellit. Aspekti i gjerë përfshin gjithkënd që thjesht pohon Perëndinë si Sundimtarin Suprem. Por aspekti i saj i brendshëm përfshin vetëm njerëz që janë shpëtuar vërtet. Ne mund ta portretizojmë këtë nëpërmjet dy rathëve njëcentrikë, një rrethi të vogël brenda një të madhi.

Rrethi i madh është fusha e pohimit; përfshin të vërtetët dhe të rremët, grurin dhe egjren. Rrethi i brendshëm përfshin vetëm ata që janë lindur përsëri nëpërmjet besimit në Zotin Jezu Krisht.

Nëpërmjet krahasimit të të gjitha referimeve biblike për mbretërinë, ne mund ta ndajmë zhvillimin e saj historik në pesë faza të ndryshme.

Së pari, mbretëria është profetizuar në Dhiatën e Vjetër. Danieli parashikoi se Perëndia do të ngrëjë një mbretëri, që nuk do të shkatërrohet kurrë dhe se kurrë nuk do t'ia dorëzojë sovranitetin e saj ndonjë populli tjetër (Dan. 2:44). Ai gjithashtu parashikoi ardhjen e Krishtit dhe mbizotërimin e Tij universal dhe të përjetshëm (Dan. 7:13, 14; shihni gjithashtu Jer. 23:5, 6).

Së dyti, mbretëria është përshkruar sikur është afër dhe e pranishme në Personin e Mbretit. I pari, Gjon Pagëzori, pastaj Jezusi dhe pastaj dishepujt lajmëruan se mbretëria ishte afër (Mat. 3:2; 4:17; 10:7). Mbreti kishte ardhur t'i paraqiste Vetën kombit të Izraelit. Jezusi tha: «... në qoftë se Unë i dëboj djajtë me ndihmën e Frymës së Perëndisë, atëherë mbretëria e Perëndisë ka ardhur në mesin tuaj» (Mat. 12:28). Në një rast tjetër Ai tha: «... mbretëria e Perëndisë është në mesin tuaj» (Luka 17:21). Ishte e pranishme sepse Mbreti kishte arritur në skenë. (Ndërsa dy referimet e fundit kanë të bëjnë me mbretërinë e Perëndisë më shumë sesa me mbretërinë e qiellit, ne do të tregojmë më vonë se dy termat përdoren duke zëvendësuar njëri-tjetrin në Dhiatën e Re).

Së treti, mbretëria është përshkruar si një formë interval. Pasi Ai u hodh poshtë nga kombi i Izraelit, Mbreti u kthye në qiell. Mbretëria ekziston sot në zemrat e të gjithë atyre që e njohin mbretërimin e Tij ndërsa Mbreti mungon dhe parimet etike dhe morale të mbretërisë janë të zbatueshme për ne sot. Kjo fazë intervali e mbretërisë përshkruhet në shëmbëlltyrat në Mateun 13.

Faza e katërt e mbretërisë është manifestimi i saj. Ky është sundimi një mijëvjeçar i Krishtit mbi tokë. Ishte paratreguar në Malin e Shndërrimit, kur Zoti u pa në lavdinë e sundimit të ardhshëm të Tij (Mat. 16:28). Jezusi iu referua mbretërisë, kur Ai tha: «Shumë do të vijnë nga lindja dhe nga perëndimi dhe do të ulen në tryezë me Abrahamin me Isakun dhe me Jakobin, në mbretërinë e qiejve» (Mat. 8:11).

Forma e pestë dhe e fundit do të jetë mbretëria e përjetshme. Ajo përshkruhet në 2 Pjetri 1:11 si «mbretëria e përjetshme e Zotit dhe Shpëtimtarit Jezu Krisht».

Fraza «mbretëria e qiellit» gjendet vetëm në Ungjillin e Mateut. Termi «mbretëria e Perëndisë» gjendet në të katër Ungjijtë. Për të gjitha qëllimet praktike nuk ka asnjë ndryshim; të njëjtat gjëra thuhën për të dyja ato. Për shembull, në Mateun 19:23 Jezusi tha se do të ishte e vështirë për një njeri të pasur të hynte në mbretërinë e qiellit. Në Markun 10:23 dhe Llukën 18:24 Jezusi citohet duke thënë të njëjtën gjë në lidhje me mbretërinë e Perëndisë. Pastaj Mateu gjithashtu citon Jezusin duke thënë pikërisht të njëjtën gjë në lidhje me mbretërinë e Perëndisë (krahaso Mat. 19:23, 24).

Pjesë të tjera ku mbretëria e qiellit dhe mbretëria e Perëndisë përdoren duke zëvendësuar njëra-tjetrën janë:

- Mat. 4:17 krahaso me Marku 1:15
- Mat. 8:11 krahaso me Lluka 13:29
- Mat. 10:7 krahaso me Lluka 9:2
- Mat. 11:11 krahaso me Lluka 7:28
- Mat. 13:11 krahaso me Marku 4:11
- Mat. 13:31 krahaso me Marku 4:30, 31; Lluka 13:18
- Mat. 13:33 krahaso me Lluka 13:20, 21
- Mat. 19:14 krahaso me Marku 10:14; Lluka 18:16

Ne përmendëm se mbretëria e qiellit ka një aspekt të jashtëm dhe një realitet të brendshëm. E njëjta është e vërtetë edhe për mbretërinë e Perëndisë. Kjo mund të tregohet si më poshtë:

Mbretëria e qiellit	Mbretëria e Perëndisë
Në aspektin e saj të jashtëm ajo përfshin të gjithë ata që janë nën sundimin e Mbretit, dhe gjithashtu ata që thjesht pohojnë besnikëri ndaj Tij. Kjo shihet në shëmbëlltyrën e mbjellësit (Mat. 13:3-11), shëmbëlltyrën e farës së sinapit (Mat. 13:31, 32), dhe në shëmbëlltyrën e majasë (Mat. 13:33).	Ajo gjithashtu përfshin të vërtetët dhe të rremët. Kjo shihet në shëmbëlltyrën e mbjellësit (Lluka 8:4-10), shëmbëlltyrën e farës së sinapit (Lluka 13:18, 19), dhe në shëmbëlltyrën e majasë (Lluka 13:20, 21).
Sipas realitetit të saj të vërtetë, të brendshëm, në mbretërinë e qiellit mund të hyjnë vetëm ata që janë të shpëtuar (Mat. 18:3).	Sa për realitetin e brendshëm të vërtetë, në mbretërinë e Perëndisë mund të hyjnë vetëm ata që janë të lindur përsëri (Gjoni 3:3, 5).

Pali po i referohej realitetit të saj të brendshëm, kur ai tha se «mbretëria e Perëndisë nuk është mish dhe pije, por drejtësi dhe paqe dhe gëzim në Frymën e Shenjtë» (Rom. 14:17). Ai gjithashtu theksoi se «mbretëria e Perëndisë nuk është në fjalë, por në fuqi» (1 Kor. 4:20).

Dallimi midis mbretërisë dhe Kishës mund të shihet më poshtë: mbretëria filloi kur Krishti filloi shërbimin e Tij publik; Kisha filloi në Ditën e Rrëshajave (Veprat 2). Mbretëria do të vazhdojë mbi tokë deri sa toka të shkatërrohet; Kisha do të vazhdojë në tokë vetëm deri në Rrëmbim; pastaj do të kthehet me Krishtin në Ardhjen e Tij të Dytë me Të si nusja e Tij. Tani njerëzit që janë në mbretëri në realitetin e saj të vërtetë, të brendshëm, janë gjithashtu në Kishë; ky është i vetmi aspekt në të cilën të dyja ndeshen.

DY ARDHJET E KRISHTIT

Për të kuptuar dhe shijuar Shkrimet, është e nevojshme të bëjmë dallimin midis ardhjes së parë dhe ardhjes së dytë të Krishtit. Ardhja e Tij e Parë, natyrisht, i referohet lindjes së Tij si foshnjë në Betlehem. Ardhja e Dytë tregon për kohën kur Ai do të kthehet. E para ka të bëjë me vuajtjet e Krishtit, e dyta me lavdinë që do të ndjekë më pas (1 Pjetri 1:11).

Në këtë kapitull, do të diskutojmë në mënyrë të përgjithshme Ardhjen e Dytë të Krishtit, duke paraqitur vetëm faktin e thjeshtë se Shpëtimtari po vjen përsëri. Në kapitullin tjetër do të shohim se Ardhja e Tij e Dytë ka disa faza.

Profetët e Dhiatës së Vjetër e parashikuan ardhjen e Mesias, por ata u çoroditën nga çfarë panë. Fryma e Perëndisë u zbuloi atyre se Krishti do të vinte me përlulje dhe lavdi. Ai do të vuante, do të derdhte gjakun dhe do të vdiste, por gjithashtu, Ai do të triumfonte mbi të gjithë armiqtë e Tij. Ata nuk mund të pajtoheshin me këtë. Ajo çfarë ata nuk kuptuan ishte që ata merreshin me dy ardhje të ndryshme të Mesias, me më shumë se 1900 vjet midis tyre.

Shpeshherë dy ardhjet janë bashkuar bashkë në Bibël pa asnjë tregues të ndonjë periudhe kohe midis tyre. Nëse mësojmë t'i zbulojmë këto tranzicione të menjëhershme, atëherë kjo do të na ndihmojë së tepërmi për të shijuar atë dhe do të përfitojmë. Ja disa shembuj.

Njëzet e një vargjet e parë të Psalmi 22 i referohen Ardhjes së Parë; ato tregojnë për vuajtjet e Shpëtimtarit në Kryq. Por vihet re një pauzë e dallueshme midis vargjeve 21 dhe 22. Dhjetë vargjet e fundit të psalmi tregojnë për fitoren dhe lavdinë e Ardhjes së Dytë.

Ne gjithashtu i gjejmë dy ardhjet në Isaia 9:5, 6:

Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Ati i përjetshëm Princ i paqes. Nuk do të ketë të sosur rritja e perandorisë së tij dhe paqja mbi fronin e Davidit dhe në mbretërinë e tij, për ta vendosur pa u tundur dhe për ta përforcuar me anë të mençurisë dhe të drejtësisë, tani dhe përjetë. Këtë ka për të bërë zelli i Zotit të ushtrive.

Ardhja në Betlehem është përshkruar me fjalët: «Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë...». E gjithë pjesa tjetër e vargjeve tregon kohën kur Ai do të kthehet për të sunduar me fuqi dhe lavdi të madhe.

Dy ardhjet gjenden gjithashtu në Isaia 49:7,

Kështu i thotë Zoti, Shpenguesi i Izraelit, i Shenjti i Tij, atij që përbuzet nga njerëzit, që urrehet nga kombi, shërbëtorit të sundimtarëve: Mbretërit do të shohin dhe do të ngrihen, princat do të bien përmbys, për shkak të Zotit që është besnik, i Shenjti i Izraelit, që të ka zgjedhur.

Ardhja e parë është e dukshme në fjalët: «atij që përbuzet nga njerëzit, që urrehet nga kombi, shërbëtorit të sundimtarëve», por pjesa tjetër e vargut tregon pagabueshëm ardhjen e Tij të dytë.

Tani vini re Isaian 52:14-15:

Duke qenë se shumë veta u çuditën me ty, sepse pamja e tij ishte e shfytyruar më tepër se e çdo njeriu tjetër dhe fytyra e tij ishte ndryshe nga ajo e bijve të njeriut, kështu ai do të spërkasë shumë kombe; mbretërit do të mbyllin gojën para tij, sepse

do të shohin çfarë nuk u ishte treguar kurrë atyre dhe do të kuptojnë ato që nuk kishin dëgjuar.

Vargu 14 e përshkruan qartë Shpëtimtarin në Kryq; ata që e panë Kryqëzimin u habitën nga thellësia e vuajtjes së Tij. Ai ishte aq i keqtrajtuar sa Ai nuk dallohej më si njeri. Por gjendet një kontrast i mahnitshëm në vargun 15. Kur Shpëtimtari të kthehet përsëri, njerëzit do të habiten me shkëlqimin e lavdisë së Tij. Kombet do të shtangen kur të shohin të Huajin e ulët të Galileesë duke u kthyer si Mbret mbi mbretër dhe Zot mbi zotër.

Një nga shembujt më të njohur të një pjese, ku dy ardhjet janë sëbashku është Isaia 61:1, 2:

Fryma e Zotit, Zoti është mbi mua, sepse Zoti më ka vajosur për t'u dhënë një lajm të mirë të përulurve; më ka dërguar të lidh plagën e atyre që e kanë zemrën të thyer, të shpall çlirimin e atyre që janë në robëri, hapjen e burgut të burgosurve, të shpall vitin e hirit të Zotit dhe ditën e hakmarrjes të Perëndisë tonë, për të ngushëlluar tërë ata që pikëllohen.

Kur Jezusi ishte në sinagogë në Nazaret, Ai citoi nga këto vargje (Lluka 4:18, 19). Por vini re se Ai ndaloi me fjalët «për të predikuar vitin e pranueshëm të Zotit». Ai nuk vazhdoi me shprehjen «dhe ditën e hakmarrjes së Perëndisë tonë». Pse? Sepse Ardhja e Tij e Parë solli vitin e pranueshëm të Zotit. Ardhja e Tij e Dytë do të fillojë «ditën e hakmarrjes së Perëndisë tonë».

Ne gjejmë një ilustrim të ngjashëm të dy ardhjeve në Psalmin 34:15, 16:

Sytë e Zotit janë mbi të drejtët dhe veshët e Tij janë të vëmendshëm të kapin brimën e tyre. Fytyra e Zotit është kundër atyre që sillen keq, për të çrrënjosur kujtimin e tyre nga faqja e dheut.

Kur Pjetri i citon këta vargje në 1 Pjetri 3:12, ai ndalon në fjalët «për të çrrënjosur kujtimin e tyre nga faqja e dheut». E gjithë pjesa tjetër e citimit i takon epokës në të cilën ne po jetojmë, por kjo shprehje e fundit tregon Ardhjen e Dytë të Krishtit.

Profeti Mikea paratregoi se Betlehemi do të ishte vendlindja e Mesias (Mikea 5:2):

Por ti, o Betlehem Efratah, megjithëse je i vogël midis mijërave të Judës, nga ti do të dalë për mua ai që do të jetë sundues në Izrael, origjinat e të cilit janë nga kohërat e lashta, nga ditët e përjetësisë.

Por pastaj Mikea kalon menjëherë në Ardhjen e Dytë të Krishtit, kur Ai do të jetë i madh deri në skajet e tokës (Mikea 5:4):

Ai do të mbetet për të kullotur kopenë e tij me pushtetin e Zotit, në madhërinë e emrit të Zotit, Perëndisë së tij. Dhe ata do të banojnë të sigurt, sepse atëherë ai do të jetë i madh deri në skajet e tokës.

Në Zakarian 9:9 kemi një parashikim të dukshëm të hyrjes triumfatore të Krishtit në Jerusalem:

Ngazëlllo me të madhe, o bijë e Sionit, lësho britma gëzimi, o bijë e Jerusalemit! Ja, mbreti yt po të vjen; ai është i drejtë dhe sjell shpëtimin, i përulur dhe i hipur mbi një gomar, mbi një gomar të ri.

Por vargu tjetër na çon për në Ardhjen e Dytë, kur Krishti do të sundojë nga deti në det:

Unë do t'i zhduk qerret nga Efraimi dhe kuajt nga Jerusalemi; harqet e luftës do të asgjësohen. Ai do t'u flasë për paqe kombeve; sundimi i tij do të shtrihet nga deti në det dhe nga lumi deri në skaj të dheut.

Ne i gjejmë dy ardhjet bashkë në Dhiatën e Re ashtu si në Dhiatën e Vjetër. Për shembull, le të marrim Lluka 1:31-33:

Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë dhe do t'ia vesh emrin Jezus. Ai do të jetë i madh dhe do të quhet Biri i Shumë të Lartit; dhe Zoti Perëndi do t'i japë fronin e Davidit, atit të tij; dhe do të mbretërojë mbi shtëpinë e Jakobit përjetë dhe mbretëria e tij nuk do të ketë kurrë të sosur.

Vargu i parë siç duket qartë u përmbush kur Jezusi lindi (shihni Mat. 1:25). Por vargjet 32 dhe 33 e kalojnë Epokën e tanishme të Kishës te koha kur Krishti do të kthehet për t'u ulur në fronin e Davidit dhe për të sunduar mbi tokë.

Gjendet një referim tjetër për dy ardhjet në Lluka 20:18:

Kushdo që do të bjerë mbi këtë gur do të bëhet copë-copë dhe ai mbi të cilin do të bjerë guri, do të dërrmohet.

Në pjesën e parë të vargut, guri (Krishti) është mbi tokë. Gjatë Mishërimit të Tij njerëzit ranë mbi Të dhe u bënë copë-copë. Në gjysmën e dytë të vargut, guri po bie nga lart. Kur Krishti të kthehet përsëri Ai do t'i shkatërrojë të pabindurit dhe do të bëhen si pluhur.

Një rast i fundit dhe i dukshëm në kombinimin e dy ardhjeve gjendet në Hebrejve 9:26, 28:

Sepse përndryshe ai duhet të pësonte shumë herë qëkurse u krijua bota; por tani, vetëm një herë, në fund të shekujve Krishti u shfaq për të prishur mëkatën me anë të flijimit të vetvetes....

Kështu Krishti, pasi u dha vetëm njëherë për të marrë mbi vete mëkatet e shumëve, do të duket për së dyti pa mëkatën për ata që e presin për shpëtim.

Ai u duk njëherë për të larguar mëkatën nëpërmjet flijimit të Vetvetes; ajo ishte Ardhja e Tij e Parë. Ai do të duket herën e dytë pa mëkat për shpëtim; ajo do të ndodhë kur Ai të vijë përsëri.

FAZAT E KTHIMIT TË KRISHTIT

Në mësimin e mëparshëm pamë se është e nevojshme të bëjmë dallimin midis ardhjes së parë dhe të dytë të Krishtit. E para i përket historisë; ndodhi 2000 vjet më parë. E dyta i përket profecisë; është akoma në të ardhmen.

Por është e nevojshme të kuptojmë se Ardhja e Dytë e Krishtit nuk është një ngjarje e vetme. Për më tepër, ajo zgjatet në një periudhë kohe dhe ka katër hapa ose faza. Kështu, në këtë mësim dëshirojmë të bëjmë dallimin midis këtyre fazave.

Në gjuhën origjinale (greqisht) të Dhiatës së Re fjala e zakonshme për «ardhjen» nënkuptonte «një prani» (*parousi* në greqisht). Ajo përcakton një ardhje dhe një prani të qëndrueshme. Përdorej shpeshherë në lidhje me ardhjen e një mbreti dhe vizitën që pasonte.

Për shembull, ardhja e Krishtit në Galile solli shërim për turma njerëzish. Këtu nuk nënkuptojmë thjeshtë ditën në të cilën Ai arriti në Galile, por të gjithë periudhën e kohës që Ai kaloi në atë zonë.

Kështu, kur mendojmë për Ardhjen e Dytë të Krishtit, ne duhet të mendojmë më shumë për një periudhë kohe sesa një ngjarje të izoluar. Kjo periudhë kohe ka katër faza, si më poshtë:

1. Një fillim
2. Një kurs (d.m.th. drejtim)
3. Një manifestim
4. Një pikë kulminante

1. Fillimi i ardhjes së Krishtit

Fillimi i Ardhjes së Krishtit është Rrëmbimi, domethënë, Ardhja e Krishtit për shenjtorët e Tij. Ai do të vijë në ajër, të vdekurit në Krishtin do të ngrihen, besimtarët që jetojnë do të ndryshojnë dhe të gjithë do të shkojnë te shtëpia e Atit. Kjo mund të ndodhë në çfarëdo momenti dhe do të ndodhë në një moment.

Sepse, ashtu si erdhi vdekja me anë të një njeriu, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin, por secili sipas radhës së vet: Krishti, fryti i parë, pastaj ata që janë të Krishtit, në ardhjen e Tij (1 Kor. 15:22, 23).

Tashmë, vëllezër, nuk duam që të jeni në padije për sa u përket atyre që flenë, që të mos trishtoheni si të tjerët që nuk kanë shpresë. Sepse, po të besojmë se Jezusi vdiq dhe u ringjall, besojmë gjithashtu që Perëndia do të sjellë me të, me anë të Jezusit, ata që kanë fjetur. Dhe këtë po jua themi me fjalën e Zotit: ne të gjallët, që do të mbetemi deri në ardhjen e Zotit, nuk do të jemi përpara atyre që kanë fjetur, sepse Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryeengjëlli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër; dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin. Ngushëlloni, pra njëri-tjetrin me këto fjalë (1 Thes. 4:13-18).

Ju lutemi, o vëllezër, lidhur me ardhjen e Zotit tonë Jezus Krisht dhe me tubimin tonë me Të (2 Thes. 2:1).

Tani, pra, vëllezër, jini të durueshëm deri në ardhjen e Zotit; shikoni si e pret me

durim bujku frytin e çmuar të tokës, deri sa të marrë shiun e parë dhe të fundit. Jini të durueshëm edhe ju dhe forconi zemrat tuaja, sepse ardhja e Zotit është afër (Jak 5:7, 8).

Edhe tani djema, qëndroni në Të që, kur të shfaqet Ai, ne të mund të kemi besim dhe në ardhjen e Tij të mos turpërohemi para Tij (1 Gjoni 2:28).

Të tjera pjesë, që i referohen Rrëmbimit janë Gjoni 14:1-4; 1 Korintasve 15:51-54; Filipianëve 3:20, 21; 1 Thesalonikasve 1:10; Hebrenjve 9:28; 1 Gjoni 3:2; Zbulesa 22:7, 20.

2. Kursi i ardhjes së Krishtit

Faza e dytë, kursi i ardhjes së Krishtit, përfshin Gjykimin nga Krishti, kur besimtarëve do t'u jepen shpërblime për shërbim me besnikëri.

Cila në fakt është shpresa jonë, a gëzimi, a kurora e lavdisë? A nuk jeni pikërisht ju, përpara Zotit tonë Jezus Krisht në ardhjen e Tij? (1 Thes. 2:19).

Dhe Perëndia i paqes ju shenjtëroftë ai vetë tërësisht; dhe gjithë fryma juaj, shpirti e trupi, të ruhet pa të metë për ardhjen e Zotit tonë Jezus Krisht (1 Thes. 5:23).

Shihni gjithashtu Romakëve 14:10-12; 1 Korintasve 3:11-15; 2 Korintasve 5:10; 2 Timoteut 4:7, 8.

Një ngjarje tjetër, e cila ndoshta duhet të përfshihet në kursin e ardhjes së Krishtit është Darka e Martesës së Qengjit. Nga vendndodhja në librin e Zbulesës, ne e dimë se do të ndodhë para sundimit të lavdishëm të Krishtit. Ne e përfshijmë atë këtu madje edhe nëse fjala «ardhje» nuk përdoret në lidhje me të.

Dhe dëgjova një si zë i një turme të madhe dhe si zë shumë ujërash dhe si zë bubullimash të forta, që thoshte: Aleluja, sepse filloi të mbretërojë Zoti, Perëndia ynë, i Plotfuqishmi! Le të gëzohemi dhe të ngazëllohemi dhe le t'i japim atij lavdi, sepse erdhi dasma e Qengjit dhe nusja e Tij është përgatitur! Dhe i është dhënë të vishet me li të hollë, të pastër dhe të shkëlqyeshëm, sepse liri i hollë janë veprat e drejta të shenjtoreve. Dhe më tha: Shkruaj: Lum ata që janë ftuar në gostinë e dasmës së Qengjit. Dhe më tha: Këto janë fjalët e vërteta të Perëndisë (Zbu. 19:6-9).

Ndërsa këto ngjarje do të ndodhin në qiell, toka do të përjetojë një kohë shtrëngese. Kjo do të jetë një periudhë afërsisht prej shtatë vjetësh, gjatë së cilës Perëndia do të gjykojë botën me intensitet gjithnjë në rritje (Dan. 9:27; Mat. 24:4-28; Zbu. 6—19). Gjysma e fundit e kësaj periudhe njihet si Shtrëngesa e Madhe; do të dëshmojë shqetësim dhe shkatërrim të një ashpërsie të madhe (Mat. 24:15-31).

3. Manifestimi i ardhjes së Krishtit

Faza e tretë është manifestimi i ardhjes së Krishtit, domethënë, ardhja e Tij në tokë me fuqi dhe lavdi të madhe për të sunduar si Mbret mbi mbretër dhe Zot mbi zotër. Rrëmbimi do të shihet nga bota; do të ndodhë në një pjesë të sekondës. Por çdo sy do ta shohë Krishtin kur të vijë për të sunduar. Për këtë arsye quhet manifestimi i ardhjes së Tij. Kjo është faza e tretë e ardhjes së Tij.

Pastaj, kur ai u ul të rrinte në malin e Ullinjve, dishepujt e vet iu afruan mënjanë dhe i thanë: Na thuaj, kur do të ndodhin këto gjëra? Dhe cila do të jetë shenja e

ardhjes sate dhe e mbarimit të botës? (Mat. 24:3).

Sepse, si vetëtima që del nga lindja dhe flakëron deri në perëndim, kështu do të jetë ardhja e Birit të njeriut (Mat. 24:27).

Por, ashtu si që në ditët e Noeut, kështu do të jetë edhe në ardhjen e Birit të njeriut (Mat. 24:37).

Dhe nuk kuptuan asgjë, deri sa erdhi përmbytja dhe i fshiu të gjithë; kështu do të ndodhë në ardhjen e Birit të njeriut (Mat. 24:39).

Për të bërë të patundura zemrat tuaja, pa të meta në shenjtëri përpara Perëndisë dhe Atit tonë, në ardhjen e Perëndisë sonë Jezus Krisht bashkë me gjithë shenjtorët e Tij (1 Thes. 3:13).

Atëherë do të shfaqet ky i paudhë, të cilin Zoti do ta shkatërrojë me hukatjen e gojës së tij dhe do ta asgjësojë me të dukurit e ardhjes së tij (2 Thes. 2:8).

Sepse nuk jua bëmë të njohur fuqinë dhe ardhjen e Zotit tonë Jezu Krisht, duke shkuar pas përrallave të sajuara me mjeshtri, por sepse jemi dëshmitarë okular të madhështisë së Tij (1 Pje. 1:16). (Këtu Pjetri po flet rreth manifestimit të ardhjes së Krishtit siç ishte portretizuar më parë në malin e Shndërrimit.)

Pjesë të tjera që i referohen fazës së tretë të ardhjes së Krishtit janë: Zakaria 14:4; Malakia 4:1-3; Veprat 1:11; 2 Thesalonikasve 1:7-9; Juda 14; Zbulesa 1:7; 19:11-16.

4. Kulmi i ardhjes së Krishtit

Faza e fundit është kulmi i ardhjes së Krishtit, shkatërrimi i qiejve dhe i tokës me zjarr. Ajo ndjek një mijë vjetët e sundimit të Krishtit në tokë. I referohet në 2 Pjetri 3:4, 7-13:

Dhe do të thonë: Ku është premtimi i ardhjes së Tij? Sepse, qëkur etërit fjetën, të gjitha gjërat mbetën në po atë gjendje si në fillim të krijimit.... Ndërsa qiejt dhe dheu i sotshëm janë ruajtur nga e njëjta fjalë për zjarrin, të rezervuar për ditën e gjyqit dhe të humbjes së njerëzve të pabesë. Por, shumë të dashur, mos harroni këtë gjë: se për Zotin një ditë është si për një mijë vjet dhe një mijë vjet si një ditë. Zoti nuk vonon plotësimin e premtimit të Tij, siç disa besojnë që ai bën; por është i durueshëm ndaj nesh, sepse nuk do që ndokush të humbasë, por që të gjithë të vijnë në pendim. Dhe dita e Zotit do të vijë si një vjedhës natën; atë ditë qiejt do të shkojnë me krismë, elementët do të shkrihen nga të nxehtëtit dhe veprat dhe toka që janë në të do të digjen krejt. Përderisa të gjitha këto gjëra duhet të shkatërrohen, si të mos duhet të keni një sjellje të shenjtë dhe të perëndishme, duke pritur dhe shpejtuar ardhjen e ditës së Perëndisë, për shkak të së cilës qiejt marrin flakë do të treten dhe elementët të konsumuar nga nxehtësia do të shkrihen? Por ne, sipas premtimit të Tij, presim qiej të rinj dhe tokë të re, në të cilën banon drejtësia.

Në këtë kapitull lexojmë për përqeshës, të cilët do të dalin në ditët e fundit, duke mohuar mundësinë e kthimit të Krishtit. Cilin nga aspektet e ardhjes së Tij nënkuptojnë ata?

A po i referohen Rrëmbimit? Jo. Ata ndoshta nuk dinë asgjë rreth Rrëmbimit. A po i referohen ardhjes së Krishtit për të sunduar? Jo. Është e dukshme se jo. I tërë konteksti tregon se ajo çfarë ata po përqeshin është dënimi përfundimtar i keqbërësve nga Zoti. Ata

nënkuptojnë gjykimin e fundit kulmor në tokë, ose çfarë ata e quajnë «fundin e botës». Argumenti i tyre është se ata nuk kanë përse të shqetësohen. Perëndia nuk ka ndërhyrë në histori dhe nuk do të ndërhyjë në të ardhmen. Kështu ata ndihen të lirë të vazhdojnë në fjalët dhe veprat e ligësisë.

Pjetri u përgjigjet përqeshjes së tyre duke u treguar kohën, pas mijëvjeçarit të sundimit të Krishtit, kur qiejt dhe toka, siç e dimë, do të shkatërrohen tërësisht. Ky kulm i ardhjes së Krishtit do të ndodhë pas Mijëvjeçarit dhe në inaugurimin e përjetësisë.

«Por» dikush mund të pyesë: «Si e di se faza e parë dhe e tretë, Rrëmbimi dhe Zbulesa, janë ngjarje të ndara»? Përgjigjja është se ato janë të dalluara në Shkrimet e Shenjta në mënyrat e mëposhtme:

Rrëmbimi

Zbulesa

1. Krishti vjen në ajër (1 Thes. 4:16, 17).	1. Ai vjen në tokë (Zak. 14:4).
2. Ai vjen për shenjtoret e Tij (1 Thes. 4:16, 17).	2. Ai vjen me shenjtoret e Tij (1 Thes. 3:13; Juda 14).
3. Rrëmbimi është mister, d.m.th. një e vërtetë e panjohur në Dhiatën e Vjetër (1 Kor. 15:51).	3. Zbulesa nuk është mister; Ajo është tema e shumë profecive të Dhiatës së Vjetër (Psa. 72; Isaia 11; Zak. 14).
4. Ardhja e Krishtit për shenjtoret e Tij nuk do të ndodhë e paraprirë nga shenja në qiej.	4. Ardhja e Krishtit me shenjtoret e Tij do të shpallet me shenja në qiej (Mat. 24:29, 30).
5. Rrëmbimi identifikohet me Ditën e Krishtit (1 Kor. 1:8; 2 Kor. 1:14; Fil. 1:6, 10).	5. Zbulesa njihet si Dita e Zotit (2 Thes. 2:1-12).
6. Rrëmbimi është paraqitur si një kohë bekimi (1 Thes. 4:18).	6. Theksi kryesor i Zbulesës është vënë në gjykimin (2 Thes. 2:8-12).
7. Rrëmbimi ndodh sa hap e mbyll sytë (1 Kor. 15:52). Kjo nënkupton me forcë që kjo nuk do të dëshmohet nga bota.	7. Zbulesa do të jetë e dukshme në mbarë botën (Mat. 24:27; Zbu. 1:7).
8. Rrëmbimi duket se do të përfshijë kryesisht Kishën (Gjoni 14:1-4; 1 Kor. 15:51-58; 1 Thes. 4:13-18).	8. Zbulesa përfshin kryesisht Izraelin, pastaj kombet joçifute (Mat. 24:1—25:46).
9. Krishti vjen si Ylli i Shndritshëm i Mëngjesit (Zbulesa 22:16).	9. Krishti vjen si Dielli i Drejtësisë me shërim në krahët e tij (Mal. 4:2).

DITA E ZOTIT, DITA E KRISHTIT, DITA E PERËNDISË

Tani duhet të kemi arritur në atë pikë ku pëlqejmë të bëjmë dallimet e duhura ndërsa studiojmë Shkrimet e Shenjta. Kur të arrijmë te studimi i ngjarjeve të ardhshme, ne do të kemi një fillim të mbarë në të kuptuarit e tyre, nëse jemi të aftë të bëjmë dallimin midis Ditës së Zotit, Ditës së Krishtit dhe Ditës së Perëndisë.

Dita e Zotit

Sigurisht nuk është një ditë njëzet e katër orëshe, por një periudhë kohe me karakteristika të caktuara.

Në Dhiatën e Vjetër «Dita e Zotit» përdorej për të përshkruar çfarëdo kohë gjykimi, braktisjeje dhe errësire (Isaia 2:12; Joeli 2:1, 2). Ishte një kohë, kur Perëndia marshonte përpara kundër armiqve të Izraelit dhe i dënonte ata përfundimisht (Sof. 3:8-12; Joeli 3:14-16; Abd. v15-16; Zak. 12:8, 9). Ishte gjithashtu ndonjë rast, kur Perëndia dënoi popullin e Tij për idhujtarinë e tyre dhe për largimin nga Ai. (Joeli 1:15-20; Amosi 5:18; Sof. 1:7-18). Dita e Zotit ishte kryesisht për gjykimin mbi mëkatin dhe për fitore për çështjen e Zotit (Joeli 2:31, 32).

Në Dhiatën e Re, Dita e Zotit përmbledh përafërsisht të njëjtën periudhë si «kohërat dhe stinët» (Veprat 1:7; 1 Thes. 5:1). Ajo fillon pas Rrëmbimit dhe përfshin:

1. Shtrëngesën ose, siç quhet gjithashtu, koha e mundimit të Jakobit (Dan. 9:27; Jer. 30:7; Mat. 24:4-28; 1 Thes. 5:1-11; 2 Thes. 2:2; Zbu. 6:1-19:16). Kjo është faza e parë e Ditës së Zotit. Do të vijë papritur, si një hajdut natën. Gjithashtu do të vijë pa e vënë re, menjëherë, me shkatërrim, e paevitueshme dhe e pashmangshme. Është një periudhë afërsisht prej shtatë vjetësh gjatë së cilës Perëndia do të derdhë gjykimin e Tij mbi judaizmin kundërshtar, krishterimin kundërshtar dhe mbi kombet joçifute. Këto gjykime gjithnjë në rritje janë pikturuar në Zbulesën nën simbolet e shtatë vulave, shtatë trumbetave dhe shtatë kupave. Gjysma e dytë e Shtrëngesës njihet si Shtrëngesa e Madhe; do të jetë koha më e vështirë e shqetësimit që bota ka përjetuar ose do të përjetojë ndonjëherë.
2. Ardhja e Krishtit me Shenjtorët e Tij (Mal. 4:1-3; 2 Thes. 1:7-9). Në fund të periudhës së Shtrëngesës Zoti Jezus do të kthehet në tokë me engjëjt e Tij të fuqishëm «në një zjarr flakërues, për t'u hakmarrë kundër atyre që nuk njohin Perëndi dhe që nuk i binden ungjillit». Ai do të shkatërrojë të gjithë armiqtë e Tij para se të vendosë mbretërinë e Tij mbi tokë.
3. Sundimi njëmijëvjeçar i Krishtit. Ky përfshihet në Ditën e Zotit (Joel 3:18 krahaso v14; Zak. 14:8, 9 krahaso v1). Do të jetë një kohë gjykimi i menjëhershëm për këdo që ngrihet në rebelim kundër Zotit (Isaia 65:17-25). Mbreti do të sundojë me një shkop prej hekuri (Zbu 19:5).
4. Shkatërrimi përfundimtar i qiejve dhe i tokës me zjarr (2 Pje. 3:7, 10). Në fund të sundimit njëmijëvjeçar të Krishtit, qiejtë dhe toka do të shkatërrohen me një zhurmë të

madhe dhe elementët do të shkrihen me nxehtësi të jashtëzakonshme. Kjo është faza e fundit e Ditës së Zotit.

Dita e Krishtit

Ndërsa Dita e Zotit është kohë gjykimi mbi botën që ka hedhur poshtë Birin e Perëndisë, Dita e Krishtit është një kohë bekimi për ata që i kanë besuar Atij dhe që janë anëtarë të Kishës së Tij. Dita e Krishtit ka dy cilësi të kryesore:

1. Rrëmbimin e shenjtoreve (1 Kor. 5:5; Fil. 1:6, 10). Të vdekurit në Krishtin do të ngrihen. Besimtarët që akoma jetojnë do të shndërrohen. Së bashku ata do të rrëmbehen për t'u takuar me Zotin në ajër dhe për t'u kthyer me Të te Ati në qiell.

2. Gjykimin nga Krishti (1 Kor. 1:8; 2 Kor. 1:14; Fil 2:16). Besimtarët do të paraqiten para Bemës (fjalë greke, d.m.th. karrigja e gjykimit) për rishikim dhe për shpërblim. Nuk do të vihet në dyshim shpëtimi i tyre, por do të shqyrtohet shërbimi i tyre. Shpërblime do t'u jepen të gjithë atyre që marrin aprovimin e Krishtit. Ata që kanë harxhuar kot jetën e tyre do të vuajnë humbje, por ata vetë do të jenë të shpëtuar nëpërmjet «si me zjarr» (1 Kor. 3:15).

Në përkthimin «Diodati i Ri (1991-1994)» 2 Thes. 2:2 lexohet «dita e Krishtit» por kjo është një gabim në përkthim. Duhet të lexohet «dita e Zotit». Për arsye të shqetësimeve intensive që po përjetonin besimtarët Thesalonikas, ata mendonin se gjykimet e Ditës së Zotit tashmë kishte filluar. Pali i siguron ata se do të jenë dy ngjarje që do t'i paraprijnë ardhjes së Ditës së Zotit—një largim mbarëbotëror nga besimi dhe shfaqja e Njeriut të Mëkatit—Antikrishtit. Thesalonikasit s'kishin pse të frikësoheshin nga ardhja e Ditës së Krishtit. Për ata, ajo do të kishte qenë çlirim nga sprovat përgjithmonë. Pra, 2 Thes 2:2 duhet të lexohet «dita e Zotit».

Dita e Perëndisë

Dita e Perëndisë nuk duhet të ngatërrohet me Ditën e Zotit ose me Ditën e Krishtit. Është dita e triumfit përfundimtar të Perëndisë. Ajo do të ndodhë pasi e gjithë ligësia të jetë mposhtur përgjithmonë dhe pasi qiejtë dhe toka të jenë shkatërruar me zjarr (2 Pje. 3:12). Për të gjitha qëllimet praktike, Dita e Perëndisë është e njëjtë si gjendja e përjetshme.

PËRMBUSHJE TË DYFISHTA

Kur arrijmë në studimin e Shkrimeve profetike, një nga çelësat më të dobishëm është të kuptojmë se disa profeci kanë më tepër se një përmbushje. Nuk është e pazakonshme të gjejmë një profeci që ka një përmbushje paraprirëse, një të pjesshme dhe më vonë një të plotë të fundit. Ky njihet si «ligji i referimit të dyfishtë».

Shembulli klasik i profecisë së Joelit në lidhje me derdhjen e Frymës.

Mbas kësaj do të ndodhë që unë do të përhap Frymën time mbi çdo mish; bijtë tuaj dhe bijat tuaja do të profetizojnë, pleqtë tuaj do të shohin ëndrra, të rinjtë tuaj do të kenë vegime. Në ato ditë do të përhap Frymën time edhe mbi shërbëtorët dhe shërbëtoret. Do të bëj mrekulli në qiejt dhe mbi tokë: gjak, zjarr dhe shtëllunga tymi. Dielli do të shndërrohet në terr dhe hëna në gjak, para se të vijë dita e madhe dhe e tmerrshme e Zotit. Dhe do të ndodhë që kushdo që do t'i drejtohet emrit të Zotit do të shpëtojë (Joeli 2:28-32a).

Kur Pjetri e citoi këtë pjesë në Ditën e Rrëshajave (Veprat 2:14-21), ai tha: «... kjo është çfarë është folur nga profeti Joel». Por ai nuk nënkuptoi një përmbushje të plotë, meqë disa nga gjërat që Joeli përmendi nuk ndodhën në Ditën e Rrëshajave.

Fryma nuk ishte përhapur mbi çdo mish, por vetëm mbi tre mijë çifutë. Nuk kishte mrekulli në qiej—qielli nuk ishte errësuar, as hëna nuk ishte shndërruar në gjak. Jo të gjitha shenjat ndodhën mbi tokë, të tilla si gjak dhe zjarr dhe tym.

Kjo do të thotë, se Dita e Rrëshajave ishte një përmbushje jo e plotë, e hershme e profecisë së Joelit. Përmbushja e plotë e saj do të ndodhë në Ardhjen e Dytë të Krishtit. Ardhja e Tij do të paraprihet nga shenjat e paratreguara dhe do të ndiqet nga derdhja e Frymës mbi çdo mish në tokën e mijëvjeçarit.

Ne gjejmë edhe një ilustrim tjetër të «ligjit të referimit të dyfishtë» në pjesën e famshme «të virgjëreshës» në Isaia 7:14:

Prandaj vetë Zoti do t'ju japë një shenjë: Ja, e virgjëra do të mbetet me barrë dhe do të lindë një fëmijë të cilin do ta quajë Emanuel.

Profecia kishte një kuptim të shpejtë për mbretin Ashaz, kryesisht, se një fëmijë do të lindte dhe do të quhej «Perëndia me ne», duke nënkuptuar se fitorja ishte afër. Para se fëmija do të ishte mjaft i rritur për të dalluar të mirën nga e liga aleanca Siri-Izrael do të prishej dhe brenda disa viteve fëmija do të jetonte në pjesën më të majmure të tokës (v. 15).

Por përmbushja e këtij vargu u bë me lindjen e Krishtit.

E gjithë kjo ndodhi që të përmbushej fjala e Zotit, e thënë me anë të profetit që thotë: «Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, të cilit do t'i vënë emrin Emanuel, që do të thotë: «Zoti me ne» (Mat. 1:22, 23).

Një shembull i tretë i përmbushjes së dyfishtë gjendet në Psalmin 118:26a.

I bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit.

Në të Dielën e parë të Palmave, kur Jezusi hyri në Jerusalem, turma brohoriti, duke thënë:

Hosana Birit të Davidit! Bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit! (Mat. 21:9).

Por ne e dimë se kjo nuk e konsumoi profecinë, sepse në vajtimin e Tij të mëvonshëm për Jeruzalemin Zoti Jezus tha:

Sepse Unë po ju them, se tani e tutje nuk do të më shihni më deri sa të thoni: I bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit (Mat. 23:39).

Përmbushja e fundit do të ndodhë kur Shpëtimtari të kthehet në tokë me fuqi dhe lavdi te njerëzit që do ta mirëpresin Atë si Mesia dhe Mbreti.

Akoma edhe një ilustrim tjetër i një profecie që ka dy përmbushje për sa i përket shkatërrimit të Jerusalemit. Jezusi e parashikoi braktisjen e qytetit në Lluca 21:20-24. Natyrisht fjalët e Tij u përmbushën në vitin 70 pas Krishtit, kur Titi dhe legjionët romakë plaçkitën qytetin dhe rrënuan Tempullin. Por mjerimet e Jerusalemit nuk janë të gjitha të kaluara. Është e qartë nga Zbulesa 11:2 se joçifutët do të shkelin qytetin e shenjtë për dyzet e dy muaj gjatë periudhës së Shtrëngesës.

Psalmi 2:1, 2 është cituar në Veprat 4:25, 26:

Përse u zemëruan joçifutët dhe popujt kurdisin gjëra të kota? Mbretërit e dheut ngritën krye dhe princat u mblodhën bashkë kundër Zotit dhe kundër Krishtit të tij.

Në Veprat 4:27, fjalët i zbatohen kryqëzimit të Krishtit:

Sepse pikërisht kundër Birit tënd të shenjtë, që ti e vajose, u mblodhën Herodi dhe Ponc Pilati me joçifutët dhe me popullin e Izraelit

Kjo ishte një përmbushje e pjesshme fillestare e fjalëve të Psalmi. Ato do të kenë një përmbushje të mëtejshme në fund të Shtrëngesës, kur sundimtarët e botës do të bashkohen në një përpjekje të kotë për ndaluar Krishtin që të marrë sundimin e qeverisjes universale.

Një shembull i fundit i ligjit të referimit të dyfishtë mund të gjendet në profecitë që kanë të bëjnë me rigrumbullimin e Izraelit (Isaia 43:5-7; Jer. 16:14, 15; Ezek. 36:8-11; 37:21). Këto profeci patën një përmbushje të pjesshme kur një pjesë e çifutëve u kthyen në Izrael nga robëria Babilonase, siç është përshkruar në Ezdran dhe Nehemian. Por ngjarja kryesore është akoma në të ardhmen. Ndonjë grumbullim i mëparshëm mund të ketë qenë veçse se një pikë uji në det. Gjatë kohës së shqetësimit të Jakobit, Perëndia do të sjellë popullin e Tij të zgjedhur përsëri në Izrael nga e gjithë bota (Mat. 24:31; Ligj. i Përt. 30:3, 4; Ezek. 36:24-32; 37:11-14). Atëherë dhe vetëm atëherë do të përmbushen plotësisht dhe përfundimisht profecitë.

SHTATË GJYKIMET

Kur studiojmë Biblën, është e rëndësishme të kuptojmë se gjenden disa gjykime të ndryshme dhe se duhet të kemi parasysh njerëzit, kohën dhe vendin ku ndodhin dhe bazën e gjykimit dhe rezultatet. Për shembull, shumë njerëz mendojnë se Gjykimi i kombeve është i njëjtë me Gjykimin para Fronit të Bardhë. Një studim i hollësishëm i tyre na tregon se ato nuk janë të njëjta.

Me siguri që studiuesi i kujdesshëm e di se nuk ekziston diçka e tillë e quajtur «gjykim i përgjithshëm», ku besimtarët dhe jo besimtarët të qëndrojnë para Perëndisë dhe të marrin dënimin e tyre.

Këtu do të diskutojmë për shtatë nga gjykimet më të rëndësishme që gjenden në fjalën e Perëndisë.

Gjykimi i mëkatit të njeriut

Në Kalvar, Perëndia e gjykoi mëkatin kur Jezus Krishti mori mbi vete dënimin në Kryq. Shpëtimtari vdiq për mëkatet e botës.

Sepse dashuria e Krishtit na shtrëngon, sepse kemi arritur në konkluzionin se, në qoftë se një ka vdekur për të gjithë, të gjithë, pra, kanë vdekur; dhe se Ai ka vdekur për të gjithë, me qëllim që ata të cilët jetojnë, të mos jetojnë që sot e tutje për veten e tyre, por për atë që vdiq për ta dhe u ringjall (2 Kor. 5:14, 15, theksi është shtuar).

Ai është shlyesi për mëkatet tona dhe jo vetëm tonat por për të të gjithë botës. (1 Gjoni 2:2, theksi është shtuar).

Kur Ai vdiq, ai pagoi plotësisht dënimin për mëkatin. Gjaku i Tij i derdhur i plotësoi të gjitha kërkesat e Perëndisë kundrejt mëkatit. Ai siguroi një rrugë nëpërmjet të cilës, Perëndia shpëton mëkatarët e paperëndishëm pa e miratuar mëkatin dhe pa komprometuar shenjtërinë e Tij. Vepra e Tij shpengimtare pati efekt të pafund dhe i dha fund mëkatit.

Sidoqoftë, vepra e Tij në kryq nuk e shpëton automatikisht gjithkënd. Vepra e Tij zëvendësuese është e mjaftueshme të mbulojë mëkatet e gjithë botës, por vetëm ata që pendohen dhe besojnë në Zotin Jezu Krisht përfitojnë nga vepra e Tij.

Kur një person e pranon Krishtin si Zot dhe Shpëtimtar, ai është përgjithmonë i lirë nga faji dhe dënimi i mëkatit. Ai nuk do të dënohet përjetësisht për mëkatet e tij, për arsye se Jezusi e ka përjetuar gjykimin e tyre dhe se Perëndia nuk kërkon dy herë shpagim. Besimtari merr njëherë e përgjithmonë falje juridike nëpërmjet besimit.

Vet-gjykimi i besimtarit

Kur njeriu shpëtohet, ai duhet të mbartë një farë vet-gjykimi në jetën e tij. Kjo do të thotë se ai duhet të gjykojë dhe të braktisë mëkatet sa më shpejt që ai kupton që ka kryer një mëkat. Pali po i referohej kësaj në 1 Korintasve 11:27-32:

Prandaj ai që ha nga kjo bukë ose pi nga kjo kupë e Zotit padenjësisht, do të jetë fajtor i trupit dhe i gjakut të Zotit. Por secili të shqyrtojë vetveten e kështu të hajë nga buka e të pijë nga kupa, sepse ai që ha e pi padenjësisht, ha dhe pi një dënim për veten e tij, sepse nuk e dallon trupin e Zotit. Për këtë arsye ka mes jush shumë të dobët e të sëmurë dhe shumë vdesin. Sepse po të shqyrtonim veten tonë, nuk do të

gjykoheshim. Por kur gjykohemi, ndreqemi nga Zoti, që të mos gjykohemi bashkë me botën.

Ne e gjykojmë mëkatin në jetën tonë atëherë kur e pranojmë praninë e mëkatit dhe e rrëfejme duke e braktisur atë. Ky gjykim duhet të vazhdojë gjatë gjithë jetës. Përndryshe, ne përjetojmë disiplinimin nga Ati ashtu siç është përshkruar në Hebrenjve 12:3-15.

Apostulli Pal e kuptoi se po të mos e dënonte mëkatin në jetën e tij, ai atëherë nuk do të ishte i denjë për shërbimin ndaj Zotit.

Madje e mundoj trupin tim dhe e nënshtroj, se mos, pasi t'u kem predikuar të tjerëve, të bëhem i padenjë (1 Kor. 9:27).

Gjykimi nga Krishti

Kur flasim për gjykimin nga Krishti, ne nuk duhet të mendojmë për një gjykim për krime, por si një garë atletike. Zoti nuk është atje për të bindur dhe dënuar fajtorët. Ai është atje për të dhënë shpërblimet! Nuk është një skenë gjyqi, por një kohë për rishikim dhe shpërblim.

Të gjithë besimtarët do të paraqiten para këtij gjykimi, i cili është quajtur Gjykimi Bema (nga fjala greke).

Të gjithë, pra, do të dalin përpara gjykatës së Krishtit (Rom. 14:10c).

Është e qartë se kjo ngjarje e rëndësishme ndodh në përjetësi, pas ringjalljes së shenjtoreve. Atëherë besimtarët do të kenë trup të përlëvdur.

Shërbimi i njerëzve të Perëndisë do të vlerësohet:

Sepse ne të gjithë duhet të dalim para gjyqit të Krishtit, që secili merr shpagimin e gjërave që ka bërë me anë të trupit, në bazë të asaj që ka bërë, qoftë në të mirën apo në të keqen (2 Kor. 5:10).

Disa do të shpërblehen dhe disa do të pësojnë humbje:

...vepra e secilit do të shfaqet, sepse dita do ta tregojë; sepse do të zbulohet me anë të zjarrit dhe zjarri do të provojë veprën e secilit e ç'loji është. Në qoftë se vepra që dikush ka ndërtuar mbi themelin qëndron, ai do të marrë një shpërblim, në qoftë se vepra e tij digjet, ai do të pësojë humbje (1 Kor. 3:13-15a).

Dhe pjesa e fundit e vargut 15 e bën të qartë se shpëtimi i personit nuk vihet kurrë në rrezik nga ky gjykim:

por ai vetë do të shpëtohet, si përmes zjarrit.

Gjykimi i Izraelit

Asnjë komb nuk ka përjetuar urrejtje, keqtrajtim dhe persekutim si populli Izraelit. Holokousti është një kapitull tjetër në histori me një rekord trishtimi, vuajtjesh dhe vdekjeje.

Por, për fatkeq, fundi nuk ka ardhur akoma. Pas Rrëmbimit të Kishës, Izraeli dhe kombet e tjerë do të përfshihen në një periudhë shtatëvjeçare mundimesh, gjysma e së cilës do të ketë trazira të papërshkrueshme. Jeremia e quan atë «kohë ankthi për Jakobin» (Jer. 30:7) dhe Zoti përdor shprehjen «Mundimi i madh».

Sepse atëherë do të ketë një mundim aq të madh, sa nuk ka ndodhur kurrë që nga

krijimi i botës e deri më sot dhe as nuk do të ketë më kurrë (Mat. 24:21).

Në fund të kësaj kohe, do të vijë Mesia. Kombi do të rimblidhet dhe Zoti do të takohet ballë për ballë në një vend që Ai e quan «shkretëtira e njerëzve» (Ezek. 20:33-44).

Një nga krimet më të mëdha me të cilën Zoti do të merret është adhurimi i Antikrishtit gjatë periudhës së Mundimit të madh. Zoti Jezus parashikoi se shumica e këtij kombi do të jetë në formën më të keqe të idhujtarisë:

Unë kam ardhur në emrin e Atit dhe ju nuk më pranoni; në qoftë se dikush tjetër vjen në emrin e tij, ju e pranoni (Gjoni 5:43).

Malakia jep një listë të gjatë të mëkateve që do të trajtohen nga Mbreti (Mal.2:1-3:5).

Është e qartë se të gjithë ata që rebelohen kundër Mbretit-Mesia do të shkatërrohen para inaugurimit të mbretërisë, ndërsa të gjithë ata që i nënshtrohen sundimit të Tij do të hyjnë në mbretërinë e lavdishme të Tij dhe do të përjetojnë sundimin e Tij në paqe dhe begati për 1000 vjet:

Dhe kështu mbarë Izraeli (që beson) do të shpëtohet, sikurse është shkruar: «Nga Sioni do të vijë çlirimtari dhe do të largojë pabesinë nga Jakobi. Dhe kjo do të jetë besëlidhja Ime me ta, kur Unë t'ju heq mëkatet e tyre» (Rom. 11:26-27).

Gjykimi i kombeve

Pjesa kryesore e Shkrimeve të Shenjta, që trajton gjykimin e kombeve, gjendet në Mateun 25:31-46. Ky gjyq bëhet në Ardhjen e Dytë të Zotit. Gjykatësi është Biri i Njeriut, d.m.th. vetë Jezusi.

Dhe kur të vijë Biri i njeriut në lavdinë e Tij, bashkë me të gjithë engjëjt e shenjtë, atëherë do të ulet mbi fronin e lavdisë së Vet (v. 31).

Profeti Joel e bën të qartë se trajtimi i Izraelit nga kombet e tjerë është një karakteristikë kryesore e këtij gjykimi (Joeli 3:2). Në Mateun 25 ata kombe, që i ndihmojnë vëllezërit judenj të Krishtit gjatë Mundimit të Madh, quhen dele. Ata që e kufizojnë ushqimin, ujin, veshmbathjen, mikpritjen dhe që refuzojnë të kenë ndonjë kontakt shoqëror me të sëmurët dhe të burgosurit janë quajtur kombet dhi.

Kombet dele do të «trashëgojnë mbretërinë e përgatitur... që nga themeli i botës» (v. 34). Kombet dhi do ta dëgjojnë dënimin e tyre, «Largohuni nga Unë, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm, të përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij» (v. 41).

Dhe ata do të shkojnë në mundim të përjetshëm dhe të drejtët në jetën e përjetshme (v. 46).

Disa njerëz e kanë të vështirë të pranojnë idenë e kombeve¹ të shpëtuar apo të humbur. Ata mendojnë se shpëtimi është një çështje që ka të bëjë krejtësisht vetëm me personin. Kjo nuk duhet të përbëjë ndonjë problem. Gjatë gjithë historisë, Perëndia ka komunikuar me kombe dhe me individë gjithashtu. Në qoftë se shumica e njerëzve në një vend rebelojnë ndaj Perëndisë, Ai në mënyrë karakteristike së pari shpëton popullin e Tij, pastaj hedh zemërimin e Tij mbi gjithë popullsinë. Sodoma është një shembull i kësaj. Dhe e tillë ishte edhe përmytja, por në një shkallë më të lartë.

Gjykimi i engjëjve

Pa e plotësuar krejtësisht kuriozitetin tonë, Bibla na tregon për disa engjëj që mëkatuan, të cilët po presin gjykimin e tyre të fundit:

Sepse, në qoftë se Perëndia nuk i kurseu engjëjt që mëkatuan, por i hodhi në tartar të lidhur me pranga terri që të ruhen për gjyq... (2 Pje. 2:4).

Ai i ruajti me pranga të përjetshme në errësirë për gjyqin e ditës së madhe, edhe engjëjt që nuk e ruajtën gjendjen e tyre të parë, po e lanë banimin e tyre (Jud. 6).

Ne e dimë shumë mirë se ekzistojnë edhe engjëj të tjerë të liq (zakonisht të barazuar me djajtë), të cilët janë me shumicë. Atëherë kur do të ndodhë gjyqi i engjëjve mëkatarë?

Mesia-Mbret, gjatë sundimit të Tij në tokë, do «t'i japë fund sundimit dhe pushtetit dhe fuqisë» dhe «do t'i vërë të gjithë armiqtë nën këmbët e veta» (1 Kor. 15:24-25). Pa dyshim, kjo përfshin nënshtrimin e fuqive, sundimeve dhe ligësisë frymërore në vende qiellore.

Meqë besimtarët do të sundojnë me Të, do të marrin pjesë në dënimin e engjëjve. Ndoshta kjo shpjegon pyetjen enigmatike të Palit në 1 Korintasve 6:3: «A nuk e dini se ne të gjithë do të gjykojmë engjëjt?»

Gjykimi përfundimtar i Satanit ndodh në fund të Mijëvjeçarit dhe përpara Gjykimit të Fronit të Bardhë:

Atëherë djallin që i kishte mashtruar, do ta hedhin në liqenin e zjarrit e të squfurit, ku janë bisha dhe profeti i rremë; dhe do të mundohen ditë e natë në shekuj të shekujve (Zbu. 20:10).

Meqë engjëjt, që mëkatuan, e pranojnë Satanin si drejtuesin e tyre, është e arsyeshme të besojmë se ata do të dënohen për pjesëmarrjen në rebelimin kundër Perëndisë (Isa. 14:12-17; Ezek. 28:12-19) dhe do të marrin pjesën e tyre në shkatërrimin e Satanit në liqenin e zjarrit.

Gjykimi para Fronit të Madh të Bardhë

Gjoni «pa një fron të madh të bardhë dhe atë që ulej mbi të, nga prania e të cilit iku dheu dhe qielli» (Zbu. 20:11). Froni është i madh për arsye të Atij që ulet mbi të dhe për arsye të gjërave që gjykohen. Bardhësia e tij bën fjalë për kullueshmërinë e këtij gjykimi. Ky gjykim ndodh në përjetësi, pasi bota siç e dimë do të jetë shkatërruar nga zjarri (2 Pje. 3:10).

«Dhe pashë të vdekurit, të mëdhenj e të vegjël, që rrinin në këmbë përpara Perëndisë» (Zbu. 20:12a). Këta janë të vdekurit e liq të të gjitha kohërave. Arsyeja pse ata po qëndrojnë në këmbë këtu, është se ata nuk besuan në Zotin. Mosbesimi është mëkati i madh, që sjell dënim.

Ai që nuk beson tashmë është dënuar, sepse nuk ka besuar në emrin e Birit të vetëmlindur të Perëndisë (Gjoni 3:18b).

Kush nuk i bindet Birit nuk do të shohë jetë, por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të (Gjoni 3:36b).

Dy libra hapen për të përcaktuar shkallën e këtij gjykimi:

...dhe librat u hapën; dhe u hap një libër tjetër, që është libri i jetës; dhe të vdekurit u gjyquan në bazë të gjërave të shkruara në libra, sipas veprave të tyre (Zbu. 20:12b).

Fundi i tyre është vulosur nga fakti se emrat e tyre nuk janë në Librin e Jetës, që do të thotë se ata nuk janë penduar dhe nuk kanë besuar në Krishtin si Shpëtimtari i tyre. Dhe kështu do të ketë shkallë gjykimi në ferr, ashtu siç do të ketë shkallë gjykimi të shpërblimit në parajsë. Veprat e tyre përcaktojnë masën e fajit të tyre. Për shembull, një përdhunues do të vuajë më shumë se një komshi, i cili ka jetuar një jetë të zakonshme (i cili, për të të ardhur keq, nuk e pranoi Zotin).

Trupi, këtu i simbolizuar si «Vdekje», dhe shpirti dhe fryma, të simbolizuara nga «Hadesi»—me fjalë të tjera, i tërë personi, do të hidhet në liqenin e zjarrit:

Pastaj vdekja dhe Hadesi u flakën në liqenin e zjarrit. Kjo është vdekja e dytë (Zbu. 20:14).

Asnjë besimtar nuk do të marrë pjesë në gjykimin para Fronit të Madh të Bardhë. Ky gjykim është vetëm për ata që e kanë hedhur poshtë ofertën e Perëndisë dhe kështu nuk janë në Librin e Jetës të Qengjit.

Shënime:

1. Krahas kësaj, duhet të kesh parasysh se fjala e përkthyer «kombe» (ethnë) mund të përkthehet në të njëjtën kohë «paganët ose joçifutët» dhe kështu është përdorur shpesh.

HADESI DHE GEHENA

Ekziston një dallim midis Hadesit dhe Gehenës. Këto fjalë janë të ndryshme dhe kanë kuptime të ndryshme në gjuhën origjinale të Dhiatës së Re. Ato nuk mund të përdoren për të zëvendësuar njëra-tjetrën¹. Hadesi është i përkohshëm, ndërsa Gehena është e përvetshme. Hadesi është i njëjtë si ferri dhe Sheoli në Dhiatën e Vjetër, ndërsa Gehena është i njëjtë si liqeni i zjarrtë. Hadesi është përshkruar si një qytet burg, ku të burgosurit presin gjyqin e tyre. Është një vendqëndrim. Gehena është burgu kombëtar ku kryhet dënimi.

Hadesi

Së pari, le të diskutojmë për Hadesin. Disa herë përdoret si referim për një vend vuajtjesh, disa herë i referohet varrit dhe herë të tjera një gjendjeje të mungesës së trupit. Po të jetë një vend, nuk ekziston ndonjë referim për lokalitetin ku gjendet. Shpjegimi më i plotë i Hadesit gjendet në Llukën 16:19-31, ku lexojmë se një i pasur, që nuk besoi, shikoi lart. Sigurisht që trupi i këtij njeriu ishte në varr, ndërsa shpirti në Hades. Por në atë gjendje të vetëdijshme, ai kishte intelekt, ishte i vetëdijshëm dhe kishte pushtet të shikonte përtej asaj gjendjeje dhe të shihte qiellin ose parajsën. Ai po vuante nga nxehtësia dhe nga etja. Ai kishte zell ungjillor, saqë donte që dikush t'u dëshmonte për Zotin pesë vëllezërve, që ata të mos përfundonin në këtë vend mundimi. Këtu Hadesi është një vend mundimi. Nuk ka asnjë rrugëdalje nga ai.

Por në Veprat e Apostujve 2:27, ai nuk është kaq shumë një vend, por është një gjendje. Pjetri citon nga Psalmi 16:10 dhe ia referon atë ringjalljes së Krishtit.

Sepse ti nuk do ta lësh shpirtin tim në Hades dhe nuk do të lejojsh që i Shenjti Yt të shohë kalbjen.

Këtu Hadesi nuk mund të jetë një vend, sepse kur Zoti Jezus vdiq, fryma dhe shpirti i Tij shkuan në parajsë², e cila është e njëjtë si qielli i tretë³, vendbanimi i Perëndisë. Por kjo mund t'i referohet gjendjes pa trup. Perëndia nuk e lejoi shpirtin e Tij të mbetej në atë gjendje dhe nuk e la të Shenjtin, d.m.th. trupin e Shpëtimtarit, të kalbej. Shprehja «i Shenjti yt» duhet t'i referohet trupit, ngaqë trupi është pjesa e njeriut që kalbëzohet pas vdekjes. Pjetri deklaroi me guxim se shpirti i Zotit nuk ishte lënë në Hades (Veprat 2:31). Ditën e tretë shpirti dhe fryma e Tij u ribashkuan me trupin e Tij të përlëvdur.

Një pjesë tjetër e Shkrimeve të Shenjta, që përshkruan Hadesin si një gjendje pa trup, është Zbulesa 20:13-14:

Dhe deti i dorëzoi të vdekurit që ishin në të dhe vdekja dhe Hadesi dorëzuan të vdekurit që ishin në ta; dhe ata u gjykuan secili sipas veprave të veta. Pastaj vdekja dhe Hadesi u flakën në liqenin e zjarrit. Kjo është vdekja e dytë.

Kjo skenë është gjykimi i fundit i mëkatarëve. Zoti Jezus Krisht është Gjykuesi, Ai që ka çelësat e Vdekjes dhe të Hadesit (Zbu. 1:18). Këtu vdekja përdoret si referim për trupin e tyre dhe Hadesi si referim për frymën dhe shpirtin e tyre. Fryma dhe shpirti i të gjithë jobesimtarëve ribashkohet me trupin në gjykimin para Fronit të Madh të Bardhë dhe kështu i tërë personi hidhet në liqenin e zjarrit.

Një pjesë tjetër e Shkrimeve të Shenjta, në të cilën Hadesi përdoret si referim të gjendjes në mungesë të trupit, gjendet në 1 Korintasve 15:55:

O vdekje, ku është gjëmba jote? O Hades, ku është fitorja jote?

Kjo është një këngë që besimtarët do të këndojnë në ardhjen e Krishtit. Ndërsa trupi i tyre ngrihet nga të vdekurit, ata do t'i kujtojnë vdekjes, se në të vërtetë i mbajti ata për një farë kohe, por nuk mundi t'i mbante ata përgjithmonë! Dhe megjithëse Hadesi pati sukses në mbajtjen e frymës dhe shpirtit të tyre të ndarë nga trupi, fitorja e tij ishte e përkohshme.

Në Zbulesën 6:8, flitet për një kalues mbi një kalë të zbehtë të quajtur Vdekje dhe Hadesin që e ndiqte nga pas. Pjesa tjetër e vargut shpjegon se Vdekja dhe Hadesi kishin pushtet të vrisnin një të katërtën e popullsisë së tokës. Përsëri këtu, Vdekja dhe Hadesi në mënyrë figurative përshkruajnë ndarjen e frymës dhe shpirtit nga trupi, që është vdekja.

Shpeshherë fjala Hades përdoret si metaforë për të përshkruar thellësinë e përlules. Për shembull, në mënyrë figurative qyteti i Kapernaumit u ngrit në qiell për privilegj. Por nuk e pëlqeu praninë e Birit të Perëndisë dhe kështu do të fundosej deri në Hades në turp dhe shkatërrim (Mat. 11:23; Lluka 10:15).

I vetmi referim tjetër e Hadesit gjendet në Mateun 16:18, ku Jezusi garantoj se portat e Hadesit nuk do të kishin sukses ndaj Kishës, që Ai do të themelonte. Asnjë sulm mbi Kishën nuk do të kishte sukses përfundimisht, kurse sigurohet sukcesi i Kishës mbi Hadesin.

Gehena

Nga dymbëdhjetë përdorimet e fjalës Gehena në Dhiatën e Re, njëmbëdhjetë nga ato janë përdorur nga vetë Zoti Jezus, i cili është më i mëshirshmi i të gjithë njerëzve. Jakobi, gjysmëvëllai i Jezusit e përdori herën tjetër.

Çfarë duhet të dimë për këtë vend të tmerrshëm? Ky vend nuk është përgatitur për njeriun, por për djallin dhe engjëjt e tij (Mat. 25:41). Perëndia nuk cakton ndokënd për këtë gjykim; por duke e hedhur poshtë hirin e Perëndisë, njerëzit zgjedhin Gehenën. Ky është një vend ku ka vajtim, të qara dhe kërcëllim të dhëmbëve (Mat. 8:12; 22:13; 24:51; 25:30; Lluka 13:28). Thuhet se vuajtjet dhe zjarri nuk marrin fund për ata që shkojnë në Gehenë (Marku 9:46). Tymi i vuajtjeve të tyre vazhdon në shekuj të shekujve (Zbu. 14:11).

Herë pas here, Jezusi ka thënë se është më mirë të hyjsh në jetë pa disa pjesë të trupit, sesa të shkosh në Gehenë në vuajtje (Mat. 5:29-30; 18:9; Marku 9:43, 45, 47). Sigurisht, kjo nuk do të thotë se do të ketë të gjymtuar në parajsë. Për më tepër, kjo do të thotë se është më mirë të përjetosh disiplinim të rreptë mbi orekset e trupit në këtë jetë, sesa të plotësosh epshet e tij dhe të mallkohesh përjetësisht.

Besimtarët nuk duhet të kenë frikë nga ata që shkatërrojnë⁴ trupin, por të kenë frikë nga Ai që mund të shkatërrojë edhe frymën edhe shpirtin në Gehenë (Mat. 10:28; Lluka 12:5).

Gjithkush që zemërohet pa shkak ndaj vëllait të tij duke e quajtur atë budalla, është në rrezikun e zjarrit të Gehenës (Mat. 5:22). Të folurit e lig i përket Gehenës në karakterin e tij (Jakobi 3:6). Mëkatet e Farisenjve i bënë ata t'i përkisnin Gehenës (Mat. 23:15,33).

Tartarus

Fjala greke tartarus⁵, e përkthyer "tartar" në 2 Pjetri 2:4, duket se ka një kuptim të veçantë në lidhje me engjëjt mëkatues. Në tartarus, ata janë në zinxhirët e errësirës duke pritur të gjykojnë.

Purgatori

Sipas Kishës Katolike Romake, «purgatori» është një gjendje ose një vend dënimi pas vdekjes, ku njeriu që vdes në hirin e Perëndisë mund të bëjë shlyerje për «dënimin e përkohshëm» për mëkatet dhe kështu të hyjë në parajsë. Zjarri i purgatorit supozohet të ketë një efekt rafinerimi për shpirtin e personit. Gjithashtu thonë se koha në purgator mund të shkurtohet nga lutjet e të gjallëve dhe nga meshat e ofruara në sajë të tyre.

Bibla nuk flet aspak për një gjendje të tillë ose një vend të tillë të quajtur purgator. Kjo fjalë nuk është përdorur në Bibël dhe kjo doktrinë është krejtësisht në kundërshtim me të vërtetën e shpëtimit me anë të hirit nëpërmjet besimit në Zotin Jezu Krishtin.

Shënime:

1. Fjala greke "Hades" është përkthyer «Hades» apo « ferr» në të gjitha përdorimet e saj përveç në 1 Korintasve 15:55, ku është përkthyer varr. Gehena vjen nga fjala greke (geenna). Zoti e përdori këtë fjalë për të bërë një përshkrim të gjallë të dënimit të përjetshëm si një vend zjarri të përjetshëm.

2. Lluca 23:43.

3. 2 Kor. 12:2, krahasojeni me v. 4.

4. Fjala shkatërrim nuk do të thotë zhdukje ose mungesë ekzistence, por për më tepër do të thotë mungesë e të qenurit mirë, mospërbushje të qëllimit për të cilin njeriu ose një gjë është krijuar. Për shembull, enët e verës që shpërthyen në Mat. 9:1 nuk u shkatërruan, por u dëmtuan dhe nuk mund t'i shërbenin qëllimit për të cilin ishin bërë.

5. Gjithashtu në latinisht shkruhet Tartarus.

MISTERE TË SHKRIMEVE TË SHENJTA

Dhiata e Re na paraqet një seri misteresh. Rreziku qëndron në atë që ne mund të mos i kuptojmë ato. Prandaj do t'i kushtojmë këtij mësimi një përmbledhje të shkurtër të kuptimeve të mistereve të ndryshme.

Përkufizim

Një mister është një e vërtetë që nuk është zbuluar kurrë më parë, të cilën njeriu nuk mund të kuptonte nëpërmjet intelektit të vet, por tani u është zbuluar njerëzve nga Perëndia. Kjo fjalë «mister» vjen nga fjala greke mysterion.

Mistere të Mbretërisë së Qiellit Mateu 13:3-50

Në Mateun 13:11 lexojmë për «misteret e mbretërisë së qiellit». Ato janë dhënë në këtë kapitull në formën e shtatë shëmbëlltyrave.

Në kapitujt e mëparshëm të Mateut, ne gjejmë Zotin Jezus duke i prezantuar Vetën Izraelit si Mesia-Mbret. Por në kapitullin 12 udhëheqësit fetarë e hodhën poshtë Atë duke e akuzuar për bërje të mrekullive me anë të fuqisë së Djallit. Kështu, tani që mbreti është hedhur poshtë, mbretëria do të marrë një formë tjetër. Kjo është çfarë gjejmë në Mateun 13. Këto shtatë shëmbëlltyra japin një përshkrim të mbretërisë në formën e saj së përkohshme—gjatë kohës midis hedhjes poshtë të Mbretit dhe kthimit të Tij për të sunduar mbi tokë. Mbreti mungon, por mbretëria e Tij gjendet kudo që njerëzit pohojnë të jenë të nënshtruarit e Tij. Ka edhe pohim edhe realitet. Në fund të periudhës së përkohshme të vërtetët do të ndahen nga të rremët dhe do të shijojnë bekimet e sundimit të Tij mijëvjeçar. Të rremët do të shkatërrohen.

Misteri i verbërisë së Izraelit Romakëve 11:25

Për arsye të mohimit të Mbretit nga Izraeli, Perëndia ka shkaktuar një verbëri juridike mbi kombin çifut. Kjo shpjegon pjesërisht vështirësinë e madhe që populli çifut ka në pranimin e Jezusit si Mesia i tyre dhe numrin relativisht të vogël të të shpëtuarve. Por kjo verbëri nuk është as totale as përfundimtare. Disa shohin se Jezusi është Ai për të cilin folën profetët. Dhe verbëria do të vazhdojë deri sa të ketë hyrë «tërësia e joçifutëve», domethënë, derisa Zoti të marrë nusen e Tij joçifute për të qenë me Të. Pastaj një pjesë çifute që mbetet të cilët besojnë do të kthehen te Krishti.

Misteri i Rrëmbimit 1 Korintasve 15:51, 52

Deri në atë kohë në historinë njerëzore gjithmonë besohej se gjithkush do të vdiste herët a vonë. Por tani apostulli Pal bën lajmërimin mahnitës se jo të gjithë besimtarët do të vdesin. Ata që jetojnë në kohën e Rrëmbimit do të shkojnë në qiell pa vdekur. Ata do të ndryshojnë—domethënë, ata do të marrin trupa të përlëvdur—dhe ata kurrë nuk do të përjetojnë vdekje. Ata që kanë vdekur në Krishtin do të ngrihen dhe do të merren në qiell me shenjtorët e gjallë. Detaje të mëtejshme gjenden në 1 Thesalonikasve 4:13-18.

Misteri i Kishës Romakëve 16:25; Efesianëve 3:4-5

Kisha ishte një e vërtetë e mbajtur sekret që nga fillimi i botës (Rom. 16:25), por iu shfaq

apostujve dhe profetëve të periudhës së Dhiatës së Re (Ef. 3:5). Ky mister përmban cilësi të tilla të rëndësishme si:

1. Kryesimi nga Krishti (Kol. 1:18).
2. Anëtarësia e gjithë besimtarëve (1 Kor. 12:13).
3. Faktin se joçifutët besimtarë janë të barabartë me besimtarët çifutë, se Krishti është shpresa e tyre e lavdisë gjithashtu dhe se armiqtë e vjetër midis çifutëve dhe joçifutëve është zhdukur në Krishtin (Ef. 3:6; Kol. 1:26, 27; Ef. 2:14, 15).
4. Kisha si trupi i Krishtit (1 Kor. 12:12, 13).
5. Kisha si nusja e Krishtit (Ef. 5:25-27, 31, 32).
6. Kisha si një shfaqje e urtësisë së shumëfishtë të Perëndisë ndaj principatave dhe fuqive në vende qiellore (Ef. 3:10).
7. Qëllimi i Perëndisë për ta bërë Krishtin Koka e një universi të shpenguar (Ef. 1:9, 10), me Kishën duke sunduar si nusja e Tij dhe duke e ndarë lavdinë e Tij me të përgjithmonë.

«Ky mister midis joçifutëve» në Kolosianëve 1:27 përcaktohet si «Krishti në ju, shpresa e lavdisë». Ky është i njëjti mister si Kisha; ai thekson se Krishti është shpresa e lavdisë për joçifutët që besojnë dhe për çifutët që besojnë gjithashtu—të gjithë tani kanë të njëjtin qëndrim në Krishtin para Perëndisë.

Në Kolosianëve 2:2 misteri i Perëndisë identifikohet me Krishtin. Ne e kuptojmë se kjo i referohet trupit misterioz të Krishtit, me Vetë Krishtin si Koka dhe të gjithë besimtarët si trupi i Tij.

Pjesë të tjera të Shkrimeve të Shenjta, që i referohen misterit të Kishës, janë Efesianëve 6:19 dhe Kolosianëve 4:3. Në një kuptim ky mister i Kishës përbën gurin e qoshes së zbulesës së Shkrimeve. Apostulli Pal e përmbushi Fjalën e Perëndisë kur ai e shfaqti këtë të vërtetë (Kol. 1:25). Nga ana kronologjike, kjo nuk ishte pjesa e fundit e Biblës që po shkruhej, por për sa i përket zbulesës të së vërtetave të reja, kjo përbën pikën kulminante.

Misteri i paudhësisë 2 Thesalonikasve 2:7, 8

I vetmi referim për «misterin e paudhësisë» gjendet në 2 Thesalonikasve 2:7, 8. Aty Pali thotë se «misteri i paudhësisë në fakt është tashmë në veprim, duke pritur vetëm që të hiqet nga mesi ai që e ndalon tani. Atëherë do të shfaqet ky i paudhë, ...» Madje edhe në ditët e para të Kishës një shpirt paudhësie po vepronte. Kishte shumë antikrishta. Por zhvillimi i plotë i paudhësisë u kufizua nga një Person i paemëruar (të cilin ne besojmë të jetë Fryma e Shenjtë). Kur ai Person kufizues të hiqet (Fryma e Shenjtë do të hiqet si Brendabanuesi i përhershëm në Rrëmbimin), atëherë Njeriu i Paudhësisë, Antikrishti, do të shfaqet në skenën e historisë. Ai do të jetë pikërisht trupëzimi i mëkatit dhe i paudhësisë. Bota nuk do të kishte parë kurrë një përqendrim të tillë ligësie në ndonjë qenie njerëzore.

Misteri i besimit 1 Timoteut 3:9

«Misteri i besimit» i referohet trupit të doktrinës së krishterë, ose asaj çfarë ne e quajmë besim të krishterë. Quhet mister, sepse kaq shumë prej të vërtetave të Tij ishin krejtësisht të panjohura në kohën e Dhiatës së Vjetër.

Misteri i perëndishmërisë 1 Timoteut 3:16

1 Timoteut 3:16 thotë:

Dhe s'ka asnjë dyshim se misteri i perëndishmërisë është i madh: Perëndia u shfaq në mish, u shfajësua në Frymë, u duk ndër engjëj, u predikua ndër joçifutë, u besua në botë, u ngrit në lavdi.

Përshkrimi i Personit të Trinisë këtu i përshtatet vetëm një personi—Zotit tonë Jezu Krisht. Deri në kohën kur Krishti erdhi në botë, njerëzit nuk kishin parë kurrë një perëndishmëri të përsosur në një njeri. Por Zoti Jezus erdhi dhe tregoi një demonstrim praktik të asaj çfarë është një person absolutisht i perëndishëm.

Kur Pali thotë se misteri i perëndishmërisë është «i madh» (fjala greke: mega), ai nuk nënkupton se ai është thellësisht misterioz, por për më tepër se e vërteta e Personit të Krishtit është e mahnitshme dhe e mrekullueshme.

Misteri i perëndishmërisë është në kontrast me misterin e paudhësisë. I pari paraqet një Njeri, i cili trupëzon në mënyrë të përsosur mëshirë. I dyti paraqet trupëzimin e gjallë të mëkatit. Ekziston një kontrast tepër i madh midis Krishtit dhe Antikrishtit.

Misteri i shtatë yjeve

Zbulesa 1:20

Ky mister është përkufizuar qartë. Shtatë yjet në vizionin e Gjonit janë engjëjt ose mesazh-sjellësit e shtatë kishave të Azisë. Shtatë shandanët e artë janë shtatë kishat. Në dy kapitujt e tjerë, Zoti ua adreson letrat engjëjve të shtatë kishave. Këto letra mund të kuptohen në tre mënyra të ndryshme.

1. Ato ishin shtatë letra të shkruara shtatë kishave të vërteta që kanë ekzistuar në kohën e Gjonit. Pothuajse të gjithë e besojnë këtë.
2. Ato japin një përmbledhje kronologjike të gjendjes në Kishës mbarëbotërore në çfarëdo kohë të historisë së saj. Kjo duket të jetë një zbatim i qartë për shumë studentë të Biblës.
3. Ato përshkruajnë një përmbledhje kronologjike të gjendjes së Kishës nga ditët e apostujve deri në fund të epokës së krishterë. Jo të gjithë e pranojnë këtë pikëpamje, por paralelizmat në të janë të mahnitshëm.

Misteri i Perëndisë

Zbulesa 10:7

Kur të bjerë trumbeta e shtatë e Zbulesës, misteri i Perëndisë do të përmbushet. Tingëllimi i trumbetës së shtatë shoqërohet nga zëra të lartë në qiell duke thënë: «Mbretëria e botës u bë mbretëria e Zotit tonë dhe e Krishtit të Tij dhe ai do të mbretërojë në shekuj të shekujve» (Zbulesa 11:15). Nga kjo dimë se trumbeta e shtatë bie në fund të Shtrëngesës së Madhe, kur Krishti të kthehet në tokë për të sunduar (Zbulesa 11:17). Në atë kohë shenjtorët besnikë të Shtrëngesës së Zotit do të shpërblehen dhe armiqtë e Tij do të shkatërrohen (v. 18).

Misteri i Perëndisë atëherë do të përmbushet. E liga që ka qenë kaq këmbëngulëse dhe në dukje fitimtare do të hidhet poshtë. Indiferenca e Perëndisë ndaj ligësisë së njeriut dhe mosveprimi i Tij në dukje do të kenë marrë fund. Ashtu siç thotë U. A. Krisëll: «Vonesa e madhe e Zotit tonë në marrjen e mbretërisë dhe në vendosjen e drejtësisë në tokë do të marrë fund».

Kurse F. W. Grant thotë: «Misteri i Perëndisë është i mbaruar përgjithmonë; lavdia e Perëndisë shkëlqen si dielli; besimi është plotësisht i shfajësuar, mërmëritja e dyshimit përgjithmonë e heshtur».

Misteri i Babilonisë

Zbulesa 17:5-7

Babilonia e Madhe është përshkruar në Zbulesën 17 si një prostitutë e ulur mbi një bishë

me shtatë koka dhe dhjetë brirë. Ajo quhet Babilonia e Madhe, Nëna e prostitutave dhe e paudhësive të tokës. Shpjegimi i misterit jepet në vargjet 8-18. Gruaja është një qytet i madh që sundon mbi mbretërit e tokës (v. 18). Bisha është një perandori që ka ekzistuar në një kohë, që ka dalë jashtë ekzistence dhe do të gjallërohet dhe do të shkatërrohet (v. 8). Shtatë kokat janë shtatë mbretër të kësaj perandorie (v. 9). Dhjetë brirët janë dhjetë mbretër që do të bashkohen me këtë perandori (v. 12). Prostituta shëtiti e ulur mbi bishën për një farë kohe, por pastaj ajo shkatërrohet nga bisha (v. 16). Vetë perandoria përfundimisht do të shkatërrohet nga Zoti (v. 14).

Interpretimi ynë i misterit është si më poshtë. Gruaja përfaqëson një sistem ekonomik e fetar, i cili do ta ketë qendrën në Romë; do të jetë një kishë botërore me burime të mëdha financiare. Bisha përfaqëson Perandorinë e gjallëruar Romake në një formë dhjetë mbretërisht, diku afër me linjat gjeografike të Tregut të Përbashkët European.

Pas mbështetjes së kishës botërore për pak kohë, sundimtari i Perandorisë së gjallëruar Romake dhe dhjetë mbretërit, që janë në aleancë do të dalin kundër sistemit dhe do ta shkatërrojnë atë. Detaje të mëtejshme për sa i përket Babilonisë dhe shkatërrimit të saj gjenden në Zbulesën 18.

Konkluzion

Ka edhe katër referime të tjera për misteret në Dhiatën e Re.

Në 1 Korintasve 2:7 Pali thotë se ai dhe apostujt e tjerë e folën «urtësinë e Perëndisë në një mister». Pastaj ai shpjegon se nënkupton të vërteta, të cilat u ishin fshehur brezave të mëparshëm, por që tani janë zbuluar nëpërmjet Frymës së Shenjtë.

Ai dhe apostujt e tjerë ishin «administratorë të mistereve të Perëndisë» (1 Kor. 4:1). Këtu përsëri fjala përdoret në një kuptim të përgjithshëm për të mbuluar të gjithë të vërtetën e përndarjes së krishtera.

Por ai na kujton në 1 Korintasve 13:2, se nuk është e mjaftueshme të njohësh të gjitha misteret dhe gjithë njohurinë. Po qe se nuk kemi dashuri, ne nuk jemi asgjë.

Dhe së fundi, në 1 Korintasve 14:2 Pali shpjegon se, në qoftë se një njeri flet në një gjuhë të panjohur pa ndonjë përkthyes të pranishëm, ai nuk përfiton asgjë, megjithëse ai mund të flasë mistere më të plota.

ASPEKTE TË LAVDIVE TË KRISHTIT

Kur flasim për lavditë e Krishtit, u referohemi cilësive supreme të Tij në Personin, pozitën dhe veprën e Tij. Ka të bëjnë me përsosmëritë morale dhe frymërore, që mund të vihen re nëpërmjet syrit të besimit nëpërmjet Fjalës së Perëndisë ose nënkupton madhështinë dhe lavdinë e Tij fizike tani në qiell ose kur të kthehet në tokë si Mbret mbi mbretër dhe Zot mbi zotër.

Është e pamundur t'i numërosh të gjitha lavditë e Zotit Jezu Krisht. Ato as që mund të përshkruhen me fjalë. Në këtë studim ne do ta kufizojmë veten në shtatë aspekte të kësaj lavdie që ne gjejmë në Shkrimet e Shenjta.

Lavdia e Tij origjinale personale si Perëndia Biri

Kjo u referohet të gjitha cilësive dhe përsosmërive të hyjnisë së Krishtit. Kjo lavdi është e përjetshme dhe gjithmonë ekzistuese. Ai është i njëjtë me shkëlqimin e lavdisë së Perëndisë (Heb. 1:3). Zoti Jezu nuk mund ta zbrazte Vetën nga kjo lavdi dhe as nuk mund ta linte mënjane. Kjo është një pjesë e pandarë e ekzistencës së Tij. Kjo përfshin të gjitha atributet dhe virtytet e Tij të mrekullueshme. Kur erdhi në tokë, Ai e mbuloi lavdinë e Tij me një trup mishi, por lavdia ishte e pranishme gjatë gjithë kohës dhe shkëlqeu në kohë të caktuara si në shndërrimin (Mat. 17:1-8; Marku 9:1-8; Lluka 9:28-36).

Lavdia e Tij pozicionale në qiell

Zoti Jezu ka zënë një vend të papërshtueshëm nderi dhe lavdie në gjithë përjetësinë. Ai ishte kënaqësia Atit të Tij dhe objekt adhurimi për engjëjt. Por për shpengimin e njerëzimit, Ai zgjodhi të mos e mbante atë pozitë. Në vend të saj, *Ai e zbrazi Vetën nga ajo* (Fil. 2:7a, përkthim fjalë për fjalë), mori formën e një shërbyesi dhe erdhi në formën e njeriut. As që mund të vihet në dyshim lavdia e Tij pozicionale kur Çarls Uesli po mendonte kur ai shkroi: «Të butë e lë Ai lavdinë, i lindur që njeriu të mos vdesë më»¹.

Është tepër e rëndësishme të kuptojmë se vet-zbrazja e Shpëtimtarit i referohet vetëm pozitës së Tij në qiell dhe jo Personit të Tij. Një princ mund të largohet nga një pallat dhe të jetojë në xhungël, por ai është i njëjti person.

Në Gjonin 17:5, Shpëtimtari u lut: «Tani, pra, më përlëvdo, o Atë, pranë Teje, me lavdinë që Unë e kisha pranë Teje para se të bëhej bota». Me fjalë të tjera, Ai po kërkonte restaurimin e lavdisë së Tij pozicionale, që Ai kishte me Atin, por që e la mënjane kur erdhi në tokë.

Lavdia e jetës së Tij në tokë si Biri i Njeriut

Si njeri në tokë, Zoti Jezu ishte i lavdishëm në mrekullitë që Ai bëri. Kështu ne lexojmë: «Jezusi bëri këtë fillim të shenjave në Kanë të Galileës dhe e shfaqti lavdinë e Tij» (Gjoni 2:11a). Ai ishte i lavdishëm në përsosmërinë e karakterit të Tij. Ai nuk kishte mëkat, Ai nuk mëkatoi, nuk pati asnjë mëkat në Të (2 Kor. 5:21; 1 Pje. 2:22; 1 Gjoni 3:5). Ai ishte kaq i përsosur sa që Ai nuk mund të bënte asgjë sipas vullnetit të Tij. Ai mund të bënte vetëm gjërat e Atit (Gjoni 5:19)² dhe Ai mund të fliste vetëm fjalë të Atit (Gjoni 13:50; 17:8). Pilati e pranoi se nuk kishte asgjë të gabuar në Të (Lluka 23:14, 22; Gjoni 18:38; 19:4, 6). Vendimi i Herodit ishte se Ai nuk kishte bërë asgjë të gabuar për të vdekur (Lluka 23:15). Vjedhësi që po vdiste dëshmoi se Jezusi nuk kishte bërë asgjë të gabuar (Lluka 23:41). Madje edhe Juda e pranoi se ai kishte tradhtuar gjakun «e pafajshëm» (Mat. 27:4). Shpëtimtari jo vetëm që ishte i lavdishëm në pamëkatshmërinë e Tij, por Ai ishte i lavdishëm në të folurit e Tij. Njerëzit në Nazaret u mahnitën nga fjalët që dilnin nga goja e Tij (Lluka 4:22). Ushtarët që shkuan ta

arrestonin e pranuan: «Asnjëri tjetër nuk ka folur ndonjëherë si ky Njeri!» (Gjoni 7:46). Ai ishte i lavdishëm në të qenët njeri. Kjo është çfarë e quajmë lavdia morale e Zotit tonë Jezu Krisht.

Lavditë e Tij të fituara

Zoti nuk do të ishte bërë Shpëtimtari ynë, po të kishte qëndruar në qiell. Por Ai u bë Shpëtimtari ynë i përkryer duke u kryqëzuar dhe u ngritur nga të vdekurit. Kështu ne lexojmë:

Sepse i duhej Atij, për të cilin dhe nëpërmjet të cilit janë të gjitha, duke çuar shumë bij në lavdi, ta bënte të përsosur me anë të vuajtjeve sjellësin e shpëtimit të tyre (Heb. 2:10).

Dhe, si u bë i përkryer, u bë vepronjësi i shpëtimit të amshuar për të gjithë ata që i binden (Heb. 5:9).

Është e qartë se Ai nuk mund të bëhej i përkryer për sa i përket Personit të Tij. Ai gjithmonë ka qenë i përkryer në atë aspekt. Por Ai mund të bëhej dhe u bë Shpëtimtar i përkryer.

Zoti e fitoi këtë lavdi kur u kryqëzua në kryqin e Kalvarit. Ai tha:

Ora ka ardhur, në të cilën Biri i Njeriut duhet të përlëvdohet (Gjoni 12:23b).

Krahas lavdisë së fituar si Shpëtimtar i përkryer, Zoti Jezus fitoi edhe përlëvdime të tjera nëpërmjet mishërimit dhe veprës flijuese të Tij. Po të mos ishte mishëruar, Ai nuk mund të ishte bërë Mesia, sepse Krishti duhej të ishte pasardhës i Davidit. Pa kryqëzimin në Kalvar, Ai nuk mund të ishte Kryepriest, Avokat, Ndërmjetës, Lutës për të tjerët, Shpengues, Bariu i Mirë, Trashëgimtar i të gjitha gjërave, Gjykatës dhe Kreu i Kishës. Ai nuk do të kishte pasur Emrin mbi të gjithë emrat ose të ishte i Parë-linduri nga të vdekurit. Çdo titull, që është fryt i mishërimit, vdekjes, varrosjes dhe ringjalljes së Tij, është lavdi e fituar.

Një rast tjetër i lavdisë së Tij të fituar gjendet në Gjonin 17:10:

Dhe të gjitha gjërat e Mia janë të Tuat dhe gjërat e Tua janë të Miat; dhe Unë jam përlëvduar në to.

Përlëvdimi nga besimtarët është diçka që mund të ndodhte vetëm si rezultat i veprës së Tij në kryqin e Kalvarit.

Në 2 Thesalonikasve 1:10a, Pali e lidh këtë në një mënyrë të veçantë me ardhjen e Tij të Dytë:

Kur Ai të vijë, atë ditë, për të qenë i përlëvduar në shenjtoret e Vet, për të qenë i admiruar në mes të atyre që kanë besuar...

Lavdia e ringjalljes dhe ngritjes së Tij në qiell

Përsëri në Gjonin 17:1, Zoti i referohet Kalvarit sikur tashmë të kishte ndodhur. Ai lutet që Ati ta përlëvdonte Atë, d.m.th. ta ngrinte nga të vdekurit, që Biri, nga ana tjetër, të përlëvdonte Atin.

Një pjesë e ngjashme me këtë e Shkrimeve të Shenjta gjendet në Gjonin 13:31-32:

Kur doli ai {Juda}, Jezusi tha: «Tani Biri i Njeriut është përlëvduar dhe Perëndia

është përlëvdur në Të. Në qoftë se Perëndia është përlëvdur në Të, Perëndia do ta përlëvdojë edhe në Vetvete dhe to ta përlëvdojë menjëherë».

Ai po fliste për vdekjen e Tij, si një mënyrë në të cilën Ai u përlëvdua dhe nëpërmjet të cilës i solli lavdi të madhe Atit. Me fjalë të tjera vargun 32 mund ta thonim: Meqë Perëndia është përlëvdur nga vepra e Krishtit në kryq, Perëndia do të përlëvdojë Atë, d.m.th. duke e ngritur nga të vdekurit menjëherë. Kjo është pikërisht çfarë ndodhi. Ati u ngrit ditën e tretë. Ja edhe disa vargje të tjera që flasin për lavdinë e ringjalljes dhe ngritjes së Tij në qiell:

Por a nuk duhej që Krishti të vuajë gjëra të tilla që të hyjë kështu në lavdinë e Tij? (Lluka 24:26).

Por këtë Ai e tha për Frymën, që do të merrnin ata që do të besonin në Të; sepse Fryma e Shenjtë në fakt nuk ishte dhënë ende, sepse Jezusi ende nuk ishte përlëvdur (Gjoni 7:39).

Dishepujt e Tij nuk i kuptuan për momentin këto gjëra, po, kur Jezusi ishte përlëvdur, atëherë u kujtuan se këto gjëra ishin shkruar për Të dhe që i kishin bërë këto gjëra për Të (Gjoni 12:16).

Perëndia i Abrahamit, e Isakut dhe Jakobit, Perëndia e etërve tanë e ka përlëvdur Birin e Tij Jezusin, të cilin ju ia dorëzuat Pilatit dhe e mohuat përpara Tij, megjithëse Ai kishte vendosur ta lironte (Veprat 3:13).

{Ai} u ngrit në lavdi (1 Tim. 3:16, pjesa e fundit e vargut).

Që, nëpërmjet Tij, të besoni në Perëndinë që e ringjalli prej së vdekurish dhe i dha lavdi (1 Pje. 1:21).

Lavdia e ringjalljes dhe ngritjes në lavdi bëhet një dhe e pandarë me lavdinë e Tij të amshuar në qiell. Ato janë të pandara.

Lavdia e Ardhjes së Dytë dhe e Mbretërisë së Tij

Në Dhiatën e Re ka më shumë referime për këtë lavdi se ndonjë lloj lavdie tjetër. Biri i Njeriut do të vijë mbi retë e qiellit me fuqi dhe lavdi të madhe (Mat. 24:30). Atëherë, Ai do të përlëvdohet në shenjtoret e Tij dhe do të admirohet nga të gjithë ata që besojnë (2 Thes. 1:10). Kur Ai të ulet në fronin e lavdishëm të Tij, Ai do të shpërblejë apostujt dhe të gjithë ndjekësit e Tij (Mat. 19:28), dhe do të gjykojë kombet (Mat. 25:31-33). Kur të vijë në lavdinë e Tij (Lluka 9:26), Atij do t'i vijë turp për ata që kishin pasur turp nga Ai dhe fjalët e Tij. Jakobi dhe Gjoni me papjekuri kërkuan të uleshin njëri në të djathtë dhe tjetrin në të majtë e Tij në lavdinë e mbretërisë së Tij të ardhshme (Marku 10:37). Ata që tashmë janë pjestarë të mundimeve të Krishtit, do të gëzohen dhe ngazëllohen në zbulesën e lavdisë së Tij në Mijëvjeçarin (1 Pje. 4:13).

Shndërrimi i Krishtit ishte një shembull i Mesias në lavdinë e Tij si Mbret mbi mbretër dhe Zot mbi zotër. Pjetri, Jakobi dhe Gjoni e panë lavdinë e Tij në malin e shenjtë.

Dhe ne soditëm lavdinë e Tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë (Gjoni 1:14b)³.

Pjetri dhe shokët e tij ishin ... kur u zgjuan plotësisht, panë lavdinë e Tij dhe ata dy

burra që ishin bashkë me Të (Lluka 9:32).

Më vonë Pjetri iu referua shndërrimit dhe e shpjegoi se kishte të bënte me fuqinë dhe ardhjen, d.m.th. ardhjen në fuqi të Zotit Jezus Krisht (2 Pje. 1:16).

Lavdia e Krishtit në mbretërinë e Tij përmendet edhe në Gjonin 17:22. Atje Kryepriifti ynë thotë:

Dhe Unë u kam dhënë lavdinë që Më ke dhënë, që ata të jenë një, ashtu si Ne jemi një.

Në njëfarë kuptimi, ne i shijojmë disa nga këto lavdi tani, si bij të Perëndisë, si vëllezërit e Tij, si pjesëtarë të Trupit të Tij dhe si bashkëtrashëgimtarë me Të.

Por në këtë pjesë të Shkrimeve të Shenjta, Ai flet gjithashtu për sundimin e Tij në tokë sikur të ishte i atëhershëm. Ne do të sundojmë me Të për 1000 vjet (Zbu. 20:4c). Kur Ai të lartësohet në lavdi, edhe ne do të shihemi në lavdi gjithashtu.

Në kohët tona, bota as nuk i dallon as nuk i pëlqen besimtarët e Perëndisë.

Prandaj bota nuk na njeh, sepse nuk e ka njohur Atë (1 Gjoni 3:1b).

Por kur Ai të vijë në lavdi, besimtarët do të shihen në lavdi gjithashtu:

Kur të shfaqet Krishti, jeta jonë, atëherë edhe ju do të shfaqeni në lavdi bashkë me Të (Kol. 3:4).

Shumë të dashur, tani jemi bij të Perëndisë, por ende nuk është shfaqur ç'do të jemi; por dimë se, kur të shfaqet Ai, do të jemi të ngjashëm me Të, sepse do ta shohim se si është Ai (1 Gjoni 3:2).

Atëherë bota do ta shohë unitetin midis Zotit Jezus dhe ndjekësve të Tij dhe do ta dijë se Ati e dërgoi Birin dhe se Perëndia i do shenjtorët ashtu siç do edhe Birin.

Lavdia e Tij e tanishme në qiell

Dëshira e Zotit Jezus, e shprehur në Gjonin 17:24, është që ata që e duan Atë të jenë me Të në qiell, që ata të sodisin lavdinë e Tij.

Me anë të besimit, ne tashmë mund ta shohim atë atje, të kurorëzuar me lavdi dhe nderime:

Por shohim Jezusin të kurorëzuar me lavdi dhe me nder për vdekjen që pësoi; Ai u bë për pak kohë më i vogël se engjëjt, që me hirin e Perëndisë të provonte vdekjen për të gjithë njerëzit (Heb. 2:9).

Lavdia e Tij e tanishme në qiell është ajo që Pjetri quan lavdi të përjetshme të Jezusit:

Dhe Perëndia i çdo hiri, që ju thirri në lavdinë e Tij të përjetshme në Krishtin Jezus, mbasi të keni vuajtur për pak kohë, do t'ju bëjë të përsosur Ai vetë, do t'ju bëjë të patundur, do t'ju forcojë dhe do t'ju vërë themel (1 Pje. 5:10).

Sidoqoftë, kjo lavdi në një farë kuptimi është e ndryshme në një farë mase nga ajo para se të vinte në tokë. Tani Ai është në qiell si një Njeri i përlëvdur krahas lavdisë së hyjnisë së Tij.

Lavdia e Tij e tanishme është një kombinim i të gjitha lavdive të Tij, të trashëguara dhe të fituara. Është lavdia e hyjnisë, mishërimit, attributeve, pozitës dhe karakterit të Tij. Ne nuk jemi thirrur për të marrë pjesë nga ato, por për t'u ngazëlluar në to dhe për t'i dhënë Atij lavdi përgjithmonë.

Shënime:

1. Në këngën e tij të preferuar të Krishtlindjes: «Hark the Herald Angels Sing».
2. Kjo, rastësisht, i përgjigjet pyetjes: «A mund të mëkatonte Jezusi»? Ai mund të bënte vetëm çfarë pa në Atin dhe kjo e përjashton mëkatimin. Ai gjithmonë bëri ato gjëra që e kënaqnin Atin (Gjoni 8:29) dhe kjo gjithashtu e përjashton mëkatin.
3. Ky varg mund t'i referohet edhe lavdisë së Tij si Njeri në tokë, por përdorimi kryesor është bërë si referim i shndërrimit të Tij.

DALLIME NË UNGJITË

Kushdo që i studion Ungjijtë vë re se shumë gjëra janë përsëritur veçanërisht në Ungjillin e Mateut, të Markut dhe të Llukës. Në to lexojmë për të njëjtat mrekulli, të njëjtat shëmbëlltyra dhe të njëjtat mesazhe nga Zoti. Sidoqoftë, këto nuk janë të pavlera. Fryma e Shenjtë nuk e përsërit Vetën pa qëllim.

Një studim i hollësishëm na tregon se dallimet midis Ungjijve janë më të rëndësishme se gjërat që janë përsëritur. Ajo ç'ka na duket se është përsëritur shpeshherë ka dallime të vogla që janë tepër të rëndësishme.

Shumë libra janë shkruar për harmoninë midis Ungjijve. Por ata e humbasin atë më të rëndësishme. Nuk është e rëndësishme ajo që është e njëjtë, por të vërtetat e ndryshme të nxjerra në ato pjesë të Shkrimeve të Shenjta. Le ta shpjegojmë këtë nëpërmjet krahasimit të dy pjesëve të njëjta të Shkrimeve të Shenjta.

Në të katër Ungjijtë, Gjon Pagëzori u tha njerëzve se ata do të pagëzoheshin nga Zoti. Kur po fliste vetëm me besimtarët, ai tha: «Ai (Jezusi) do t'ju pagëzojë me Frymën e Shenjtë» (Marku 1:8; Gjoni 1:33). Por kur po fliste edhe me jobesimtarë, ai tha: «Ai do t'ju pagëzojë me Frymën e Shenjtë dhe me zjarr» (Mateu 3:11; Lluca 3:16). Ai po fliste për dy pagëzime të ndryshme. I pari ishte pagëzimi i bekimit, i dyti pagëzimi i gjykimit.

Dy Shërbesa, jo një e vetme

Shërbesa në Mal gjendet në Mateun 5-7. Pjesë të saj duken të jenë përsëritur në Llukën 6:17. Por ato janë dy mesazhe të ndryshme të dhëna në dy raste të ndryshme. Në Mateun, mesazhi është dhënë në mal. Në Llukën, mesazhi është dhënë në një fushë. Jezusi kishte zbritur në një fushë me dishepujt (Lluca 6:17). Mateu përshkruan shtetasin e përkryer të mbretërisë, ndërsa Lluca përshkruan jetesën e dishepujve ndërsa ata shkojnë të përhapin Ungjillin. Në Mateun flitet për bekim për të varfrit në frymë (5:3); në Llukën Zoti i bekon të varfrit (6:20). Nuk flitet për mjerime në Mateun; por gjenden katër mjerime në Llukën (6:4-26). Këto dallime nuk duhet të nënvleftësohen.

Edhe Mateu edhe Lluca e citojnë thënien: «Llampa e trupit është syri». Konteksti në Mateun tregon se dashuria pas parave e pengon rritjen frymërore (6:22). Në Llukën paratë as që përmenden (11:33-36). Ajo çfarë theksohet këtu është se bekimi vjen nëpërmjet përvetësimit të mësimave të Jezusit dhe përhapjes së tyre në të tjerët.

Tre herë në Ungjijtë e gjejmë shprehjen: «...me masën me të cilën ju masni, do t'ju masin të tjerët». Në Mateun 7:2, ky është një paralajmërim për një qëndrim gjykues ndaj të tjerëve. Kurse Marku e përdor atë si një inkurajim për përvetësimin e Fjalës së Perëndisë (4:24). Ndërsa Lluca e përdor atë për të inkurajuar liri në bujari ndaj besimtarëve të Perëndisë (6:38).

Në Mateun 10:24, Jezusi tha: «Dishepulli nuk del mbi mësuesin, as shërbëtori mbi zotin e tij». Pastaj në Llukën 6:40, Ai tha: «Dishepulli nuk ia kalon mësuesit të vet, madje çdo dishepull që ka mësuar do të jetë si mësuesi i vet». Këto vargje duken sikur po thonë të njëjtën gjë, por janë krejt të ndryshëm. Në Mateun, Shpëtimtari po u mëson dishepujve të mos mendojnë se do të persekutohen më pak se Mësuesi i tyre, ndërsa në Llukën ai thotë se një besimtar nuk mund ta udhëheqë një dishepull më tej se niveli i tij frymëror.

Nëntëdhjetë e nënta

Tregimi i nëntëdhjetë e nëntë deleve është i njohur për ne. Në Mateun 18:12-13, kjo shpreh dashurinë e Zotit për fëmijët e vegjël (shih vargun 14). Në Llukën 15:4-7 kjo jepet me qëllim për farisenjtë dhe skribët, të cilët nuk donin ta pranonin se kishin nevojë të

pendoheshin (shih vargjet 2 dhe 7).

Shëmbëlltyra e talentave (Mat. 25:14-30) nuk duhet të ngatërrohet me atë të dhjetë minave (Lluka 19:12-27). Në rastin e talentave, tre njerëzve iu dhanë një sasi parash sipas aftësive të tyre. Dy të parët morën të njëjtin vlerësim pavarësisht nga aftësitë e tyre të ndryshme, ngaqë ata u treguan besnikë. I treti u kritikua ngaqë nuk bëri asgjë me çfarë i ishte dhënë.

Në shëmbëlltyrën e dhjetë minave, tre njerëz morën të njëjtën sasi parash. Ata të tre kishin të njëjtën mundësi. Njëri prej tyre e shumëfishoi sasinë e tij dhjetëfish, tjetri pesëfish dhe i treti aspak. Shpërblimet për dy të parët ndryshonin nga e të tredit sipas përdorimit të mundësisë që ata kishin. I treti humbi edhe atë që i ishte dhënë.

Sa mohime?

Është e mundur që Pjetri e mohoi Zotin të paktën gjashtë herë. Në qoftë se u bëjmë një studim të hollësishëm Ungjijve, do të zbulojmë se ai e mohoi Krishtin: 1. Para një gruaje të re (Mat. 26:69-70; Marku 14:66-68); 2. Para një gruaje tjetër të re (Mat. 26:71-72; Marku 14:69-70); 3. Para turmës (Mat. 26:73-74; Marku 14:70-71); 4. Para një burri (Lluka 22:58); 5. Para një njeriu tjetër (Lluka 22:59-60); 6. Para shërbëtorit të një kryepriifti (Gjoni 18:26-27). Ky i fundit është i ndryshëm nga të tjerët ngaqë tha: «A nuk të pashë ty në kopësht me Të?» Të tjerët nuk janë cituar duke thënë këtë.

Në fund të secilit Ungjill, Zoti i porositi dishepujt e Tij, por vini re dallimin në secilin rast.

Mateu – bëni dishepuj, duke predikuar dhe mësuar (28:19).

Marku – predikoni Ungjillin (16:15).

Lluka – dëshmoni (24:48).

Gjoni — më ndiqni Mua (21:19-21).¹

Kështu është e qartë se pjesë të Shkrimeve që duken sikur janë të njëjta nuk janë aspak të njëjta. Po të shohim dallimin midis tyre në vend të harmonisë, do të zbulojmë të vërteta të thella frymërore. Këto do të zgjidhin ato ç'ka ne na duken si kontradikta. Dhe do të na bëjë ta pëlqejmë edhe më tepër Fjalën e frymëzuar të Perëndisë.

Shënim:

1. Kjo iu tha Pjetrit, por gjen zbatim për të gjithë besimtarët.